Rruga e Arbërit

www.rrugaearberit.com GAZETË E PAVARUR. NR. 6 (168) / QERSHOR 2020. ÇMIMI: 50 LEKË. 20 DENARË.

Bigmarket
DI ÇFARË ZGJEDH!
NË PESHKOPI
Çdo muaj me
SUPER OFERTA

PROFIL

Neshat Ndreu, modeli i njeriut të suksesshëm

Nga **SHAQIR ÇERPJA** — Faqe 10

JETË

Tirana dhe Dibra, një histori e mikpritjes dhe e dashurisë

Nga **ENISA GORDANI** — Faqe 12

BOTIME / "Shënime në Çadër"

Një libër me vlera shkencore për gjeologjinë, ekonominë, historinë, turizmin...

Nga **PROF. DR. BASHKIM LLESHI** — Faqe 14

HOMAZH

Përse nuk më shkrove inxhinier Luan Leka?

Nga **DR. SELMAN MËZIU** — Faqe 22

REPORTAZH: Mes banorëve në Fushë-Alie dhe Arras, shtëpitë dhe pronat e të cilëve mbulohen nga ujërat e hidrocentralit

Skavica, hidrocentrali që po trazon jetën e banorëve luginës së Drinit

Skavica, një kërcënim real për banorët e pellgut të Drinit. Banorët kundërshtojnë planet e qeverisë: Nuk ka Skavicë pa bisedime me njerëzit në terren. Planet e paqarta të qeverisë për ndërtimin e hidrocentralit të Skavicës me forcat tona ngjallin pasiguri për të ardhmen e banorëve që jetojnë në fshatrat përgjatë luginës së Drinit të Zi nga Gjorica, në kufi me Maqedoninë e Veriut, deri në Zall-Reç.

Nga **BUJAR KAROSHI** — Faqe 2-4



Në foto: Fshati Fushë-Alie që mbulohet nga uji edhe në versionin e Skavicës 388 metra. Foto: B.Karoshi, qershor 2020

ANALIZË nga prof. dr. ADEM BUNGURI

— Faqe 4-6

Argumentet pse kundërshtoj ndërtimin e HEC-it të Skavicës!

OPINION

Shuhet kompozitori **Përparim Tomçini**, ideatori dhe themeluesi i **"Odës Dibrane"**

Fjalë zemre nga kompozitorë, këngëtarë, bashkëpunëtorë, miq e të njohur të kompozitorit të madh Përparim Tomçini

— Faqe 19-20



NË BRENDËSI:

- *Veli Torba, fermeri që nuk di të ndalet*
- Përcjellje për artin e Jahe Delisë
- Jam i lumtur kur kanë të tjerët
- *Muhurri, histori dhe personalitete* - një enciklopedi e gjithë zonës
- "Edhe unë jam nga Muhurri!"
- "Valle çmendurie", libër për dukuritë e jetës
- Hasmëria Murrja-Hasa dhe zbatimi në perfeksion i kanunit
- Profili njerëzor dhe profesional i Luljeta Çerës
- "Më preve në besë, o Qerim Sula"
- Për Qerim Sulën - Mjeshtrin e Madh
- Sejfulla Sefa, 44 vjet në shërbim të arsimit

Gazeta “Rruga e Arbërit” është një media e lirë dhe e hapur.
Çdo kontribut me shkrime, abonime ose donacione është i mirëpritur!
Bëj pajtimin tënd me **PayPal** përmes emailit <rrugaearberit@gmail.com>
Një pajtim vjetor kushton: Në Shqipëri: 600 lekë. Në Europë: 10 Euro.
Në SHBA dhe vende të tjera: 15 USD.
Pajtimi në Europë dhe SHBA është vetëm në versionin PDF.

Posta e Rruga e Arbërit

Gazetë e pavarur. Nr. 6 (168). Qershor 2020
Gazeta doli nga shtypi, 5 korrik 2020.
Gjendet në treg gjatë gjithë muajit korrik 2020.

Redaksia e gazetës falënderon lexuesit dhe bashkëpunëtoret e saj për mesazhet dhe shkrimet e sjella për botim.

Kujtojmë bashkëpunëtorët, të cilët duan që shkrimet e tyre të botohen patjetër në numrin e radhës, të konfirmojnë më parë sjelljen e materialit në numrat e telefonit të redaksisë ose emailin e gazetës.

Shkrimet refuzohen për botim vetëm në rast se merrni përgjigje me email. Për çdo rast tjetër shkrimet priten për botim në numrat e radhës.

Shkrimet në redaksi për numrin e radhës priten deri më **datë 20** të muajit, përveç rasteve të bashkëpunëtorëve të rregullt.

Gjithashtu, ju **kujtojmë bashkëpunëtorëve se shkrimet deri në dy faqe daktilografike kanë përparësi botimi.**

GJITHASHTU, KUJTOJMË SE ÇDO SHKRIM I BOTUAR NË NJË MEDIA TJETËR APO RRJETE SOCIALE NUK KA PËRPARËSI BOTIMI.

JU LUTEMI, SHKRIMET QË VIJNË PËRMES EMAIL-it, TË KENË PATJETËR ZANOREN “ë”.

Ju falënderojmë që jeni pjesë e gazetës!

BOTUES:
Musa Riçku
Bujar Karoshi
Shaqir Skarra

Editor i faqes online: Agim Deva

Kontribuan për këtë numër:
Osman XHILI
Abdurahim ASHIKU
Adem BUNGURI
Shaban SINANI
Bujar KAPEXHIU
Bashkim LLESHI
Enisa GORDANI
Fejzulla GJABRI
Shaqir ÇERPJA
Arif MURRJA
Mevlud BUCI
Selma MËZIU
Besnik LAMI
Lazam GJOKA

KËRKOHEN KORRESPONDENTË NË PESHKOPI DHE DIBËR TË MADHE

Të interesuarit për korrespondentë/menaxherë duhet të kenë pasion gazetarinë. Përbën avantazh përvoja në shtypin e shkruar ose në qoftë se kanë mbaruar studimet për gazetari dhe letërsi / marketing. Të jenë të angazhuar për punën në grup dhe të jenë të pavarur politikisht gjatë kohës që bashkëpunojnë me gazetën.
Të interesuarit të shkruajnë email
në adresën <rrugaearberit@gmail.com>
ose të telefonojnë në numrin
069 20 68 603.

Arkivi i gazetës është PA pagesë në faqen e internetit **www.rrugaearberit.com.**
Falënderojmë z. **AGIM DEVA** për kontributin e vazhdueshëm për mirëmbajtjen e faqes së gazetës në internet dhe arkivin online.
Pajtimet në gazetë mund t’i bëni në çdo kohë duke komunikuar në adresat e redaksisë.
Bëj pajtimin tënd me **PayPal** përmes emailit
<rrugaearberit@gmail.com>
Një pajtim vjetor kushton: Në Shqipëri: 600 lekë. Në Europë: 10 Euro. Në SHBA dhe vende të tjera: 15 USD.
Pajtimi në Europë dhe SHBA është vetëm në versionin PDF.
Për kontribute për gazetën mund të kontaktoni redaksinë ose mund t’i bëni ato përmes numrit të llogarisë më poshtë:
Raiffeisen Bank
Rruga e Arberit
Nr. llog. në lekë: 0010036640
IBAN: AL44 2021 1219 0000 0000 1003 6640

Adresa e gazetës:
Rr. “Zenel Baboçi”,
Pall. “Ferar”, Tiranë
Tel. +355 4 22 33 283
+355 69 20 68 603
E-mail: rrugaearberit@gmail.com

Opinionet dhe komentet e botuara nuk shprehin domosdoshmërisht qëndrimin e redaksisë
Çdo shkrim apo foto e botuar i nënshtrohet ligjit për respektimin e të drejtave të autorit. Ndalohet riprodhimi, fotokopjimi, shpërndarja apo ribotimi pa lejen e autorit të shkrimit apo redaksisë.

Nga **BUJAR KAROSHI**

“Skavica, në secilin variant, është i papranueshëm për ne”, - thotë Nazmi Drizi, kryetar i Shoqatës për Mbrojtjen e Pellgut të Drinit të Zi. “Nëse varianti 443 dhe 388 e ndajnë Dibrën përgjysëm, varianti 485 e zhduk përfundimisht Dibrën” - thotë ai.
“Skavica 388” do ta ketë ujëmbledhësin deri te Ura e Muhurrit, ndërsa “Skavica 443” do të mbulojë këmbët e urës së re mbi Drin, pjesë e Rrugës së Arbrit. Bazamenti i urës është 446 metra, 6 metra më shumë se niveli maksimal i kuotës se hidrocentralit.



Një arë me grurë në mes të Fushës së Kastriotit, ku altimetri regjistron 443 metra mbi nivelin e detit. Ara me grurë në këtë foto mund të jetë bregu i Skavicës. Çfarë sheh më poshtë, e gjitha do të jetë nën ujë.

Në mes të Fushës së Kastriotit, 15 metra poshtë kanalit vaditës që furnizon me ujë disa fshatra, përfshirë edhe Fushë-Alien, altimetri - një aplikacion i shkarkuar në celular, regjistron 443 metra mbi nivelin e detit. Ara me grurë - siç shihet në një nga fotot - do të jetë bregu i Skavicës. Çfarë sheh më poshtë, e gjitha do të jetë nën ujë.

Qeveria ka në shqyrtim dy versionet për hidrocentralin: Skavica 443 dhe Skavica 388. Në rastin e Skavicës 443, niveli i ujit do të jetë në kuotën 440 metra. Në rastin e Skavicës 388, niveli i ujit do të jetë në kuotën 385 metra. Versioni i vjetër i Skavicës, me digën 485 metra, duket se nuk është i zbatueshëm për qeverinë, por grupime të ndryshme interesi e kanë kritikuar qeverinë në qëndrimin që mban. Ata duan ndërtimin e Skavicës në nivelin maksimal, sepse kështu besojnë që i japin një zgjidhje afatgjatë jetesës së hidrocentraleve mbi Drin.

“Skavica, në secilin variant, është i papranueshëm për ne”, - thotë Nazmi Drizi, kryetar i Shoqatës për Mbrojtjen e Pellgut të Drinit të Zi. “Nëse varianti 443 dhe 388 e ndajnë Dibrën përgjysëm, varianti 485 e zhduk përfundimisht Dibrën” - thotë ai.

“Skavica 388” do ta ketë ujëmbledhësin deri te Ura e Muhurrit, ndërsa “Skavica 443” do të mbulojë këmbët e urës së re mbi Drin, pjesë e Rrugës së Arbrit. Bazamenti i urës është 446 metra, 6 metra më shumë se niveli maksimal i kuotës se hidrocentralit.

“QEVERIA OSE NUK E KA MARRË SERIOZISHT, OSE AJO PO PËRGATITET TË TJETËRSOJË JETËN TONË”

Dalip Alia, një 58 vjeçar nga Fushë Alia, fshati që mbytet nga të dy nivelet e diskutueshme të hidrocentralit të Skavicës, 388 metra dhe 443 metra, është i dëshpëruar. Pas 18 vjet përpjekje për të kundërshtuar ndërtimin e Skavicës, tashmë ai e sheh veten e pafuqishëm.

“Kjo është një shpërngulje masive. Kjo është një tjetërsimi jetës sonë”, - thotë ai.

Dalipi ka 3.5 hektarë tokë të tij, por bashkë me tokën e disa të afërmve, ai aktualisht punon 5 hektarë.

Ai është njëri nga ata banorë që ka vendosur ta ndërtojë jetën këtu. Shtëpia e tij është 385 metra mbi nivelin e detit dhe përmbytet në të dyja versionet e ndërtimit të hidrocentralit.

Është njëri nga anëtarët themelues të Shoqatës për Mbrojtjen e Pellgut të Drinit të Zi. Kanë dhënë lekë nga buxheti i familjes për të printuar dhe shpërndarë materiale që kërkojnë të bindin njerëzit që të kundërshtojnë planet e qeverisë për ndërtimin e hidrocentralit. Nga Reçi në Katund të Ri e Peshkopi ka udhëtuar për t’iu bashkuar protestave që kundërshtojnë ndërtimin e hidrocentralit.

“Qeveria ose nuk e ka marrë seriozisht këtë çështje, ose ajo po përgatitet të bëjë një gjenocid ndaj nesh”, - thotë Dalipi.

Dalipi dhe të tjerë në Fushë Alie janë të mendimit se qeveria, po ta kishte seriozisht ndërtimin e Skavicës, duhej të vinte dhe të ulej me popullin: qeveria të sjellë argumentet e veta dhe populli të sjellë argumentet se pse janë kundër. Të ballafaqohen palët dhe pastaj të vendoset.

“Këtu nuk ka ardhur kush për të regjistruar tokën tonë, as atë arë dhe jo më kullotat e pyjet”, - thotë Dalipi.

Babai i Dalipit, Fezë Alia, 88 vjeç, megjithëse lëviz ngadalë me shkop, mendjen e ka të freskët. Ai nuk beson se do të ndërtohet hidrocentrali.

“Është e vështirë edhe për qeverinë të marrësh përsipër të mbytësh Fushën e Dibrës. Ai thotë se të vjetrit i kanë pas thënë “Fusha e vogël e Myzeqesë, e cila mbante me bukë Dibrën e Matin bashkë”.

“Dalim në kodër dhe themi: Ishalla bëhet bereqeti në Dibër” - kujton ai thënie nga paraardhësit e tij.



Vladimir Marku, një guidë turistike në fshatin Arras, bujtina e të cilit mbytet nga Skavica 443.

TURIZMI, ZHVILLIM APO RRËNIM

Vladimir Marku, një 40-vjeçar nga Arrasi, ka mbaruar studimet për gjuhë angleze. Ai ka punuar për disa vite si mësues, por prej vitesh ofron shërbimet si guidë turistike. Shtëpinë e tij në Arras e ka kthyer në një bujtinë pritëse prej vitesh dhe vit pas viti turistët nga e gjithë bota kanë marrë shërbimet e tij. Ai tregon se u ka ofruar guidë rreth 5 mijë turistëve të huaj, ku 1 mijë prej të cilëve vetëm vitin e kaluar.

Këtë vit ka shtuar kapacitetet pritëse, por pandemia e ka zhytur biznesin në krizë. Shpresat për këtë vit janë te turizmi i brendshëm, por ndërtimi i Skavicës me digën 443 metra i mbyt gjithçka që ka ndërtuar deri më tani.

Bujtina “Arbri”- kështu quhet me emrin e biznesit shtëpia e Vladimirit - është në një rrafshinë të bukur në fshatin Arras, 416 metra mbi nivelin e detit. Versioni me 443 metra e mbyt shtëpinë e tij, por version tjetër 388 metra mund t’i rrisë mundësitë e zhvillimit të turizmit. Kur e pyet nëse është dakord apo jo, ai thotë “një orë e më përpara”. Për ata që nuk e njohin, mund ta marrin seriozisht, por ironia ndjehet kur biseda vazhdon.

reportazh

Banorët kundërshtojnë planet e qeverisë: Nuk ka Skavicë pa bisedime me njerëzit në terren
Planet e paqarta të qeverisë për ndërtimin e hidrocentralit të Skavicës me forcat tona ngjallin pasiguri për të ardhmen e banorëve që jetojnë në fshatrat përgjatë luginës së Drinit të Zi nga Gjorica, në kufi me Maqedoninë e Veriut, deri në Zall-Reç.

Skavica, hidrocentrali që po trazon jetën e banorëve luginës së Drinit



Shtëpia e Dalip Alisës, e cila në nivelin e Skavicës 388 metra, kati i dytë i ndërtesës mbetet mbi ujë...



Bujtina Arbri në Arras, e cila mbulohet nga uji në versionin e Skavicës 443 metra

Bujtina "Arbri"- kështu quhet me emrin e biznesit shtëpia e Vladimirit - është në një rrafshinë të bukur në fshatin Arras, 416 metra mbi nivelin e detit. Versioni me 443 metra e mbyt shtëpinë e tij, por version tjetër 388 metra mund t'i rrisë mundësitë e zhvillimit të turizmit. Kur e pyet nëse është dakord apo jo, ai thotë "një orë e më përpara". Për ata që nuk e njohin, mund ta marrin seriozisht, por ironia ndjehet kur biseda vazhdon.

Vladimiri publikisht tregohet asnjanës kur vjen biseda rreth Skavicës. Ai ka qenë një aktivist kundër ndërtimit të hidrocentraleve mbi lumin Seta, i cili është edhe njëra nga guidat e tij turistike më të kërkuara, por protestat e tij dhe dhjetëra banorëve të Arrasit dhe Çidhnës kanë dështuar.

"Gryka e Setës është një destinacion turistik interesant për turistët e huaj dhe vendas, por tashmë ajo është e dëmtuar nga punimet për ndërtimin e HEC", thotë ai.

Centrali i HEC-it "Seta 4" dhe një rezervuar i kultivimit të troftës ngritur prej vitesh me ujërat e pastra të Setës do të mbulohen me ujë edhe në rastin e ndërtimit të Skavicës 388. Ato ndodhën 385 metra mbi nivelin e detit.

Duke pasur parasysh se qytetarët e humbën betejën me Setën me pasoja për ta - disa prej tyre vazhdojnë akoma nuk marrin dot një pasaportë - ai ndjen se edhe beteja kundër Skavicës do të jetë një dështim.

VENDI PA INFRASTRUKTURË DHE PROJEKTE

Te hyrja e Bujtinës "Arbri" në Arras është fundi i asfaltit mbi rrugë. Gjatë fushatës elektorale për zgjedhjet vendore vitin e kaluar, kryeministri Edi Rama u premtoi banorëve vazhdimin e asfaltimit të rrugës, së paku deri te Muzeu i Kastriotëve në Sinë, i cili u rikonstruktua në vitin 2018, në kuadrin e "Vitit Mbarëkombëtar të Skënderbeut".

Por asfalti nuk ka më në plan të shtrohet.

Besnik Alku, ekspert i qeverisjes vendore, që vitet e fundit është marrë edhe me rritjen e burimeve turistike në Dibër dhe trajnimin e operatorëve turistikë, thotë se "Skavica i sjell një dëm ekonomik të madh Dibrës. Operatorët në të gjithë sektorët e tregut pësojnë një humbje të madhe, për shkak se do të humbasë komunikimi mes zonave. Ai thekson se infrastruktura është aktualisht shumë e dobët, por ndërtimi i HEC do ta ndërpresë krejtësisht komunikimin.

Fshatrat e Reçit, Lurës, Mustafe, Çidhnës, Selishtës, Muhurrit dhe gjithçka që mbetet në anën perëndimore të liqenit do të duhet të zhvillojnë rrjet të ri rrugor që i lidh me Kukësin, Mirditën e Matin. Do të duhet ndërtimi i një infrastrukture të re, por nga ana tjetër Dibrës do t'i largohet gjysma e tregut.

Rreth 27 fshatra nga Zall - Reçi në Hotesh mbulohen nga ujërat ë hidrocentralit plotësisht ose pjesërisht dhe dhjetëra fshatrave të tjerë u përmbyten tokat e punueshme që kanë në përdorim.

Shoqata për Mbrojtjen e Pellgut të Drini të Zi, e krijuar për të kundërshtuar ndërtimin e Skavicës, ka evidentuar se uji mbulon mbi 8 mijë hektarë tokë nga më pjelloret dhe e gjitha e punueshme, duke detyruar shpërnguljen e rreth 10 mijë banorëve dhe duke humbur tokën e punueshme rreth 40 mijë të tjerë.

"Këtu nuk ka më Dibër", thotë Nazmi Drizi.

NGA NATYRA TE HISTORIA, DËMET QË NUK I LLOGARIT KUSH

Varianti 443 metra i bën një dëm të madh Dibrës. Skavica jo vetëm mbyt tokën më pjellore të Dibrës, por i shkakton një dëm të madh mjedisit dhe rrezikon të prishë ekuilibrat mjedisorë për frutikulturën, e cila vitet e fundit ka marrë një zhvillim të madh.

"Mjegulla në pranverë dhe temperaturat e ftohta mund ta shkatërrojnë frutikulturën në të gjithë rajonin", - thotë Zenulla Mehmeti, i cili së bashku me vëllezërit e tij kanë një fermë të madhe mollësh në Melan.

"Në fazën e lulëzimit mjegulla dhe ngrica mund të dëmtojnë pemët, por edhe në qoftë se një pjesë e tyre shpëton, do të kenë nevojë për më shumë pesticide ndaj mbrojtjes nga kroma apo sëmundje të tjera".

Në deklarimet e pakta nga ana e qeverisë, theksohet se Dibra do të marrë një zhvillim turistik, sidomos peshkimit dhe turizmit liqenor, por banorët janë skeptikë.

"Kjo është një tallje, - thotë Dalip Alia. - Kryeministri, i cili e ka bërë të modës nxjerrjen e njerëzve të suksesshëm në faqen e tij në Facebook, pse nuk nxjerr edhe një histori të banorëve të Kukësit, të cilët po e shfrytëzojnë Fierzën për turizëm e peshkim? Atëherë edhe ne bindemi që kjo qenka një mundësi e punës sonë në të ardhmen".

"Duke qenë se Skavica do të shërbejë më shumë si ujëmbledhës dhe do të furnizojë hidrocentralet e tjera mbi Drin, në kohën kur ajo do të bjerë, mjedisi në brigjet e saj do të jetë shumë i degraduar. Të gjithë e kanë parë se kur bie Fierza, brezin e shëmtuar kafe të dheut poshtë bimësisë, por në rastin e Skavicës ky brez do të jetë fusha të tëra. Sepse sikur një metër të bjerë niveli, dhjetëra metra do të jetë në terren brezi i tokës i tharë. Vende-vende, madje, do të jetë edhe i ngjashëm me një kënetë" - thotë Nazmi Drizi.

Banorët revoltohen nga argumentet që sjellin zyrtarë të qeverisë , të cilët theksojnë se "nga ndërtimi i Skavicës do të shpëtojnë Shkodra e Lezha nga përmbytjet".

"Dibranët historikisht kanë qenë në mbrojtje të Shkodrës. Në vitin 1856 qindra dibranë të Dibrës së Poshtme të udhëhequr nga Sali Demiri shkuan në luftë kundër malazezve. Tridhjetë vjet me vonë, 1880-1890 përsëri dibranët në Shkodër. Hera e fundit në nëntor 1912, të udhëhequr nga Isuf bej Hysenagolli i Dohoshishtit, rreth një mijë dibranë kanë luftuar për mbrojtjen e Shkodrës. Pas 6 muajsh u kthyen, duke lënë atje 114 të vrarë e dhjetëra të plagosur. Tani, pas 107 vjetësh sërish dibranët duhet të "paguajnë" e sakrifikojnë për Shkodrën. Tani ata duhet të lëshojnë vatanin, të mbysin historinë, tokat e shtëpitë e tyre vetëm e vetëm që të shpëtojë Shkoda... Ky argument i përdorur është cinik. T'u kërkosh dibranëve të shpërngulen nga trojet e tyre me qëllim për të shpëtuar Shkodrën, është fyerje për dibranët sot. Por kjo është fyerje edhe për Shkodrën dhe shkodranët" - thotë Haki Përnezha, studiues i historisë dhe etnokulturës.

Ai rendit disa vendbanime të hershme si dhe mjaft vende që lidhen me historinë e lashtë dhe të vonë të luginë së Drinit të Zi,



Rruga përmes fushës së Kastriotit është e vetmja rrugë e asfaltuar në zonë. Nga Arrasi, Lura, Çidhna, Mustafe, Reç, Zall-Dardhë, Muhurr, Selishtë etj. nuk ka asnjë metër rrugë të shtruar me asfalt, duke vështirësuar komunikimin mes fshatrave.

Rruga e Arbërit nr. 168



Përmendorja kushtuar Betejës së Torviollit dhe luftërave për liri e pavarësi në shekuj të popullit të krahinës së Çidhnës, ndërtuar në vitin 2014 me kontributin e vetë banorëve. Përmendorja mbulohet nga Skavica 443 bashkë me disa vende të tjera që lidhen me historinë e lashtë dhe të vonë të luginë së Drinit të Zi, të cilat kanë mbetur jashtë interesit te hulumtimit historik e arkeologjik.

Skavica, hidrocentrali që po trazon jetën e banorëve luginës së Drinit

(Vijon nga faqja 3)

të cilat kanë mbetur jashtë interesit te hulumtimit historik e arkeologjik, por që mbartin pasuri të mëdha që dëshmojnë identitetin tonë kombëtar dhe historinë tonë.

SHOQATAT E REJA, PËRPJEKJE PËR PROTAGONIZËM

Pas njoftimit të qeverisë për nxjerrjen nga sirtari të planeve për ndërtimin e Skavicës, shoqata dhe individë të ndryshëm kanë shprehur interesin për krijimin e aleancave për ta kundërshtuar planin e qeverisë.

"Aleanca për Mbrojtjen e Dibrës" është krijuar në Facebook dhe gjithashtu ka hapur edhe një peticion online për të kundërshtuar ndërtimin e Skavicës. Ndërsa në Peshkopi një përpjekje për të organizuar një forum me shoqatat joqeveritare ka dështuar.

"Ne jemi këtu, - thotë Nazmi Drizi. - Kemi 18 vite që luftojmë kundër planeve të qeverisë. Bashkojuni rreth shoqatës dhe nuk ka nevojë të krijojmë shoqata të tjera, që vetëm dëm do t'i sjellin çështjes, jo përfitim".



Kartë anëtarësie e Shoqatës për Mbrojtjen e Pellgut të Drinit të Zi, e cila ka 18 vjet veprimtari dhe mbi 5500 anëtarë

Shoqata për Mbrojtjen e Pellgut të Drinit të Zi ka 18 vjet aktivitet, mbi 5500 anëtarë dhe deri më tani nuk ka marrë asnjë ndihmë nga asnjë organizatë apo forum për mbarëvajtjen e punës së saj, përveç fondeve të anëtarësisë.

"Shoqata jonë është e regjistruar pranë institucioneve shqiptare si dhe është e njohur zyrtarisht edhe nga qeveria shqiptare. Ne kemi zhvilluar takime me ministrat e qeverisë së Fatos Nanos dhe Sali Berishës dhe i kemi shprehur qëndrimet tona kundër në zyrat e ministrisë. Nuk kemi nevojë t'ia nisim nga e para, por le të bashkohemi dhe t'i japim një vrull të ri mbrojtjes së çështjes sonë të përbashkët".

Nazmiu dhe anëtarë të tjerë të shoqatës kanë frikë se aleanca apo forume të reja që krijohen në këtë situatë janë përpjekje të individëve të ndryshëm për të përfituar prej situatës, duke kërkuar të jenë zëri ynë, por në fakt janë përpjekje për marrëveshje me qeverinë e radhës.

"Nuk do ketë shoqatë që të na marrë mundin që kemi bërë duke mbrojtur interesat tona pa asnjë interes financiar", - thotë Nazmi Drizi.

"Kontributet i pranojmë, protagonizmin jo", - thotë Dalip Alia.

ZGJIDHJA E VETME: ULJA NË BISEDIME ME BANORËT

Banorët kërkojnë që qeveria përpara se të vazhdojë me planet për Skavicën, duhet të vijë në terren të ulet me banorët: të regjistrojë shtëpitë, tokat troje, arat, kullotat. Sepse në Dibër secili ka shkuar në tokën e trashëguar brez pas brezi dhe pavarësisht se kjo tokë është apo jo e regjistruar në kadastrat zyrtare, ajo është e tyre.

"Qeveria duhet të bjerë dakord me njerëzit që dëmtohen, - thotë Nazmiu. - Askush nuk ka bërë një llogari se çfarë dëmesh vijnë me ndërtimin e hidrocentralit, çfarë resursesh prishen dhe ku përfundon Dibra, si ndahet ajo?"

"Shteti duhet të ketë respekt për banorët. Këtu nuk bëhet fjala për një individ, këtu bëhet fjalë për një krahinë, bëhet fjalë për Dibrën. Ne nuk jemi për pazare, por nuk jemi as antishqiptarë dhe as kundër zhvillimit."

Pavarësisht lëvizjeve të qeverisë dhe aksioneve civile për të kundërshtuar, banorët që takova në Fushë-Alie e Arras janë pothuajse njëzëri në mendimin se Skavica nuk do të bëhet.

"Vetëm një gjëje ia kemi frikën: përdorimit të parave të drogës dhe trafikut. Në qoftë se qeveria vendos të amnistojë paratë që vijnë nga krimi i organizuar dhe trafiqet, atëherë ajo as nuk do të denjojë të ulet me banorët për të zgjidhur problematikat. Ajo do të fillojë ndërtimin e digës dhe banorët, kur ta shohin ujin te dera, do marrin plaçkat dhe do ikin… Por kjo atëherë do të jetë një gjenocid. Dhe atëherë ne do të dimë se si t'i përgjigjemi".

* * *

Fejzë Alia ka kaluar një jetë plot vuajtje e sakrifica. Pasi dëgjon bisedat për Skavicën në oborrin e shtëpisë së tij në Fushë Alie, thotë:

"Një punë që mund ta bësh dhe nuk e bën - është haram. Një punë që nuk e bën dot dhe thua e bëj - është haram".

Të parën që mund ta bëjë qeveria nuk e ka bërë, ndërsa të dytën që është e vështirë të bëhet thotë që do ta bëjë...Së paku deri më sot.

Fotot dhe teksti: B.KAROSHI

Nga Prof. dr. ADEM BUNGURI

Dy janë çështjet aktuale me rëndësi jetike për Dibrën: **Rruga e Arbërit dhe HC i Skavicës**! E para e shpëton Dibrën, e dyta e përmbyt atë dhe e asgjëson si tërësi gjeografike, historike dhe etno-kulturore mijëravjeçare!.

SKAVICA

Çështja e ndërtimit të HC të Skavicës u publikua në ditët e para të janarit 2016, duke iu referuar vizitës së kryeministrit të vendit në Istanbul në dhjetorin e kaluar. Sipas disa kanaleve televizive bëhet fjalë për një farë marrëveshjeje midis shefit të qeverisë tonë dhe një kompanie turke, që paska marrë përsipër ndërtimin e HC të Skavicës!. Për pasojat e rënda që do të ketë për Dibrën, ndërtimi i HC të Skavicës, ky problem nuk mund dhe nuk duhet të kalohet në heshtje.

Për hirë të së vërtetës, një projekt për ndërtimin e një HC mbi Skavicë, ka qenë hartuar edhe në kohën e komunizmit, përkatësisht në vitet 1983-1984. Sipas ekspertëve të hidrologjisë së asaj periudhe, qeveria Çarçani u tërhoq nga ndërtimi i këtij HC, përballë kostës së madhe të humbjes së tokave më të mira dhe më pjellore të këtij rajoni. Se Dibra është konsideruar gjithnjë si Myzeqeja e Shqipërisë Lindore! Kjo çështje qe rihapur në shkurt 2010 nga qeveria Berisha, dhe shihej në atë kohë si zgjidhje e problemit të përmbytjeve në zonën Shkodër-Lezhë, edhe pse më vonë u gjetën zgjidhje të tjera shumë më racionale. Banorët e Dibrës e kundërshtuan këtë projekt, kundërshti që e kanë shprehur prej kohësh në shtypin periodik disa nga përfaqësuesit e spikatur të publicistikës dibrane si z. A. Hoxha, z. B. Karoshi, z. A. Ashiku, z. V. Hoxha, z. M. Koltraka, z. Sh. Skara etj. Për fat të mirë, qeveria demokratike e asaj periudhe u tërhoq nga kjo ndërmarrje me pasoja të padëshirueshme për Dibrën.

Nga burime të besueshme thuhet se qeveria aktuale paska në plan ndërtimin me koncension të HC të Skavicës dhe liqenit gjegjës jo me një digë, por me dy diga, një prej të cilave në Katund të Ri dhe tjetra në Skavicë!. Nga varianti me dy diga, do të duhej të çvendoseshin nga shtëpitë dhe trojet e tyre më shumë se 10.000 banorë, ndërsa nga ai me një digë mbi 40.000 banorë! Eksponentë të tjerë të lartë të vendit, mbështesnin ndërtimin e HC me një digë në Skavicë dhe një liqen të stërmadh, nga pragu i Skavicës në veri deri në pjesën lindore të Dibrës që shtrihet në FYROM në jug, variant që do të fshinte nga harta e Shqipërisë për fare Dibrën londineze! Kjo do të bëhej me alogjizmin absurd se ***"duhej përmbytur një rajon, për të shpëtuar nga përmbytja një rajon tjetër"***!

Në kushtet e mungesës së plotë të transparencës qeveritare lidhur me këtë problem, dëshiroj t'u kujtoj një ndodhi të para 2000 vjetëve në Romën e lashtë atyre që nuk e kanë lexuar Senekën. Filozofi Seneka (4 para Kr.-65 pas Kr.), në vitet e fundit të jetës së tij ishte këshilltar i diktatorit Neron (54-68 pas Kr.). Kur perandori Neron dogji Romën, i frikësuar në palcë nga vala e hakmarrjes popullore, e pyet Senekën se ç'mund të bënte për të shpëtuar kokën nga urrejtja e turmës, dhe ky i fundit e këshilllonte perandorin e tij "***që t'i gënjente romakët"***, pasi ***"populli beson çdo lloj gënjeshtre që i serviret!".***

Më poshtë po parqesim reagimin tonë të fortë kundër këtij projekti, për arsyet e mëposhtme:

Fusha e Dibrës nuk është tokë e krijuar nga tharjet e kënetave apo moçaleve, as me punë angari të të burgosurve politikë. Ajo është trashëguar brez pas brezi, dhe është blerë e shitur me flori. Kjo është arsyeja që në Dibër nuk u zbatua dhe as që mund të zbatohej ligji bolshevik nr. 7501 i vitit 1991.
Përmbytja e Dibrës do të provokonte një lëvizje të madhe demografike dhe do të sillte probleme të mëdha sociale për këtë brez dhe për brezat e ardhshëm.

PËR ARËSYE GJEOGRAFIKE DHE EKOLOGJIKE

Skavica përfaqëson një prag të lartë shkëmbor që ngrihet midis fshatrave Qafë-Draj të Reçit të Dibrës në jug dhe Ujmisht të zonës së Lumës së Kukësit në veri, dhe që në kuptimin gjeografik, ndan pellgun e Peshkopisë nga ai Bicaj-Kukës.

Në gjeomorfologjinë e Shqipërisë dhe të Ballkanit Perëndimor, lugina e Drinit të Zi, përfaqëson padyshim një nga koridoret më të rëndësishme lumore. Pellgu ujëmbledhës i Drinit të Zi me sipërfaqe 5885km^2 përbën bazën e një eko-sistemi mijëvjeçarë. Në shënimet e tij mbi gjendjen në epokën e bronzit, Apolloni i Rodosit e përshkruan Drinin e Zi si***"lumin e thellë e të zi, afër enkelejve"***. Në rajonin e Dibrës shtrihet rrjedha e mesme e luginës së këtij lumi, me një gjatësi prej 75 km, duke filluar nga gryka e Jabllanicës ku ndahet me Strugën në jug deri në pragun e Skavicës në Qafë Draj në veri. Në këtë luginë lumore, si askund tjetër, alternohen pellgjet dhe pragjet lumorë, në një harmonizim të përsosur gjeomorfologjik. Këtu vargmalet lindore e ato perëndimore herë largohen duke të shpalosur para syve fusha të bukura e pjellore, siç ndodh në pellgun e Dibrës dhe në atë të Peshkopisë, dhe herë afrohen dhe të detyrojnë të ngjitesh në qafat kufizuese apo pragjet malorë, siç ndodh në qafën e Qenokut dhe pragun e Dovalanit në jug, apo qafën e Draj-Reçit dhe pragun e Skavicës në veri.

Me luginën e tij gjatësore, ky lum ka krijuar që në lashtësi jo vetem një vend tërheqës për banim, por edhe një arterie të rëndësishme natyrore, që lidh Shqipërinë Lindore me Maqedoninë Perëndimore, Kosovën. si dhe viset fqinje dhe ato më të largëta. Ne rajonin ne shqyrtim, Drini i Zi formon dy pellgjet me te medha te tij, atë të Dibrës (15 x 9 km) me lartësi 400-450 m mbi nivelin e detit dhe atë të Peshkopisë (8 x 6km) me lartësi 300-350m, të ndarë nga pragu i Dovolanit dhe qafa e Qenokut. Falë aluvioneve dhe sedimenteve pjellore te shtresezuara në shekuj, keto pellgje jane mjaft të begatë, dhe përbëjnë zonat më të rëndesishme bujqesore dhe ekonomike të ketij rajoni. Lugina e mesme e Drinit të Zi, është jo vetëm lugina lumore më e bukur dhe më e begatë në Shqipëri, por ndër më të bukurat në botë! Populli i Dibrës nuk do të lejojë përmbytjen e kësaj pasurie të çmuar për asnjë çmim!

PËR ARSYE EKONOMIKE DHE DEMOGRAFIKE

Territori i rrethit të Dibrës ka këtë strukturë tokash: fushat lumore me lartësi 300-600m zënë 13.7% te sipërfaqes, zona kodrinore

opinion

“Hapi i parë në likuidimin e një populli është të fshishë kujtesën e tij historike. Shkatëroni librat e tij, kulturën e tij, historinë e tij. Atëhere vini dikë të shkruaj libra të rinj, të krijojë një kulturë të re, të shpikë një histori të re. Para se të kalojë shumë kohë kombi do të harroj se çfarë është dhe çfarë qe!”.

Argumentet pse kundërshtoj ndërtimin e HEC-it të Skavicës!

paramalore me lartësi 600-1000m zë 30% e saj, malet me lartësi 1000-2000m zënë 53.5% të territorit, ndërsa pjesa tjetër (2.8%) zihet nga malet e larta mbi 2000m. Këto të dhëna janë për pjesën e Dibrës që shtrihet në Republikën e Shqipërisë. Pra tokat më të mira të këtij rajoni, të tipit aluvional, me strukturë pedologjike mjaft pjellore, gjenden anash shtratit të Drinit të Zi, dhe do të asgjësoheshin përgjithmonë nga realizimi i këtij projekti. Ndërtimi i HC të Skavicës, pavarësisht nga numri i digave, do të sillte mjaft pasoja negative social-ekonomike dhe kulturore, por mbi të gjitha ai do të përmbyste përjetësisht një nga zonat më të rëndësishme të Shqipërisë Lindore, siç është pellgu i Dibrës.

Së pari, asgjësimi përfundimtar i pjesës më pjellore të tokës së Dibrës, do t’i hiqte asaj bazën e nevojshme ekonomike që e ka mbajtur popullsinë dibrane aty prej më shumë se 8000 vjetësh. Fusha e Dibrës historikisht ka qenë hambar për Malet e Dibrës, dhe të dy këto njësi të saj kanë qenë përherë në mardhënje komplementësie ekonomike njera me tjetrën. Fusha e Dibrës e furnizonte Malësinë me drithra buke dhe merrte prej saj prodhime drusore e blektorale etj. Në vitet më të vështira të krizës së bukës gjatë luftës I botërore, përkatësisht kohën e pushtimit serb (1913-1921) dhe atij austro-hungarez (1915-1916), hambarët e Dibrës nuk u thanë nga drithi, përveçëse u dogjën nga hasmi. T’i heqësh Dibrës këtë pjesë organike të saj, ta gjymtosh atë, është sikur t’i presësh gjymtyrët trupit të njeriut. Dhe unë besoj se qeveria do ta rishqyrtojë këtë çështje jetike për Dibrën. Dibra nuk mund të flijohet dhe të sakrifikohet për të shpëtuar të tjerët, edhe pse ajo i ka ndihmuar gjithnjë të tjerët, kur ata kanë pasur nevojë. Në këtë kontekst mjafton të kujtojmë se vetëm dibranët qëndruan përkrah shkodranëve, kur Shkodra ishte rrethuar nga pushtuesit malazez në vitin 1912-1913 (10 tetor1912-22 prill 1913)! Ideja e përmbytjes së Dibrës për të shpëtuar Shkodrën, mizore dhe neveritëse në vetvete, të kujton “këshillat” e Dr. Adhamudhit, që për të shpëtuar njerin sy duhej të nxirrej tjetri!

Së dyti, duhet të kujtojmë se fusha e Dibrës nuk është tokë e krijuar nga tharjet e kënetave apo moçaleve, as me punë angari të të burgosurve politikë. Ajo nuk përfshihet në këto kategori. Ajo është trashëguar brez pas brezi, dhe është blerë e shitur me flori. Kjo është arsyeja që në Dibër nuk u zbatua dhe as që mund të zbatohej ligji bolshevik nr. 7501 i vitit 1991.

Së treti, përmbytja e Dibrës do të provokonte një lëvizje të madhe demografike dhe do të sillte probleme të mëdha sociale për këtë brez dhe për brezat e ardhshëm.

PËR ARSYE ARKEOLOGJIKE

Si arkeolog më duhet të mos heshtë! Si arkeolog kam shkelur në çdo fshat të Dibrës! Si arkeolog i them me bindje **JO SKAVICËS**! E them këtë pasi nëntoka e Dibrës ruan në gjirin e saj vlera të jashtëzakonshme arkeologjike, të cilat sapo kanë filluar të zbulohen e të studiohen. Në bazë të studimeve të derisotme, rezulton se ky është një ndër rajonet më të përshtatshëm gjeografiko-topografik, me kushte jetësore optimale për jetesë, gjë që ka përcaktuar



“Kodra e qytetit” (Zall-Sinë), një vendbanim eneolitik. Foto: A.Bunguri.

edhe hershmërinë e banimit të tij nga njerëzit që në prehistorinë e largët. Lugina e mesme e Drinit të Zi, territorialisht e lidhur me këtë rajon, përfaqëson zonën ku janë evidentuar gjurmët më të hershme të qytetërimit neolitik në Shqipëri, kronologjikisht të lidhur me gjysmën e dytë të mijëvjeçarit të VII para Kr. Fshatrat më të hershëm neolitikë të këtij rajoni dhe ndër më të hershmit në Shqipëri janë Burimi, Cetushi, Kronëzat (Fushë-Alie), prej të cilave, dy të fundit përfshihen brenda kuotave të përmbytjes, pasi janë shumë afër bregut të djathtë të Drinit të Zi.

Nëpër këtë luginë kalonte degëzimi verior i Egnatias antike, që bashkonte dy tranversalet më të mëdha tranballkanike, atë Egantia në jug (Ohër) dhe atë Lissis-Naissus në veri (Kukës). Në zonën e përfshirë nga harta e liqenit të HC të Skavicës do të përmbyteshin përgjithmonë, pa u prekur nga arkeologët, një arkiv i vërtetë vlerash dhe artefaktesh arkeologjike, që gjenden në këtë hapësirë. Duke filluar nga Skavica, pra nga veriu, e duke u ulur në drejtim të jugut, mund të përmendim sitet arkeologjikë të rrezikuara nga përmbytja:

- Zona tumulare e Draj-Reçit e periudhës së Hekurit (lagja “Troci”)
- Zona tumulare e e periudhës së Hekurit e Zall-Dardhës (Majë Meje)
- Vendbanimi eneolitik “Kodra e qytetit” (Zall-Sinë)
- Vendbanimi neolitik në Kronëza (Fushë-Alie)
- Stacioni rrugor romak në “Xhirret e Përnezhe” (Fushë-Alie)
- Vendbanimi prehistorik në “Rrokoçele të Kutës”, Blliçe (Fushë-Alie)
- Vendbanimi prehistorik në “Kodra e Ferrës” në Blliçe (Fushë-Alie)
- Vendbanimi prehistorik në “Kodra e Pareve” në Blliçe (Fushë-Alie)
- Vendbanimi prehistorik “Kodra e Gështenjës (Kalaja e Gjonit”(Kastriot)
- Trakte të degëzimit verior të Egnatias (Terzishte)(Kastriot)
- Vendbanimi mesjetar në Trezishte (Kastriot)
- Venbanimi prehistorik i Cetushit (Cetush)
- Vendbani i prehistorik i Gradecit (Brezdan)
- Vendbanimi prehistorik në “Kodra e Ballës” në Muhur (Muhur)
- Vedbanimet prehistorike dhe antike të Ushtelenzës(Ushtelenzë)
- Vendbanimi prehistorik i Bronzit të Hershëm (Selane)
- Kisha mesjetare në Katund të Ri (Katund i Ri)
- Vendbanimi antik dhe mesjetar i Gradecit (Gradec-Dovalan)
- Vendbanimi prehistorik dhe antik i Topojanit(Podgorcë)
- Vendbanimi prehistorik “Tuma e Zojcës” (Mazhicë)
- Nekropoli i periudhës romake në Gjoricë të Poshtme (Gjoricë)
- Vendbanimi i periudhës romake në Gjoricë të Poshtme (Gjoricë)
- Manastiri i Thatokut (Okshatinë)
- Kalaja ilire e Tuçepit ose Lladomericës (Lladomericë) etj.

Kjo do t’i shkaktonte një dëm të madh shkecës sonë arkeologjike. Nga ana tjetër ajo do të plotësonte dëmin e krijuar në pjesën lindore të Dibrës, që shtrihet në territorin e FYROM, ku në vitin 1968 u përmbyt përjetësisht fusha e Udovës, më e madhja dhe më pjellorja e pellgut të Dibrës. U krye me atë rast një gërmim i vogël shpëtimi, sa për të thënë, dhe u varrosën nën ujë vlera të pallogaritshme arkeologjike. U përmbytën përjetësisht vlerat e një qytetërimi të lashtë ilir. Vendbanimi i periudhës urbane gjendej reth 2km në lindje të qytetit të Dibrës, poshtë rrugës së dikurshme Dibër-Shkup, në krahun e djathtë të lumit të Radikës. Para se kjo fushë e madhe të përmbytej nga ujrat e liqenit të hidrocentralit të Spilesë (Dibër) (1964–1968), gjatë gërmimeve të shpëtimit të kryera aty, arkeologja V. Bitrakova-Groždanova jep informacionin e parë dhe të fundit arkeologjik. Sipas saj, “**aty janë zbuluar mjaft objekte arkeologjike të periudhës së hekurit dhe asaj urbane, si dhe themele banesash e vilash rustica, të ndërtuara me gurë e llaç, pitosa qeramike si dhe 14 varre të ndërtuara me tulla të tiptit “çati dyujëshe” të periudhës së sundimit romak (shek.III-IV pas Kr.)”.** Në interpretim të këtij materiali, ajo arrin në përfundimin se “***në Udovë gjendet një vendbanim i madh me kontuinitet nga koha e hekurit deri në mesjetë”,*** (V. Bitrakova-Groždanova, *Prilog kod antičkata istorija na Debarskiot* kraj, Skopje 1966, 199-201).

Pikërisht në këtë vend, e mendojmë edhe lokalizimin e qytetit ilir të Oaeneas, qytetit më të fortifikuar penest, pranë lumit Artatus (Radicis) dhe një mali të mezikalueshëm (Kërçini-pjesë e “Scardus mons”), një nga tre qytetet më të zhvilluara peneste, krahas kryeqendrës së Penestisë-Uskana (Kërçovë), dhe Draudakut (Gradec-Gostivar). Burimet antike (Polibi, Livi) përmendin krahas tyre edhe 11 qyteza peneste në këtë rajon. Ato dëshmojnë se qyteti i Oaeneas luajti një rol të rëndësishëm në luftrat mbrojtëse si kundër Perseut të Maqedonisë ashtu edhe konsullit Ap Claudi të Republikës së Romës në vitin 169 para Kr., në përpjekje për të ndaluar kthimin e Adriatikut në një “*mare nostro”*.

PËR ARSYE HISTORIKE

Është theksuar shumë kohë më parë roli i rëndësishëm i Dibrës dhe kontributi i saj i veçantë në historinë nacionale, në të gjitha etapat e zhvillimit historik e shoqëror. Përmbytja e saj do të thotë përmbytje e të gjithë kësaj historie. Një moment i lavdishëm i saj është padyshim epopeja Skënderbejane e mesit të shek. XV, dhe luftërat e tij fitimtare, atdheu historik i të cilave, është vetë Dibra, ku Skënderbeu zhvilloi 19 nga 24 betejat e tij. Pikërisht kjo Dibër tani rrezikohet nga përmbytja! Me këtë veprim të nxituar, zhduket ose përmbytet përjetësisht një pjesë e territorit hapësinor të kësaj epopeje!

Urrejtja ndaj Dibrës e dibranëve u shfaq sidomos gjatë luftërave për pushtimin e Dibrës në vitet 1912-1921. Ofensiva serbe e tetorit 1913 dhe ajo e vitit 1918, nuk lanë fshat të Dibrës pa djegur dy e tri herë. Pushtuesit serbë me sadizmin e pashoq dhe taktikën e *“tokës së djegur”*, kryen në këtë hapësirë masakra nga më të tmerrshmet, që mund të imagjinohen nga mendja njerëzore. Nuk ka pëllëmbë të tokës dibrane që nuk u skuq nga gjaku i bijëve të saj, në mbrojtje të vatanit! Këto janë të dokumentuara në arkivat e kohës, në memorien popullore, por edhe në toponimet e shumta të kësaj periudhe si “vorret e vrame”, “vorret e serbit”, “vorri i gruas”, “vorri i nuses”, “vorret e cullve” etj, që tani duam t’i mbysim përjetësisht nën ujrat e liqenit dhe t’i fshijmë nga kujtesa historike. Ndërsa shkruaj me nervozizëm këto radhë, më vjen në mendje postulati therrës:*“***Hapi i parë në likuidimin e një populli është të fshishë kujtesën e tij historike. Shkatëroni librat e tij, kulturën e tij, historinë e tij. Atëhere vini dikë të shkruaj libra të rinj, të krijojë një kulturë të re, të shpikë një histori të re. Para se të kalojë shumë kohë kombi do të harroj se çfarë është dhe çfarë qe!”.***

PËR ARSYE GJEO-STRATEGJIKE

Është vështirë të mendohet, por përmbytja e Dibrës të duket si një plan i hartuar jo në Tiranë, por në kancelaritë e Serbisë që donin ta përfshinin Dibrën brenda kufijve të tyre dhe që kërkonin të vinin kufirin e tyre përgjatë Drinit, ose në vargun e maleve perëndimore të Dibrës, ndërsa qëllimi i tyre strategjik ishte dalja në Durrës!. Mjaft të sjellim ndër mend faktin se “**Naçertania”** famëkeqe e I. Garashaninit (1844), parashikonte edhe ***“aneksimin e trojeve shqiptare të Vilajetit të Kosovës si dhe të pjesëve veriore dhe qëndrore të Shqipërisë”.*** Një pjesë e këtij plani ogurzi realizohet në vitin 1913, kur thika e ftohtë e diplomacisë evropiane ndante trupin e

(Vijon në faqen 6)

Argumentet pse kundërshtoj ndërtimin e HEC-it të Skavicës!

(Vijon nga faqja 5)

Në të gjithë botën e qytetëruar, para se të merren vendime të tilla që ndikojnë drejtpërdrejtë në ekosistemin e një rajoni të dhënë dhe në jetën e mijëra banorëve, organizohen referendume popullore. Pasi një qeveri e përgjegjshme, punon për interesat themelore të qytetarëve të vet. Atëherë, përse të mos bëhet një referendum me banorët e Dibrës dhe pastaj të vendoset, pro ose kundër?! Të gjithë e dimë mirë dhe qeveria e di edhe më mirë, se në pikëpamje juridike, sikur qoftë edhe një pronar i vetëm i zonës së përmbytur, të mos jap pëlqimin e tij, asnjë HC nuk mund të ndërtohet!

Dibrës me qetësinë e ndarjes së një torte në tavolinën e ngrënies, dhe i shkëputste atij qytetin e Dibrës me rrethinë, Rekën, Radikën, Udovën, Kosovrastin, Zhupën dhe tokat më pjellore të pellgut të Dibrës!

Është e tepërt të kujtoj se për kontributin e çmuar në historinë tonë nacionale gjatë të gjithë periudhave historike, Dibra Lindore, politikisht e përfshirë në FYROM, gjatë shekullit të fundit është trajtuar me urrejtje nga qeveritë sllavo-ortodokse të Beogradit dhe të Shkupit!. Të gjitha veprimet e kryera atje janë pjesë e një plani tërësor dhe të mirëorganizuar nën frymën çubriloviçiane për shpopullimin dhe shkombtarizimin e Dibrës. Është e tepërt të kujtoj se me këto qëllime të mbrapshta ishte përmbytur nga pushteti sllavo-maqedonas edhe pjesa lindore e Dibrës dmth fusha e madhe e Udovës në Dibrën e Madhe (FYROM) me sipërfaqe 1340ha, me pretekst të ndërtimit të HC të Spilesë!. Me përmbytjen e kësaj fushe të bekuar nga qarqet nacional-shoviniste të Beogradit u thuhej dibranëve të Dibrës së Madhe të iknin nga të donin, vetëm në Dibër të mos rrinin, se Dibra u duhej atyre, të pavatanëve, ardhacakëve të stepave!

Pyetja që shtrohet në këtë kontekst social-historik është: përmbytja e sotme e Dibrës së mbetur londineze, me ose pa dashje, a nuk duket se i ngjan, qoftë edhe formalisht, këtyre planeve antishqiptare?! Çfarë do t'u thuhet dibranëve të Dibrës Perëndimore?! Të iknin edhe ata, nga sytë këmbët, se tokat e tyre do të t'i përpijë liqeni i alogjizmave të ekonomisë!

Në fund një sugjerim: përse nuk studiohen mundësitë e prodhimit alternativ të energjisë, siç është p.sh energjia diellore apo ajo e erës, dhe të ndiqet modeli gjerman apo austriak i shfrytëzimit të saj?! Me pak investim fillestar, qoftë edhe me koncension, por pa humbur asnjë m^2 tokë dhe pa asnjë pasojë ekologjike?!

PËR ARSYE KLIMATIKE

Tek arsyet klimatike vetëm do të përmendja prishjen e ekosistemit natyror si dhe faktin se rritja e sipërfaqes së pasqyrës ujore do të rriste menjëherë lagështirën absolute dhe relative të ajrit, e cila do të ndikonte drejtpërdrejtë në ritjen e sëmundjeve reumatizmale dhe artriteve tek popullata aktive për punë, ajo e re dhe e mesme, madje dhe tek fëmijët, që sapo të dilnin në rrugë do të ndesheshin me mjegullën dhe ajrin e lagësht që do të vinte nga pasqyra e liqenit të stërmadh të HC të Skavicës.

PËR ARSYE JURIDIKE

Në të gjithë botën e qytetëruar, para se të merren vendime të tilla që ndikojnë drejtpërdrejtë në ekosistemin e një rajoni të dhënë dhe në jetën e mijëra banorëve, organizohen referendume popullore. Pasi një qeveri e përgjegjshme, punon për interesat themelore të qytetarëve të vet. Atëherë, përse të mos bëhet një referendum me banorët e Dibrës dhe pastaj të vendoset, pro ose kundër?! Të gjithë e dimë mirë dhe qeveria e di edhe më mirë, se në pikëpamje juridike, sikur qoftë edhe një pronar i vetëm i zonës së përmbytur, të mos jap pëlqimin e tij, asnjë HC nuk mund të ndërtohet! Dhe meqë jemi tek binomi qytetarë-qeveri, më vjen në mendje postulati i gazetarit të njohur amerikan Eduard R. Murrow ***"A nation of sheep will beget a government of wolves".*** Përkthimin e saj në shqip unë nuk do ta bëj, pasi sot anglishten e njohin pjesa dërmuese e brezit të ri dhe e intelektualëve, dhe ky përkthim praktikisht është i panevojshëm.

NË VEND TË MBYLLJES

Më në fund, unë nuk i kuptoj dibranët që nuk po e kuptojnë apo nuk duan ta kuptojnë "dashurinë" e madhe të qeverisë së tyre për Dibrën dhe trashëgiminë e saj historike e kulturore! "Dashuria" e qeverisë është kaq e madhe, sa që kërkon përmbytjen e përjetshme të vetë Dibrës dhe të historisë së saj! Në emër të kësaj "dashurie" kërkohet të ndryshohet deri edhe harta gjeografike e Shqipërisë Lindore, ku vendin e tokave më pjellore të Dibrës do t'a zë liqeni i HC të Skavicës! Në emër të kësaj "dashurie" po shtyhet për në kalendat greke edhe ndërtimi i "Rrugës së Arbërit"! Sepse qeveria plasi nga marrazi që t'i bëj "alpinët" dibranë të mësohen me turizmin liqenor! Ajo po kërkon ta bëj Dibrën një "Zvicër" të vogël! Ku është problemi këtu?!

Por dibranët nuk duan që nuk duan të kuptojnë këtë qëndrim "dashamirës" të qeverisë ndaj Dibrës! Ata duket se e kanë kuptuar gabim ose nuk e kanë kuptuar edhe thelbin e mosndërtimit të "Rrugës së Arbërit"! Disa thonë se premtimet për ndërtimin e kësaj rruge strategjike ishin "lojë"!. Disa thonë se fajin për këtë e kishte qeveria e Kinës! Disa të tjerë thonë, se edhe po të mos e kishte qeveria kineze, pra kushdo që ta kishte fajin, kjo rrugë tashmë nuk u duhej, pasi, në vend të udhëtimeve të lodhshme nëpër lugina, qafa e gryka malesh, shumë shpejt, në saj të "dashurisë" qeveritare, dibranët do të lundronin me varka!

Edhe pse mjaft idilike, njerëzit e thjeshtë nuk duan që nuk duan të kuptojnë se qeveria po punon me zell të madh, për të bërë të mundur, që dibranët punëtorë dhe të mençur, t'i zevendësojnë veturat me varka! Të shkojnë tek njeri tjetri me varka! Të shkojnë në punë me varka! Të dalin në pazar me varka! Të dalin shëtitje me varka! Të shkojnë edhe në dasëm me varka! Po, po! Shumë shpejt do të vijë dita që dibranët edhe dasmat t'i bënin me varka! Imagjinoni, krushqit me dhëndërin dhe nusen të hipur nëpër varka! Dhe tani e tutje dhëndurët dibranë, përveç patentës së veturës do të duhet të marrin edhe patentën e drejtimit të varkës! Meqë çdo dhëndër i ri është drejtuesi i një familjeje të re, ai duhej të ishte i përgatitur si për sfidat e lundrimit ashtu dhe për dallgët e jetës! Dhe mendjengushtët do ta kuptojnë më në fund se kështu do të lulëzojë biznesi i varkave! Se kështu jeta e popullit do të përmirësohet!

Sipas adeptëve të variantit me një digë, Dibra do të shëndrohej në një liqen të stërmadh, me shtrirje nga pragu i Skavicës dhe Draj-Reçi në veri deri në Miresh e Viçisht në jug. Por, prisni, s'keni parë gjë akoma! Shumë shpejt do të vijë dita, që më të kamurit e dibranëve, do të blejnë edhe ndonjë jaht, madje ta nisin atë direkt nga bodrumi i vilës së ndërtuar ngjitur me liqenin imagjinar. Atëherë nuk do të jetë më në modë ndërtimi i garazheve të veturave në katin përdhes të vilave, por çdo vilë do të duhej pikësëpari të ndërtohej buzë liqenit dhe të kishte si pjesë organike të saj, garazhin e jahtit! Pse çfarë kishin më tepër stambollinjtë e kamur, që dalin për çdo ditë në Bosfor me jahtet modernë direkt nga bodrumi i vilave të tyre! Nën shembullin e stambollinjëve, edhe në Dibrën liqenore do të lulëzonte biznesi i kafeneve dhe çajtoreve në lokalet e shumtë në të dy brigjet e liqenit të Skavicës! Dibranët do të duhet ta kuptojnë se në fund të fundit, nuk ka ndonjë ndryshim të madh në do ta pije kafen apo çajin në Bosfor, në Uskudar, në Dollma Bahçe, në Top Kapi apo në lokalet e brigjeve të liqenit të Skavicës! Por dibranët nuk duan që nuk duan të kuptojnë se qeveria është duke punuar për "të mirën" e tyre, që t'i "akulturojë" dibranët "alpinë", të vështirë për t'u "akulturuar"! Pastaj, a nuk e kanë krahasuar Dibrën me Stambollin?! Asnjë qeveri deri më sot nuk ka mundur t'ia përafrojë Dibrën Stambollit, dmth që Dibra t'i përngjasoj Stambollit edhe gjeografikisht, pra të ndahet në mes nga një liqen i stërmadh! Anipse dibranët nuk duan që nuk duan t'a kuptojnë qeverinë e tyre!

Idhtarët e variantit me dy diga ngulnin këmbë se Dibra do t'i ngjajë më tepër Venecias se sa Stambollit, pasi në Venecia banorët lundronin me varka të vogla e të shpejta në trajtë "lembesh" ilire. Meqenëse hëpërhë, arsyetonin ata, ekonomia ishte në pikë të hallit, dibranët nuk do të mund të blinin jahte të shtrenjtë, siç i kishin stambollinjtë e kamur, por ama mund të blinin, qoftë edhe me kredi, disa varka të vogla të tipit venecian, sa për të plotësuar nevojat e ditës! Ky argument i bënte të heshtnin idhtarët e modelit Stambollian!. Të entusiazmuar nga kjo mekje e rrymës kundërshtare, mbrojtësit e modelit venecian të Dibrës, sillnin në kujtesë deri edhe miqësinë e shtetit mesjetar të Skënderbeut me Republikën e Venedikut! Sipas tyre, meqenëse Heroi ynë kombëtar Gjergj Kastrioti Skënderbeu ishte me origjinë nga Dibra, përkatësisht nga Dibra e Poshtme që parashihet të përmbytet, atëhere pikërisht kjo Dibër do të duhej të përmbytej që t'i ngjante Venecias!

Kishte dhe nga ata që në të gjithë këtë zallamahi mendimesh, shihnin anën pozitive të çështjes, ose siç do të thonin anglezët, e shihnin "gotën e zbrazët plot"! Ata ngulnin këmbë tek komercializmi i peshkimit që do të zhvillohej në këtë liqen të stërmadh, mirëpo kjo pikëpamje nuk e kishte kaluar sitën e hollë të mendjes së mprehtë të dibranëve! Disa skeptikë mendonin se pas kësaj fshihej plani tinzar i qeverisë për t'i zënë gafil dibranët që nuk do të prisnin kuponin tatimor të peshkut! Disa thonin se nuk dihet se çfarë mund të ndodhte deri atëherë me buajtë e majmur që mezi tërhiqnin karrocën qeveritare dhe nuk ishte çudi që ata mund të ndërroheshin me buajë të tjerë më të freskët! Disa të tjerë, të lodhur nga hamendësimet, tashmë kishin kërkuar azil në Zvicër, Gjermani dhe Amerikë! Sido që të jetë, këto llogari për shumicën e dibranëve duken shumë të parakohshme, pasi ata kurrë nuk e vënë tiganin në zjarr, deri sa peshku është në det. Jeta i ka mësuar se më parë duhet të kapet peshku dhe pastaj të vihet tigani në zjarr. Dhe me atë qetësinë e tyre, të thonë se në atë liqen (**në se ata do ta lejojnë të bëhet!)** ata kurrë nuk do të mundnin të zinin peshq!. Sepse kryetari i dhomës së licensave të peshkimit, ishte kujdesur që **"rasati i peshkut të ishte prej atij farësoji, ku peshqit të hanin njeri tjetrin!".** Ec e merri vesh këta dibranët që nuk duan t'a kuptojnë as qeverinë e tyre dhe as "prosperitetin" që u ofrohet duke ua përmbytur shtëpitë dhe trojet stërgjyshore! E megjithatë, ata janë të vendosur që kjo të mos ndodhë! Pasi nuk duan të bredhin nëpër Shqipëri, si çifutët në shkretëtirë, në kërkim të "Jeruzalemit" të tyre!

**Titulli origjinal: "Jo Skavicës!", gazeta "Panorama", 6.3. 2016, f. 24 dhe "Le të "përmbytet" Dibra, gazeta "Panorama", 30.03. 2016, f. 16.*



"Po Dibrës! Jo Skavices" është një botim i gazetarit Abdurahim Ashiku, i cili trajton në një këndvështrim ndryshe problemet historike, mjedisore, turistike dhe prespektivën e zhvillimit ekonomik të rajonit të Dibrës. Në libër analizohet vendimet për të mbytur Luginën e bukur të Drinit të Zi, lugina më e madhe malore shqiptare pas asaj të Devollit në Fushën e Korçës, mbytje nëpërmjet hurdhës së Skavicës, mbytje me "Me forcat tona".
Autori, njohës i mirë i trevës historike të Dibrës, njohës i natyrës, i burimeve ujore energjetike, i potencialeve të mëdha bujqësore e blegtorale, i natyrës turistike të jashtëzakonshme... argumenton se mbytja e Dibrës nëpërmjet liqenit të Skavicës është krim jo vetëm historik por edhe ekonomik e social.
Përkundër Skavicës ai u ofron specialistëve ndërtimin e hidrocentraleve të vegjël e të mesëm mbi kanalet e shumta malore ujitëse dhe mbi degët e Drinit të Zi, potenciali energjetik dhe ujor i të cilëve është sa ai i liqenit të Skavicës në mos më i madh. Në këtë kënd vështrimi treva e Dibrës, që nga ana gjeografike është "Qendra Gjeografike e Shqiptarëve" shndërrohet në një vend agraro-turistik të rrallë, falë natyrës së saj me liqene natyrorë e bjeshkë pa fund.

Veli Torba vazhdon e vazhdon të punojë, të sfidojë kohën e tokën.

Veli Torba, fermeri që nuk di të ndalet

Nga **OSMAN XHILI**

Ai nuk arriti te shkojë më shumë se shkollimi i mesëm, ndonëse dëshirat i kishte të mëdha. Bile dhe atë e mbaroi, pa shkëputje nga puna, pasi duhej të ndihmonte familjen e tij të varfër, siç ishin të gjitha familjet e asaj kohe. Linte pas fshatin e tij të bukur malor e derdhej fushave poshtë me një çantë të thjeshtë në sqetull, me pak libra e fletore në të, por me shumë dëshira e ambicie për të ardhmen.

Një sfidë e re për të pas viteve nëntëdhjete. Veliu ishte kacavjerrë në rrjedhat e jetës si një pelivan i vërtetë dhe donte te mbahej aty me çdo kusht. Nuk shkoi në emigrim si shumë të tjerë. Donte ta ndërtoje aty folenë e tre fëmijëve, që po vinin njëri pas tjetrit. Aty te kulla gati 200 vjeçare, aty ku kishin punuar e jetuar të parët e tij në breza. Prodhoi misër e fasule, rriti lopë e viça, por më së shumti u muar me perime. Domate, speca, patate, qepë e çdo gjë tjetër, që ajo tokë e bekuar e prodhonte në sasi e cilësi. Me gjithë vështirësitë e tregut, të rrugës e ndonjëherë të thatësirës, ai ia doli të jetojë e të shkollojë dhe fëmijët, duke plotësuar pengun që i kishte mbetur nga vetvetja.

Kaluan vite dhe Veliu, krahas perimeve e hodhi shikimin nga frutikultura. Mbolli 250 rrënjë qershi, që i ka në vitin e pestë të prodhimit. Ndonëse, akoma të reja, ai i gëzohet prodhimit të parë, ku vitin e kaluar mori gati një milionë lekë. Mbolli dhe arra, gati njëqind rrënjë, që janë mjaft të shëndetshme e premtojnë ta shpërblejnë në të ardhmen. Ka dhe kumbulla të tipit Stanley dhe pak mollë, të cilat i ka më shumë për vete dhe miqtë e tij, që e vizitojnë shpesh. E vështirë për tu shpjeguar se si ky njeri me vullnet të hekurt, në gjithë këto vite, kishte mbajtur familjen, kishte shkolluar fëmijët e për më tepër kishte blerë dhe 14 dynymë tokë pjellore, të cilën po e menaxhonte më së miri.



Shimçani është një fshat i bukur, pjesë e një shtegu turistik, që të çon në Bahute, Zagrad, e më tej akoma, për të vizituar vende të mrekullueshme. Ndonëse ka plot të larguar nga fshati, por ka akoma të tjerë si Veli Torba, që punojnë e jetojnë duke besuar se ky fshat do të bëhet, se Dibra do të bëhet, se Shqipëria do të zgjohet nga gjumi e do të përparojë, si shoqet e saj.

Pak vite më parë një tjetër emër, një tjetër dritë u shfaq para fermerëve. Paulonia do të ishte ajo bimë e pemë çudibërëse, që do ngjallte shpresë, kur shumë gjëra ishin venitur, si meteorë në perëndim. Veliu nuk nguroi ta eksperimentonte në tokat e tij. Para katër vitesh mori 500 fidanë nga Italia me dhjetë mijë lekë fidani. Kishte në treg dhe më të lirë, por ai zgjodhi llojin më të mirë, me shpresën se nuk do ta zhgënjente. Pas një viti rritje të bujshme u bëri prerjen teknike dhe në dy vite të tjerë ata kanë kapur lartësinë mbi tetë metra. Vitin tjetër e shtoi sasinë e mbjellë me 700 fidanë të tjerë, duke e çuar shifrën në 1200. E përkthyer në sipërfaqe, asaj i korrespondojnë 15 dynymë tokë.

Pas euforisë së viteve të para, personalisht e kisha humbur besimin se kjo bimë është me vlerë për fermerin, të paktën në Dibër. Por, kur pashë atë lloj të bukur të paulonias, kur pashë ato bimë që zgjateshin e harliseshin drejt qiellit, mendova pak më ndryshe. Mendova që si për shumë punë të tjera të bukura dhe këtu Veli Torba nuk kishte gabuar.

E ndoqëm Veliun, duke na treguar parcelat, si turisti ciceronin dhe u mrekulluam nga ata që pamë e dëgjuam. Në vitin e parë ta paulonias, ai kishte mbjellë dhe patate, në të njëjtën sipërfaqe, duke marrë në dy dynymë rreth 100 kuintalë. Po kështu kishte shfrytëzuar tokën dhe vitin e kaluar me perime, duke marrë në tre dynymë të tjerë 150 kuintalë domate. Dy parcela të mbjella me paulonia nuk kishin pasur rrugë, për të shkuar atje. Një pjesë të rrugës e kishte hapur me krahë dhe një pjesë tjetër me fadromë, duke bërë të mundur të shkojë atje me mikrobuzin, që e shfrytëzon prej 20 vitesh. Nuk ishte pak, por një kilometër, për të shkuar deri te parcela fundore. Aty, diku në mes të rrugës, ka hapur dhe një basen të vogël, me kapacitet gati 50 metër kub ujë dhe kjo i mundëson vaditjen e pemëve, sa herë që ajo është e nevojshme. Është kjo një metodë nikoqire, që të parët tanë e kanë përdorur më së miri e tani është humbur e tretur në kohë.

Shumë punë të fermës së tij, Veliu i bën vetë, por në situata të pranverës e të verës, ai merr dhe të tjerë për punime, plehërime e shërbime të tjera, duke dhënë kështu një kontribut të çmuar në fshat. Vajza e vetme e Veliut është e martuar dhe punon pranë bashkisë së Peshkopisë, si financiere. Dy djemtë, Mefati dhe Ganiu, kanë pak vite, që janë larguar drejt Anglisë. Ata i kanë thënë babai të tij të mos punojë më, se mjaft është lodhur e tani duhet të pushojë pak. Kanë blerë si familje dhe dy apartamente në Tiranë, për të dy djemtë, nëse kthehen në Shqipëri. Të gjitha këto nuk janë arsye të mjafta që ta ndalin heroin tonë. Ai vazhdon e vazhdon të punojë, të sfidojë kohën e tokën. Pasioni për punën, i ngjizur që në rini dhe nuk i shqitet më, sado t'i afrosh kapitale e vlera financiare.

Shimçani është një fshat i bukur, pjesë e një shtegu turistik, që të çon në Bahute, Zagrad, e më tej akoma, për të vizituar vende të mrekullueshme. Ndonëse ka plot të larguar nga fshati, por ka akoma të tjerë si Veli Torba, që punojnë e jetojnë duke besuar se ky fshat do të bëhet, se Dibra do të bëhet, se Shqipëria do të zgjohet nga gjumi e do të përparojë, si shoqet e saj.


BOTIM I RI

Përcjellje për artin e Jahe Delisë

Nga **FEJZULLA GJABRI**

Duke lexuar materialet e këtij vëllimi, që nga reportazhet, studimet, portretet e deri te mendimet e të tjerëve për shkrimet e autorit, pa ndrojtje mund ta ndajmë në dy pjesë: shkrimet e autorit për vendlindjen me njerëzit dhe natyrën e saj, ku dominon ndjenja e dashurisë për ta, e në vijim me portretet e të tjerëve. Pra, na paraqitet Unë (Jahja) dhe Tjetri (të tjerët rreth apo më larg tij). Ky koncept tingëllon si filozofik, por në fakt, së pari e ka përdorë populli e më pas janë marrë filozofët, shkrimtarë e poetë. A nuk ia hapim derën (të njohurit apo udhëtarit, kurdo, natë apo ditë qoftë? Po sa shprehje e fjalë të urta ka për mikun (të njohur e të panjohur)! Duke lexuar këto shkrime të Jahes, ku Jahja shkuan portrete për të tjerët dhe të tjerët shkruajnë për Jahen, pa dashje mendja të shkon te trajtimet filozofike të këtyre nocioneve, tek "Unë dhe Tjetri", trajtuar nga filozofë të njohur botërorë.

Autori është mësues në profesion dhe, si i tillë, puna e ka lidhë me tipa të ndryshëm shoqërorë, me moshë e me zhvillim të ndryshëm. Në këto anë, tjetri (udhëtari, miku, i njohuri e aq më shumë i panjohuri) vlerësohen në shkallën më të lartë. Kjo traditë bie në sy edhe në këto shkrime. Nëpër shkrimet e Jahes, tek 'Uni' gjejmë atë 'Unë' që i do të tjerët, atë 'Unë' që njeh botën e tjetrit, që, jo vetëm e njeh, por edhe e do. Kjo shihet qartazi në shkrimet e tij. Ka shkrime për veten dhe veprimtarinë e tij. Megjithatë, po ta vësh re, këto shkrime në formë kujtimesh, kanë në qendër ngjarjet me veten dhe (të tjerët njëjës apo shumës).



RADOMIRA JONË / Jahja Delia Selmani
Botimet M&B, 2020/ ISBN: 978-9928-307-40-8
Faqe 368 / Çmimi: 700 lekë

Duke legjitimuar veten, me mendimet e tij, si vëzhgues e si veprimtar, nuk e ndan tjetrin nga vetja, përkundrazi, na e paraqet me dritë. Përshkrimet e artistëve, të drejtuesve popullorë, të kolegëve dhe të të dashurve të tij, plot nuanca lavdërore, Jahja komunikon jo vetëm me publikun e sotëm, po veçanërisht me të ardhshmin. Në mënyrën e shkrimeve dhe përshkrimeve jep një copë histori, një copë realiteti në një kohë të caktuar.

Shkrimet e Jahes, sikur lidhin brezat. Kjo lidhje vjen natyrshëm nëpërmjet përshkrimit të vendlindjes, qëllim madhor i tij. Transmetimi i vlerave të trashëgimisë te brezat e rinj ka qenë një proces me rëndësi të veçantë për të moshuarit, në mënyrë që të sigurohet mbijetesa kulturore. Për këtë, më së shumti, dikur shërbenin odat e miqve. Sot sikur ndodh ndryshe. Mjetet e informimit dhe, veças, ato elektronike po zbehin trashëgiminë apo transmetimin gojor. Edhe pse këto mjete dhe rrjetet shoqërore luajnë një rol dominues, përvoja e drejtpërdrejtë e më të moshuarve mbetet e vlefshme, veçanërisht për të rinjtë.

Shkrimet e Jahes, sikur lidhin brezat. Kjo lidhje vjen natyrshëm nëpërmjet përshkrimit të vendlindjes, qëllim madhor i tij. Transmetimi i vlerave të trashëgimisë te brezat e rinj ka qenë një proces me rëndësi të veçantë për të moshuarit, në mënyrë që të sigurohet mbijetesa kulturore. Për këtë, më së shumti, dikur shërbenin odat e miqve. Sot sikur ndodh ndryshe. Mjetet e informimit dhe, veças, ato elektronike po zbehin trashëgiminë apo transmetimin gojor. Edhe pse këto mjete dhe rrjetet shoqërore luajnë një rol dominues, përvoja e drejtpërdrejtë e më të moshuarve mbetet e vlefshme, veçanërisht për të rinjtë.

Kështu, Jahja ka zgjedhur formën shkrimore të transmetimit, nëpërmjet reportazheve për vendlindjen, portreteve dhe analizave të ndryshme; së dyti, autori ka marrë dhe u ka dhënë të tjerëve veprimtari që e kanë bërë të gjithë të shkolluarit brenda një territori të caktuar, pra, jo vetëm mësuesit. Mësues si Jahja kanë ditur së pari të marrin (në kuptimin e njohjes) dhe pastaj të japin. Jahja i përket atij komuniteti ku lindi e jetoi, që dinë mirë të vlerësojnë veten dhe tjetrin. Aty, në krahinën e tij, në Radomirë, kishte dhe ka *itifak*, që do të thotë, përmes kolektivit përfiton individi, përmes rregullave të vendosura nga shumica kishte leverdi pakica. Kjo do të thotë se brenda kulturës popullore ka qenë vlerësimi i tjetrit, jeta dhe pasuria.

Së fundmi, në konceptin Unë dhe Tjetri, them se unë e njoh Jahen. E njoh si mësues, drejtues shkolle, në takime e promovime, në veprimtari të ndryshme shoqërore. Pra, e kam njohë, po sigurisht jo në të gjitha shkallët e njohjes. Tashmë gama e njohjes është shtuar, pasi e ka shfaqë veten me botime në prozë e poezi. E njoh jo vetëm unë, por e njohin dhe të tjerët. Ndoshta më shumë, sidomos kolegët, me të cilët punoi një jetë, të afërmit dhe miqtë.

Rruga e Arbërit nr. 168

vendlindje

Esat Hysa e donte vendlindjen, kishte mall, mall emigranti, ndaj duhej një festë gjithëpërfshirëse, *Festa e Bjeshkës,* që do të organizohej çdo 30 qershor.

Jam i lumtur kur kanë të tjerët

Nga **SHAQIR SKARRA**



Esat Hysa

Në qershor të këtij viti u mbushën plot njëzet vjet ku banorët e Sllatinës festojnë festën e tyre të bukur të bjeshkës. Nisi fare rastësisht si një vullnet e dëshirë e madhe e djemve të këtij fshati që janë prej vitesh në mërgim, por ja që ajo llavë e ndezur njëzet vjet ma parë ende nuk shuhet, por flaka e saj ndriçon në të gjithë zonën e Ujemujës. Dhe këtë flakë, këtë shkëndijë të madhe po e mban ndezur prej njëzet vitesh Esat Hysa, një djalë Sllatine, emigrantë në Amerikë prej 30 vjetësh.

Jeta e Esatit është e çuditshme, ajo tek ne na vjen si nëpërmjet legjendës, i kalon perceptimet e të vërtetës. Që në moshën 12 vjeçare edhe pse filloi të kuptojë mirë e të ia dijë vlerën lekut kur ishte në shkollë po ti ndodheshin pesë lek në xhep do të blinte një gurabi e do ta ndante në pjesë të barabartë me të gjithë shokët e klasës. I tillë ishte Esat Hysa fëmijë, i tillë ka mbetur edhe sot që është bërë prind dhe me fëmijë vetë. Në ato vite varfëria ishte ulur kudo në votrat shqiptare, por Esati mundohej edhe pse nuk kishte, të ishte ndryshe të tjerëve. Kërkonte shumë nga vetja por e vështirë ishte të plotësoheshin ato që kërkonte. Megjithatë askush nuk e pengonte djaloshin Esat Hysa të vishej ndryshe, gjithë sqimë, të vishej pastër e me mjaft gusto, të mbante flokë të gjata ndryshe nga të gjithë moshatarët e tij, të organizonte mbrëmje me të rinjtë në fshat.

Kishte mësuar që i vogël t'i binte çiftelisë dhe fyellit. E vetë i mblidhte të gjitha moshat, që tek të vegjlit e deri tek më të rriturit. Që në atë moshë kishte dëshirë të organizonte mbrëmje, të bashkonte njerëz, të falte bujari e mirësi, të falte vetëm buzëqeshje dhe dashuri.

Veshja e tij, moda që mundohej të mbante, shpirti i tij herë-herë rebel nuk mund të mos binin në sy për keq. Edhe muret kanë vesh, thotë populli dhe shkonin të dhëna tek operativi i zonës, raportonin për sjelljet ekstravagante të nxënësit Esat Hysa.Bënte si bënte dhe sa herë që qepte ndonjë palë pantollona të reja ndiqte modën e qyteteve të mëdha si Tirana e Shkodra, të ngushta në gjunjë e të gjana në fund sa kur ecte serbes serbes në qendër të Sllovës dukej sikur pantallonat e tij fshin pluhurin gjatë rrugës. Megjithatë dy vite të shkollës së mesme i përfundon në Sllovë. U shkëput nga Sllova dhe vazhdoi me korrespondencë në Zalldardhë. Kurrsesi nuk donte ta ndërpriste shkollën, e donte, e donte shumë se besonte që përparimi, zhvillimi,dija, kultura nga shkolla vinin. Kishte vullnet të paparë. Mendonte për babanë e tij, Hajrushin, i cili ishte i vetmi student në ato vite nga Ujemuja që mbaroj studimet në ish Jugosllavi.

Esati nuk pretendonte për shumë, por mendonte ta mbaronte shkollën e mesme dhe pastaj mund të futej në ndonjë shkollë muzike. I pëlqente shumë muzika. Ishin bërë si familje po thuaj një orkestër e kompletuar. Të gjithë në mbrëmje vonë këtë punë bënin. Dikush çifteli, dikush sharki,fyell e klarinetë. Tamam një orkestër gjatë mbrëmjeve në shtëpinë e Hajrush Hysës.

Duke parë pasionin që kishte për muzikën, Naim Plaku së bashku me Përparim Tomçinin bënë një sakrificë vërtet të madhe duke e dërguar Esat Hysën në shkollën e muzikës në Tiranë, ku këtu qëndroi vetëm një vit. Megjithëse kishte bërë përparime të mëdha dhe mund të ecte edhe më shumë, pas një viti e ndërpreu shkollën në Tiranë dhe kthehet pas familjes në fshat. Kishte të tjera plane, të tjera ambicie, por që asnjëherë nuk i kishte diskutuar me të tjerë. Esati ishte dhe mbeti njeri enigmatik që nuk e njohën tamam as shokët e ngushtë të tij që kalonin ditën bashkë. Asnjëherë nuk fliste para kohe, asnjëherë nuk premtonte pa u siguruar ma parë se çdo gjë realizohej dhe nuk mbetej fjalë e dhënë kot.

***

Pikërisht tani fillon jeta e dytë e Esat Hysës, jetë që lindi si një ëndërr, si një dëshirë e tij netëve të gjata por për shumë vite i kishte mbetur në sirtar. Esati, si një djalosh gjithë ëndra për jetën mendonte ndryshe me bashkëmoshatarët e tij. Sllatinën e donte, i dhimbsej vendlindja, i donte shumë dhe njerëzit e saj të vuajtur, të lodhur, të plakur para kohe nga hallet dhe varfëria e tejskajshme, por ishte i pa fuqishëm t'ju thoshte se kjo që po bëjmë është jetë qeni.

Ishte verë e vitit 1982. Esat Hysa sapo ishte futur në pranverën e tetëmbëdhjetë të jetës së tij. Ishte djalë i ri, por shumë i pjekur për moshën që kishte.

Mendonte dhe vepronte si një i rritur."U poqëm para kohe" thotë me shaka vetë Esati.

Edhe pse Esati ishte krejt ndryshe, mendonte krejt ndryshe, vishej krejt ndryshe kishte shumë shokë, rrinte me ta ,fliste hapur, i besonin të gjithë në ato që thoshte, por për të tjerët, për pushtetin, për hijet që endeshin natën si hijena pas gjahut Esati ishte me rrezikshmëri të lartë." Kërkon që të na infektojë me mendime mikroborgjeze edhe bashkëmoshatarët e tij, edhe krejt shoqërinë e shëndoshë". Kështu mendonin njerëzit e veshur me pushtet, ndiqej, survejohej e kontrolloheshin mirë të gjitha lëvizjet e Esat Hysës. Duke parë nga afër vuajtjet dhe varfërinë e tejskajshme jo vetëm të prindërve të tij por të gjithë fshatit mendonte se në këtë vend ku kishte lindur shpresat për të ardhmen ishin të vdekura. Asgjë nuk ia mbushte syrin djaloshit Esat Hysa. Pesimizmi e ndiqte ngado.

Në verën e vitit 1982 i takoi të punonte në Gramë. Ishte vetëm 18 vjeç djalë por për të ndihmuar sado pak familjen i duhej edhe Esatit të punonte. Gjatë gjithë verës të atij viti punoi në Gramë, tek diga e liqenit. Së bashku me të ishin edhe Bashkim Rusi nga Rrenxi dhe Elez Përgjegji nga Përgjegje. Të tre ishin shokë të ngushtë, të tre bisedonin lirshëm, të tre i hapeshin shumë njeri tjetrit. Pas një pune të lodhshme dilnin dhe vështronin bukuritë mahnitëse të Korabit. Sipër ishte piramida, matanë piramidës shtriheshin tokat e republikës Jugosllave. Kur hidhnin vështrimin poshtë dukeshin konturet e fshatrave të Dibrës. Tre shokët e ngushtë mendonin se vërtet vendlindja e dashur është por jetesa skëterrë. Matanë një jetë krejt ndryshe. Kjo verë e vitit 1982 ua nxiti edhe më shumë djelmoshave të arratiseshin njëherë e përgjithmonë, të provonin fatin e tyre duke braktisur kështu vendlindjen.

Ajo stinë vere i vuri që të tre në një provë të madhe, thurnin plane gjithë natën dhe nesër në mëngjes kur gdhiheshin asgjë nuk po realizonin.

Bashkim Rusi kishte dajat të arratisur vite ma parë të cilët ndodheshin në Nju-Jork. Kaluan kështu plot pesë vjet duke thur plane njeri me tjetrin dhe asnjëherë nuk po vendosnin dot.

Në pranverën e vitit 1990 Esati ikën nga Sllatina dhe shkon në Rrenx. Pasi futet në shtëpinë e Bashkimit, hanë drekë bashkë dhe përsëri bisedojnë rreth planit të arratisjes.

-Unë do të ik, i thotë Esati, nëse do vish me mua bëju gati. Je i vetmi që po ta hap zemrën. Për planin tim nuk di gjë askush, as familja.

-Më vjen keq, por unë nuk mund të vij, megjithatë po të jap adresën e dajës tim dhe ty ta baftë Zoti udhën dritë- ia kthen Bashkimi. U ndanë dy shokët e ngushtë, u ndanë atë pranverë dhe secili mori drejtimin e jetës së tij.

Esati u nis i vetëm për në Sllatinë. Rrugës tashmë mendonte se si ta organizonte planin e arratisjes, se si ta shpejtonte sa ma parë.

Një natë të bukur gushti u mblodhën të gjithë bashkëmoshatarët por edhe më të rritur në moshë në qendër të fshatit. Esatit i pëlqenin këto takime, organizonte shpesh mbrëmje të tilla me shokë. Qëndruan duke biseduar, duke pirë dhe kënduar bashkë deri vonë.

Kur shitësi u kërkoi leje të rinjve që të mbyllte dyqanin u shpërndanë të gjithë nëpër shtëpi. Esati po ecte i vetëm drejt shtëpisë së tij mirëpo nata ka hije, nata është e frikshme. Një dorë e fuqishme e kapi nga flokët pas dhe po e tërhiqte. Kjo i erdhi si befasi Esatit, mendoi mos ndoshta ndonjë shok po bënte shaka. Në fakt nuk ishte shaka kjo. Nën dritën e hënës kur kjo hije që në fakt nuk ishte hije, njohu fare mirë operativin e zonës, një njeri i urryer për të gjithë zonën. Ishte nga Mati dhe e kishin sjellë me shërbim në Sllovë. Nuk ishte vetëm, jo ai nuk ecte vetëm kurrë se e njihte frikën. Bashkë me të ishte edhe një polic nga Greva. Operativi i zonës nuk flinte gjumë, vepronte natën, ruante befasitë, gjuante dhe kapte viktimat, gjahun që i duhej.

-Të erdhi fundi Esat Hysa, do të kalbesh në burg. E shikon çantën time, e kam plot me letra e denoncime që më vijnë për ty, dhe e di nga më vinë. Më shumë janë nga Sllatina. Ti je njeri me rrezikshmëri të lartë për shoqërinë. Operativi fliste e fliste pa pushim. Esati nuk ndjehej fajtor, nuk kishte bërë krim, nuk kishte shkelur ligjin, kaq e kuptonte, pastaj në një shtet me diktaturë çfarë nuk pret. Dhe operativi ashtu siç doli nëpër natë edhe iku, u largua por ama një hije frike e la tek djaloshi sllatinas.

Dielli nuk po shikonte më, shpresat ishin vrarë, re të zeza e mjegull ngado që vinte këmbën. Kishte herët që bluante në kokë planin e madh të arratisjes, por takimi nëpër natë me operativin e zonës, kërcënimet e tij mjerane ndikuan më shumë për ta shpejtuar planin .

Iku nëpër natë në shtëpi, por historinë e trishtë me operativin kobzi të zonës nuk ia tregoi njeriu. U mbyll edhe më shumë në vetvete. Filloi të mos hapej, nuk po i besonte më askujt.

Jetesa në Sllatinë ishte bërë e vështirë. Dera e burgut siç duket ishte e hapur. Dielli nuk po ngrohte më për Esatin, retë ishin shpërnda ngado dhe yjet natën ishin zhdukur, shpresat ishin vrarë dhe jeta ishte bërë e pa durueshme. Hijet e ndiqnin kudo. Planin e tij të arratisjes e shpejtoi edhe më shumë.

Atë vit i kishte vdekur nënë Xhevria, ishte ndarë nga kjo botë me nënën e mirë, me dashurinë më të madhe , me jetën që i falte jetë, me lumturinë që i falte lumturi. I mungonte shumë nëna.

Shpesh kur ndjehej ngushtë shkonte te varri i nënës e qante, qante shumë. Vetëm këtu i dukej se përsëri merrte këshilla se si të vepronte.

I kishte mbledhur një natë nëna të gjithë djemtë bashkë dhe kur aty ishte edhe Hajrushi u kishte thënë:"Prej jush dua shumë, dua të bëheni të mirë për vete, për njeri tjetrin, për fshatin dhe ma shumë se kaq. Ta doni njeri tjetrin në ditë të mirë dhe të keqe, ta ndihmoni dhe silleni kudo si u ka hije. ta doni vendlindjen, të ndihmoni kur keni mundësi. Hallall, çdo gjë hallall. Në shtëpinë e Hajrush Hysës vetëm hallalli ka vlerë, haramin nuk ua do nana.

Data shënonte 9 shtator e vitit 1990. Vjeshta kishte ardhë dhe nga maja e maleve dita ditës prisje që koha do të prishej, do të fillonin shira, moti do të ftohej e rruga do të bëhej edhe më e vështirë, rruga, një rrugë e pa shkelur asnjëherë më parë. Ishte mëngjes herët. Esati zgjohet pa i thënë askujt, mori disa fotografi të nënës që kishte dalë që kur ishte e shtruar në spital me vete, mori dhe mjaft foto të tjerëve të njerëzve të tij të dashur, të farefisit, i futi në një qese plasmasi, i mbështolli mirë rreth vetes dhe doli nga shtëpia.

Në fillim vajti tek varrezat. U ul tek varri i nënës. Dheu ishte ende i njomë. Mblodhi pak lule rreth e qark dhe i hodhi sipër varrit. U ul, puthi dheun e i dukej sikur po puthte nënën. Mbeti gjatë krejt i mpitë ashtu sipër varrit. U ngrit dhe foli, foli dy fjalë me zë të lartë por era këtë radhë i mbajti për vete fjalët e Esatit: " Po iki nënë, po iki larg, shumë larg. As vetë nuk e di se ku do përfundoi, por Sllatina nuk po më mban më mua, nuk më kuptoi asnjëherë. Hije të zeza, re dhe furtunë më ndjekin ngado. Kam ardhur këtë mëngjes shtatori me të thënë lamtumirë, me të përqafuar fort, fort, si dikur kur ishe gjallë dhe po të them se amanetet e tua do t'i kem gjithmonë parasysh.

Po iki nënë por dije se amanetin tënd do ta kem busull orientuese kudo që të shkel. Do punoi me mund e djersë, do t'i dua vëllezërit, njerëzit e farefisin, do ta dua Sllatinën time dhe tënden, do ta dua shumë dhe të jap fjalën se sa të kem jetë do punoi për të". Sytë e Esatit ishin mbushur plot për plot me lot por nuk e dha veten, nuk qëndroi shumë. Kështu me zemër të thyer dhe të lënduar u nis në udhën e gjatë pa kthim.

Rruga vetëm e vështirë, edhe më e vështirë kur nuk e di, edhe më e vështirë kur ec me frikë se nga momenti në moment mund të biesh në pritë të ushtarëve të kufirit. Ashtu i vetëm siç ishte, që në fakt nga historitë e gjata e të shumta të "arratisjes" asnjëherë nuk kishte ndodhur që të iknin vetëm por gjithmonë me dy, tre e më shumë veta, duke ecur rrugë pa rrugë më së fundi arriti fare afër kufirit. Doli nga gropat e minave, në krah të portës së Korabit.

Komandant i postës kufitare ishte Ali Elezi, ushtarak i betuar që nuk falte as kafshët kur shkelnin kufirin e jo ma njerëzit. Fati i priu Esatit. Dielli ende nuk kishte perënduar, ende ishte lart e megjithëse i shkoi rruga gjatë e kaloi më së fundi brezin e butë. Përballë tij shfaqej piramida ku shkruante Republika Popullore Socialiste e Shqipërisë. Matanë saj shkruante Republika Federale e Jugosllavisë. Ktheu edhe njëherë kokën pas. Nga larg dukeshin si konture të largëta fshatrat e Dibrës, Mundohej të gjente Sllatinën mes asaj zallamahie fshatrash por ishte e pa mundur. Sllatina nuk dukej por për Esatin Sllatina mbeti gjithçka. Hodhi vështrim poshtë. Zgjateshin e zgjateshin fshatra pa mbarim. Ishin fshatra të huaj për të.

Fshati i parë që ra ishte Tanusha, shqiptarë ishin banorët por kufiri i kishte nda dhe coptuar keq shqiptarët. Këtu vajti vetë dhe u dorëzua në postën e kufirit. Nuk e pritën mirë, kuptohet, kishte rënë në dorë të hasmit më të madh të shqiptarëve, dhe hasmi i vjetër nuk mund të bëhej mik i ri . E futën në një makinë policie dhe e nisin për në burgun e Gostivarit. Rrugës policët e provokonin, talleshin me të, e qëllonin por Esati qëndronte i heshtur, nuk e hapi gojën fare. Në qelinë e burgut ku e futën i vinte nga do era gjak. Njollat e gjakut dukeshin në mure, në çarçaf e jastëk. Këtu ishte i detyruar ta kalonte natën pas një rrugëtimi të gjatë e të lodhshëm që kishte bërë, pa bukë e pa ujë. Bukë kishte ngrënë në mëngjes në shtëpinë e tij në Sllatinë.

Nesër në mëngjes e morën përsëri. Rrugës e ndaluan makinën dhe policët po hanin në një lokal mëngjesin. Për djaloshin sllatinas as që u shkonte ndër mend se kishte njëzet e katër orë pa bukë dhe pa ujë. E çuan në burgun famëkeq të Shkupit. Aty u hap një portë e madhe dhe pa brenda dy djem të rinj, të dy moshatar me Esatin, të dy nga e njëjta krahinë, nga Ujemuja, nga Venishti, Maksim Pucin e Bujar Pucin, të dy i njihte. Kur i pyeti , i treguan se ishin arratisur nga kufiri i Dibrës. Eh ! histori të dhimbshme, histori njerëzore që sot kur nis e i tregon vetë Esati tek ne vijnë si përtej njerëzores, si nëpërmjet legjendës por ja që në fakt kanë ndodhur.

Çdo ditë në mëngjes i mblidhnin dhe i provokonin të burgosurit shqiptarë që ishin mbledhur nga vise të ndryshme e ku shumica ishin mosha të reja, të aftë për punë e mjaft të fuqishëm por që në Shqipëri i kishin humbur shpresat.

Dhe për Esat Hysën tashmë pikësynimi ishte ndryshe, vështrimin e kishte hedhur larg, mendonte për vendlindjen, i donte njerëzit që ishte rritur dhe kishte kaluar rininë bashkë me ta, e kishte edhe si amanet nga nëna që për Sllatinën dhe njerëzit e saj duhej të sakrifikonte gjithmonë.

Kështu e nisi udhën festa e Sllatinës njëzet vite ma parë, festa e bjeshkës, kështu vazhdon të festohet me madhështi përsëri, dhe më kryesorja, të gjitha shpenzimet janë nga vetë financat vetjake familjare të Esat Hysës. Deviza kryesore e Esatit është: "Jam i lumtur, jo kur kam para, por kur kanë dhe të tjerët. Lumturinë time dua ta ndaj me të gjithë!"



Festa e Sllatinës.

Megjithatë dyshonin se ndoshta ishin futur nga sigurimi famëkeq por pas një muaji tek Esati u bindën plotësisht, u binden se ishte një emigrant që kërkonte fatin e tij në perëndim, u bindën kur i panë të gjitha fotot e familjes që mbante me vete, u bindën plotësisht se Esat Hysa ishte ndryshe, kërkonte liri dhe as më pak e as më shumë nuk donte Esati. Kërkonte vërtet të ishte i lirë, i lirë në mendime, i lirë në veshje, i lirë kudo. Nuk e pranonte diktaturën Esati. E dinte se nga diktatura vetëm dhuna fitonte. Dhe kështu pas një muaji më së fundi e çuan në Beograd, në burgun Padidka Skela ku ishin grumbulluar të gjithë emigrantët që prisnin të gjithë të niseshin udhëve të perëndimit për të punuar dhe filluar një jetesë krejt ndryshe.

Kushtet ishin si mos më keq, në një dhomë më pak se 20 metra katrorë qëndronin 60 veta bashkë, me krevat 4-katësh. Jo pak por plot gjashtë muaj në një torturë të tillë. Të gjithë ishin të rinj në moshë nga 18 vjeç deri në 30 vjeç, askush nuk i kishte përjetuar kampet e Hitlerit, por ky kamp-burg në Beograd ua kalonte edhe kampeve famëkeq të asaj kohe.

Djemtë që u futën nga 80-100 kilogram kur dolën nuk i kalonin 40-45 kilogram. Një skëterrë e vërtetë si në trajtim, në ushqim, në fjetje, në higjienë e kudo. Esati shpesh pasi u largua në Amerikë është shprehur mes miqve e shokëve: "Po ta dija se sa do të vuaja në fillim në këto burgje e kampe të Beogradit, do të rrija të haja bukë e kripë vetëm në Sllatinën time".

Pas gjashtë muajsh e nxorën Esatin nga burgu famëkeq dhe bashkë me disa të kombësive të tjera i dërguan në një hotel, por edhe këtu torturat ishin nga më të ndryshme. I zgjonin në mes të natës, i provokonin sa u bënë tortura të pa durueshme. Kishte dëgjuar dhe lexuar Esati për bëmat dhe poshtërsitë e serbëve ndër shqiptarë. I kishin paguar me jetë të parët e tij në Sllatinë. Brutaliteti dhe krimet monstruoze serbe nuk kishin të numëruar. Dhe ja, sot po i shikonte nga afër."Jo, or jo, hasmi i vjetër nuk mund të bëhet mik e shok me ne" u thoshte shokëve, por qëllimi ynë është të durojmë, të mendojmë si duhet të shpëtojmë dhe të largohemi sa ma parë nga këta kanibalë"

Një natë vendosën të arratisen edhe nga hoteli së bashku me disa shokë nga Dibra. Ikën shumë larg hotelit, ikën në mal ku ngritën kasolle plasmasi. Këtu e kalonin natën. Ditën lëviznin, lëviznin shumë, dilnin fare pranë rrugës së makinave ku kalonin serbët dhe kërkonin punëtor krahu, kishin nevojë për punëtor. Ndërtonin shtëpi të reja dhe u duheshin punëtor ndërtimi për të bërë beton në vend të betonierës. Filluan me radhë në këtë mënyrë të punonin. Ai që punonte duhej të blinte bukë dhe ushqime për të gjithë.Vazhduan gjatë këtë lloj rituali por njëkohësisht filluan të përgatisnin letrat tek zyra e Kombeve të Bashkuara si emigrant, të prisnin fatin.

Shkonin me radhë tek kjo zyrë e shikonin mos ndoshta janë miratuar si emigrantë. Nuk vonoi gjatë kjo peripeci dhe Esat Hysa miratohet si emigrant me letra të rregullta në Amerikë. Kjo ishte një lindje e dytë për djaloshin nga Sllatina, një sukses, një fitore. Që në intervistën e para ambasada amerikane e pranon si emigrant politik. Fati këtë radhë kishte qenë me Esatin.

Pas një kalvari të gjatë vuajtjesh, pas sakrificash të mëdha më së fundi për djaloshin e Sllatinës doli drita në fund të tunelit. Amerika, toka e premtuar tashmë ishte fare pranë tij.

Data shënonte 26 gusht 1991 kur këmba e djaloshit nga Sllatina shkel për herë të parë në tokën e premtuar, në vendin e lirive, në Amerikë. Ajo ëndërr e kahershme e këtij djaloshi që nuk u dorëzua kurrë edhe përballë sfidave të vështira, ku jeta vihej në rrezik arriti më së fundi ta shikojë nga afër ëndrrën e kahershme rinore. Stacioni ishte Uashington State Seattle ku në fillim e mori një kishë bamirësie. I dhanë një dhomë të vogël tek universiteti ku kuzhinën, banjon dhe dushin i kishin të përbashkët edhe me studentët ku gjithsej ishin tetë veta. Edhe pse ushqime i sillnin ai nuk dinte të gatuante, ishte hera e parë që vihej para një prove të tillë, dhe megjithatë ku haptas e ku fshehtas të tjerëve ia doli.

Më së fundi gjeti punë me një pagesë që po ti llogarisësh në fund nuk i mbeteshin për të paguar taksa e qera. Nuk ishte ajo Amerika që kishte dëgjuar. Një realitet krejt ndryshe. Këtu jetesa ishte e shtrenjtë, nuk ia dinte njeri se sa vuan dhe heq ti. Nuk mund të ecje si gjarpër me zvarritje, me servilizma. Jo, jo, këtu duhej punë dhe vetëm punë. Ajo ishte faktori kryesor për një jetesë normale. Këtu e pa nga afër Esati se liria nuk paska vlerë pa punë, pa djersë, pa mund e sakrifica. Më vonë gjeti edhe punë të dytë, punë të vështirë pranë një materniteti por ishte i kënaqur se pagesa ishte ndryshe, fitimi ishte më i madh. Në shtëpi kthehej në orën 2 të natës por megjithatë po punonte për mrekulli. Shumë punë, shumë sakrifica, shumë djersë për të arrirë këtu ku ndodhet sot.

Mirëpo krejt ndryshe ndodhi situata në Sllatinë, në familjen e Hajrush Hysës. Një dramë e vërtetë, dramë sa njerëzore aq edhe psikologjike. Mëngjes, drekë dhe darkë do të trokisnin në derë njerëz të sigurimit, polic me uniformë dhe pa uniformë. Pyesnin në shtëpi por edhe në Sllatinë. Jo vetëm Hajrushi por edhe djemtë filluan të përjetojnë stres orë e çast. Hije, hije kudo. Nëna sapo ishte ndarë nga jeta, ende nuk ishin tharë lotët për humbjen e nënës. Tani ja dhe arratisja e Esatit një dramë mjaft e rëndë. Askush nuk dinte gjë, askujt nuk i kishte treguar. Fshati ziente ditë e natë si zgjua bletësh.

Dikush thoshte se e kanë vrarë në kufi gjatë arratisjes, dikush thoshte se e kanë vrarë në kufi duke kaluar në Austri.

Vuajtja e madhe ishte për familjen Hysa. Një goditje e rëndë për Hajrushin. Sa dhimbja për djalin që as dinte gjë e as dinte ku ta kërkonte, nuk po mbaronin edhe telashet e njerëzve të sigurimit të shtetit që ecnin e bridhnin si hijena natën udhëve të Sllatinës.

Sadraimi, si vëllai më i madh nis e tregon:

-Më thirrën komisari postës kufirit në zyrë se vëllai juaj Esati ka tre ditë që është larguar nga stani. Nëse ka ardhur në shtëpi, apo ka njeri të afërt më trego.

U ndava me komisarin dhe vajta në shtëpi. Hapa i vetëm valixhen e Esatit ku mbante disa fotografi familjare. Pashë se fotot më të mira mungonin. Kisha dëgjuar se ato që arratiseshin merrnin me vete dhe foto të familjes. Ia tregova babës bisedën që kisha bërë me komisarin dhe për mungesën e fotove në valixhe. U qetësuam diçka por meraku përsëri i madh ishte.

Sllatina ziente, dikush thoshte se Esati është vrarë në kufi, dikush thoshte është vrarë në Beograd. Këto fjalë vinin tek ne por në darkë mblidheshim të gjithë rreth zjarrit. Më shumë binim pa darkë. E kujt i shkonte ndërmend të hante në atë gjendje që ishim. Nuk dinim asgjë për fatin e vëllait. Një dramë kjo që zgjati gjatë, sy e vesh ishim matanë kufirit të dëgjonim ndonjë fjalë, e hije gjatë natës bridhnin rreth e qark shtëpisë tonë. Çdo lëvizje e jona kontrollohej tashmë.

Njoftova komisarin e postës se ne si familje nuk kemi asnjë lloj informacioni. Komandanti i postës Ali Elezi më thirrën një ditë dhe më thotë:

-Më preve në besë si burrat. Prej teje e lashë Esatin në bjeshkë se të ishte për mua, atij nuk i kam besuar asnjëherë.

Filloi syri i partisë të vigjilojë me kujdes.

Tashmë ia kishin frikën ndonjë arratisje tjetër. Esati nuk ishte vetëm, kishte jo vetëm në fshat por në të gjithë zonën mjaft shokë, që kishin mendime të përbashkëta.

Jo pak por plot 4- 5 muaj asnjë informacion nuk kishim për Esatin. Një torturë e madhe kjo, një dramë që vetëm ata që e kanë përjetuar e dinë se sa e rëndë është kur të largohet vëllai nga shtëpia dhe nuk di asgjë për jetën e tij, nuk di se ku ka përfunduar, a është gjallë apo e kanë vrarë siç flitej lart e poshtë në fshat.

Ishte janar i vitit 1991. Edhe pse bënte ftohtë në zyrën ku ishte një telefon për ndërlidhje në Shumbat kishte shumë veta. Njerëzit ma shumë futeshin për tu ngrohur se sa për punë. Në këtë zyrë shërbente Musa Sulejmani. Bie zilja, bisedat e të pranishmëve u ndërprenë. Nëpërmjet receptorit vinte një zë që mezi dëgjohej: "Alo! Jam Esat Hysa. Ju lutem njoftoni në familjen time, ndodhem shëndoshë e mirë në një kamp refugjatësh në Beograd" .Kaq foli Esati e biseda u ndërpre.

Lajmi vajti shpejt në Sllatinë. Akulli i ftohtë që kishte ngërthyer zemrën e Hajrush Hysës sikur filloi të shkrijë nga pak. Në sytë e tij të vegjël dolën dy pika lot. ishin lot gëzimi. U shkëputën kontaktet dhe telefonatat me Esatin, u shkëputën gjatë tani, u desh një vit që Esati të bëhej i gjallë, të komunikonte lirshëm me familjen, t'ju tregonte gjithçka për rrugëtimin e vështirë të tij që kishte bërë, për punën dhe jetesën në kontinentin e largët Amerikë.

Ishte shtator i vitit 1991. Në postë punonte Bashkim Beqiri, një djalë i mirë, ndër ata djemtë të rrallë që e donin dhe respektonin jo vetëm në Sllatinë por në të gjithë Ujemujën. Në mes letrave të shumta që vinin nga posta, në mëngjes sapo vjen posta e re gjen një letër që e bëri të derdh lot gëzimi nga sytë. Letrën e dërgonte Esat Hysa nga Amerika për familjen e tij. Ky ishte sihariqi ma i madh që mund ti jepte Hajrushit në këtë moshë të thyer çdo kush që do të shkonte të dorëzonte letrën. Esati ishte gjallë dhe jetonte për mrekulli në kontinentin e largët. Bashkim Beqiri ia dha letrën babait të tij, Hajdarit të na e dërgonte ne.

E pamë që larg se po drejtohej nga shtëpia jonë. Në dorë tundte një letër.

-O Hajrush Hysa, o Hajrush Hysa! Oborri i shtëpisë gumëzhinte nga zëri i Hajdar Beqirit.

Në dhomë ishte qetësi e madhe, askush nga ne nuk bënte zhurmë, nuk flisnim. Kishte pllakosur heshtja që nga koha e zhdukjes së Esatit. Prisnim ndonjë lajm, qoftë për mirë apo për keq por siç duket fati na ishte kthyer kundra. Lajme, lajme nga më të trishta qarkullonin kudo në Sllatinë, por era nuk përtonte që të na i sillte dhe në vatrën tonë. Dhe këto haberet ishin bërë si kafja në mëngjes pa sheqer, të zakonshme por po na lodhte më shumë, po na godisnin kudo si familje me rrezikshmëri të lartë shoqërore. Bëheshin mbledhje natën e ditën, diskutohej familja e Hajrush Hysës, si familje antiparti.

Me mendime të trishta binim gjumë, me ëndrra të bukura zgjoheshim në mëngjes. Shikonim dritë në fund të tunelit. Shpresat nuk i kishim humbur. Humbëm nënën por jo shpresën. Kishim humbur vëllanë por jo jetën, të ardhmen, perspektivën. Besonim shumë në Zot, besonim se një ditë jeta do të çelte bukur në shtëpinë tonë.

Hajrush Hysa del në derë dhe pret krahë hapur Hajdar Beqirin, pa e ditur fare se çfarë lajmi do të sillte këtë mëngjes.

-Është gjallë Esati yt, është gjallë Esati ynë, është gjallë djali i Sllatinës, fliste pa pushim Hajdari dhe tundte letrën. -Ja, letra që të sjell nga Amerika. Të dy u shtrënguan fort, të dy derdhën lot. Ne fëmijët nuk mbaheshim nga gëzimi.

Vërtet kishte filluar të çelte jeta në shtëpinë tonë. E gjetëm vëllanë, e kishim gjallë si kokra e mollës. Tashmë ajo mjegull që kishte rënë mbi shtëpinë tonë u largua menjëherë, lotët u thanë e jeta vazhdoi si ma parë. Fjalët në kruan e madh heshtën e thjeshtë tek tuk bashkëmoshatarët e Esatit flisnin:"Djalë i gjallë, me guxim dhe kurajo. Gjithmonë bota për të ishte e madhe, shumë e madhe, e kërkonte vazhdimisht dhe ja tek e gjeti. Sllatina ishte shumë e vogël për të, nuk mund të ia plotësonte ëndrrat dhe dëshirat e shumta që kishte për jetën". Hajrush Hysës i kishte lindur djali për së dyti herë, kishte gëzim, kishte dasëm. Tashmë urat e bashkimit ishin hedhur. Nuk kishte forcë, stuhi e rrebesh që ta ndante nga djali i tij. Lotët i fshiu për herë të fundit nga sytë, dhe sytë e tij nuk panë lot më kurrë.

Esati vërtet kishte shkelur në tokën e premtuar, në vendin e lirive të mëdha siç kishte ëndërruar herët por çdo fillim domosdo që ka edhe vështirësitë e veta. Nuk e pati aspak të lehtë në fillim por falë vullnetit, kurajos dhe forcës ia doli.

Vërtet Amerika ishte tokë e premtuar, liritë dhe garancitë e njerëzve ishin primare por për çiftin e ri në Amerikë nuk ndodhi ashtu siç edhe flitej. Këtu kishte rregulla strikte. Liri dhe demokraci vërtet kishte. Nuk donte njeri të ia dinte për jetën e tjetrit, por ama ligjet ishin njëlloj si për qytetarin, ashtu edhe për Presidentin. Lodhje, sfilitje, rraskapitje të ndryshme për çiftin e ri të sapo martuar shqiptar në Uashington e letrat po vononin. Filluan të lindin fëmijët njëri pas tjetrit. Letrat po vonoheshin.

Kaluan pesë e dhjetë vjet. Jetesa kështu vazhdoi. Punë shumë, lodhje shumë, stres shumë. Më së fundi erdhi dita që kishin ëndërruar. Të dy si Esati, si Mimoza, bashkëshortja e tij morën pasaportat amerikane, bënë betimin solemn para flamurit amerikan dhe u quajtën nënshtetas amerikan. Kjo ishte domosdo fitorja ma e madhe që kishin arritur. Tashmë bridhnin botën me atë pasaportë që zotëronin në xhep. Por çdo fillim domosdo që ka dhe vështirësitë e tyre, nuk e gjetën të shtruar çifti Esat dhe Mimoza Hysa. Ju, ua është dashur mjaft punë, mjaft lodhje, mjaft sakrifica për të arritur këtu ku janë sot. Filluan të bëjnë edhe nga dy punë, të punojnë në profesione që nuk kishin punuar më parë, të mësonin në mënyrë audidakte profesione të rinj, dhe këtë e bënin të dy bashkë, falë vullnetit dhe forcës që kishin.

Fëmijët po rriteshin, telashet po shtoheshin, jetesa e shtrenjtë, më e shtrenjtë arsimimi i fëmijëve por Esati dhe Mimoza i vunë detyrë vetes të punojnë shumë e fëmijët ti shkollojnë të gjithë në degët që preferonin vetë.

Vajza e madhe Lisa mbaron fakultetin e mjekësisë dhe do të specializohet përsëri në mjekësi, ndoshta për kirurgji. Djali Roberti vazhdon për stomatolog. Vajza tjetër Emi vazhdon vitin e parë në shkollë të mesme dhe ka dëshirë të vazhdojë ashtu sikur dhe vëllai për stomatologji. Vajza e vogël Anita është në klasën e shtatë dhe kjo ka dëshirë të vazhdojë mjekësinë. Kështu në një të ardhme të shpejtë çifti Esat e Mimoza Hysa mund të hapin një spital model në Amerikë me të gjitha specialitetet.

Dhe për Esat Hysën tashmë pikësynimi ishte ndryshe, vështrimin e kishte hedhur larg, mendonte për vendlindjen, i donte njerëzit që ishte rritur dhe kishte kaluar rininë bashkë me to, e kishte edhe si amanet nga nëna që për Sllatinën dhe njerëzit e saj duhej të sakrifikonte gjithmonë.

Mimoza nuk e pengonte në nisma dhe iniciativa të tilla për vendlindjen, ajo e mbështeste vazhdimisht. Po kështu edhe fëmijët kur filluan të rriten mësuan më shumë lidhjen shpirtërore që kishte babai i tyre me Sllatinën, dhe këtë lidhje filluan ta forcojnë edhe vetë.

Kanë kaluar njëzet vjet nga 30 qershori i vitit 2000 që atëherë kur Esati mendonte krejt ndryshe për Sllatinën dhe banorët e saj. Esati e donte vendlindjen, kishte mall, mall emigranti ndaj duhej një festë gjithë përfshirëse, festa e bjeshkës që do të organizohej çdo 30 qershor. Këtu nuk kishte dallime. Sllatina ftohej e gjitha por jo vetëm kaq. Kishte ftesa edhe nga fshatra të Ujemujes, nga pushteti vendor, nga këngëtar e artistë të njohur.

Kështu e nisi udhën festa e Sllatinës njëzet vite ma parë, festa e bjeshkës , kështu vazhdon të festohet me madhështi përsëri, dhe më kryesorja, të gjitha shpenzimet janë nga vetë financat vetjake familjare të Esat Hysës. Deviza kryesore e Esatit është:"Jam i lumtur, jo kur kam para, por kur kanë dhe të tjerët. Lumturinë time dua ta ndaj me të gjithë!"

Neshat Ndreu nuk është pikë që pikon atje ku ka rrjedhur dikur.

Neshat Ndreu, modeli i njeriut të suksesshëm

Nga **SHAQIR ÇERPJA**

Neshat Ndreu është një njeri energjik, kërkues ndaj vetes, këmbëngulës për të ecur përpara. Ai është modeli, shembulli që duhet ndjekur për të kapur suksesin dhe progresin.

Kur ne flemë, Neshati mendon, planifikon suksesin për ditën e nesërme, për ditët, javët dhe muajt e ardhshëm. Kur ne rrimë, ai ecën, kur ne ecim, ai vrapon, kur ne përpiqemi të vrapojmë apo na duket se po vrapojmë, ai fluturon. Vrapon e fluturon i lehtë si era, shpresëplotë si pranvera dhe i begatë si vera e vjeshta. Ritmi i jetës së tij është i shpejtë, tepër i shpejtë. Ashtu si ritmi i frymëmarrjes së tij, është i shpejtë edhe ritmi i hapit, i ngjitjes, i rritjes, i përparimit, i suksesit. Ai është njeri shumë i suksesshëm, sepse është guximtar. Nuk ka dështuar, por ai nuk i druhet dhe nuk i trembet as dështimit, sepse ai e di dhe na tregon edhe ne, se nuk mund të jesh i suksesshëm, nëse nuk guxon, nëse trembesh e frikësohesh nga dështimet.

Neshat Ndreu u lind në vitin 1964, në fshatin Zall-Dardhë të Dibrës, në një familje me tradita atdhetare dhe me kontribute të shquara në historinë tonë. Neshati, jo vetëm e filloi jetën duke qarë si të gjithë fëmijët e tjerë, por duke qarë e vazhdoi dhe e jetoi një pjesë më të rëndësishme të jetës së tij. Ai pati një jetë me brenga e halle, me vuajtje dhe dhimbje të thella shpirtërore, sepse regjimi komunist, familjes së tij, jo vetëm i mohoi kontributin e shquar në Luftën Nacionalçlirimtare, gjakun e derdhur nga familja e tij për çlirimin e vendit, ku Selim Ndreu ra dëshmor, ndërsa xhaxhai i Neshatit, Bajram Ndreu, jo vetëm ishte partizan, por edhe u plagos në luftë për çlirimit të vendit. Familja e tij u përndoq dhe persekutua deri në ekstrem, duke e cilësuar dhe etiketuar "kulak". Kur lindi Neshati, u gëzuan prindërit, familja dhe të afërmit e tij, por u mëzit partia dhe u zemërua regjimi komunist, sepse ai regjim gëzohej vetëm kur kjo shtresë popullsie vuanin, bile vetë regjimi prodhonte e krijonte rrethana e kushte sa më të vështira që njerëzit e kësaj shtrese popullsie të vuanin, të qanin e të lotonin çdo ditë.

Ndërsa Neshati rritej, ai shihte, dallonte, kuptonte dhe çdo ditë ballafaqohej me pretsionin jo vetëm psikologjik të përndjekjes dhe të luftës së klasave. Kudo që të ishte, në rrugë, në shkollë dhe shoqëri, ai shihte dhe ndjente diferencimin dhe përbuzjen klasore, të cilat, tek ai, te familja dhe të afërmit e tij, krijonin plagë dhe dhimbje të thella shpirtërore. Ai nuk kishte asnjë mundësi tjetër, veçse të duronte në heshtje, por edhe të fshihte brenda vetes të gjithë zemërimin, mllefin dhe urrejtjen ndaj regjimit komunist. Për shkak të vështirësive dhe halleve të shumta familjare, Neshati u detyrua të



fillonte punë në moshë shumë të re. Fillimisht punoi në vendlindje, por më vonë punoi edhe në Vlorë, Koman, Banjë, Bovillë etj.

Neshati kishte shpirt të dlirë, por kishte edhe natyrë rebele. Ai jo vetëm e donte, e dëshironte dhe e ëndërronte lirinë, por edhe mendonte se si ta kërkonte e ta fitonte atë, por diktatura komuniste ishte shumë e egër dhe liria kishte kosto dhe çmim shumë të lartë dhe shumë njerëz e kishin pagur shumë shtrenjtë, me burgosje, bile edhe me jetë, me varje dhe pushkatim. Në vitin 1990, vetëm disa muaji pasi Havzi Nela u dënua me vdekje dhe u ekzekutua me varje në litar, në mes të qytetit të Kukësit, Neshat Ndreu, bashkë me kushëririn e tij Luan Ndreu guxuan dhe vendosën të arratiseshin nga Shqipëria, me synimin dhe shpresën për të arritur në vendet e zhvilluara perëndimore, ku liria nuk ishte dogmë, por demokracia, liria dhe mundësitë për jetë dhe jetesë shumë më të mirë ishin reale. Autoritetet jugosllave i kthejnë në Shqipëri, por fatmirësisht, procedurat e hetimit, gjykimit dhe dënimit u zbutën menjëherë dhe nuk kishin më forcë, sepse regjimi komunist kishte filluar të tronditej.

Shpirti i tij liridashës ishte etur e djegur për liri, prandaj edhe ai u përfshi maksimalisht në lëvizjen popullore për rrëzimin e regjimit komunist dhe demokratizimin e gjithë jetës së vendit. Rrëzimi, rënia dhe përmbysja e regjimit komunist në Shqipëri, ishte dita më e bukur, gëzimi më i madh, kthesa më e rëndësishme dhe fitorja më e madhe dhe më e pakrahasueshme në jetën e tij. Dielli i ditëve pluraliste shkriu akullin e diferencimit dhe të përndjekjes klasore,

Ai është gjurmë e dukshme e një fisi dhe familje me shumë emër... Ai është gur i çmuar në truallin dhe në themelet e Dardhës - mal historik në Nëntë Malet e Dibrës... Ai është pentagram i zërit të vendlindjes, që ushqehet nga historia dhe bëhet këngë dhe ushqim për historinë, traditën, artin, kulturën... Ai është gjak i gjakut të Haziz Ndreut, është jehonë e zërit të Qerim Sulës, është ritëm i valles së Xhelal Çerpes, ai është lis e shkëmb në bjeshkë, valë e dallgë Drini ...

fshiu mjegullën në sytë dhe në rrugën e tij, rilindën shpresat dhe u ngrohën zemrat, shpërtheu vrullshëm optimizmi dhe energjitë fizike dhe shpirtërore për të ecur përpara, për të krijuar e ndërtuar një jetë e jetesë më të mirë, pa vuajtje, brenga dhe halle.

Neshati i ri dhe energjik, i palodhur, këmbëngulës dhe i përkushtuar, me mendim dhe ide vizionare, me shpirt krijues, iniciativë dhe vetëveprim, ia nisi dhe iu vu punës për të ecur përpara, për të realizuar dëshirat dhe ëndrrat e tij. Në vitin 1996 kreu dhe mbaroi studimet e larta dhe, përveçse në policinë e shtetit punoi edhe në Ministrinë e Financave. Disa vite ishte drejtor i ndërmarrjes nr. 2 të trajtimit të studentëve në Qytetin Studenti në Tiranë. Ndërkohë që vazhdonte studimet e larta, u njoh dhe u martua me Leonora Ismailin nga Berati, e cila ka punuar dhe ka kryer detyra të ndryshme, si ekonomiste në Bazën e Armatës, (Ministria e Mbrojtjes), tetë vite drejtoreshë e tatimpaguesve, shefe auditi në bashkinë e Tiranës, ndërsa aktualisht është ekonomiste në kompaninë "Klaron Security" dhe administratore e kompanisë National Security Albania (NSA).

Me punë dhe përkushtim, Neshati dhe bashkëshortja e tij, Leonora, kanë krijuar dhe ngritur kompaninë private "Klaron Security", e cila është e shtrirë dhe vepron në disa rrethe të vendit, të cilën, prej dymbëdhjetë vjetësh e drejtojnë me shumë efektivitet dhe sukses. Ata kanë krijuar një ekonomi të qëndrueshme dhe një jetë e jetesë komode. Por pasuria më e madhe e tyre është familja. Ata kanë krijuar e ndërtuar një familje shembullore dhe model, në themel të së cilës është mirëkuptimi dhe harmonia. Ata kanë rritur dhe edukuar dy fëmijë të mrekullueshëm, të sjellshëm, të kulturuar, të edukuar dhe të arsimuar në universitete prestigjioze amerikane. Djali Aronoeli ka mbaruar studimet e larta për menaxhim biznesi dhe është angazhuar në biznesin e familjes, ndërsa vajza, Klaudia, është në vitin e fundit të studimeve për menaxhim biznesi ndërkombëtar në Florida të SH.B.A.

Sukseset e arritura dhe jetesa komode në Tiranë, nuk e kanë zbehur asnjëherë dashurinë e tij për vendlindjen, për Dardhën dhe Dibrën. Ai, jo vetëm ka ndërtuar shtëpinë e tij në vendlindje, ku shkon e kalon pushimet familjare, por ka treguar gjithmonë interes për vendlindjen, për problemet që ka fshati i tij dhe zona dhe është përpjekur për zgjidhjen e problemeve të zonës. Është pikërisht dashuria për vendlindjen, që ndezën tek ai dëshirën dhe vullnetin për të ringjallur traditën kulturore dhe artistike të Dardhës, për të ringritur ansamblin artistik "Kuvendi" të Dardhës. Ai është president i këtij ansambli dhe kontributi i tij është i çmuar dhe shumë i rëndësishëm, jo vetëm për iniciativën për ringritjen e këtij ansambli dhe organizimin e veprimtarive artistike, por ai, me buxhetin e tij familjar ka përballuar koston e veprimtarisë së këtij ansambli, sigurisht duke u bërë nxitës që edhe subjekte e individë të tjerë të vetëofrohen me financime për këtë ansambël.

Që në fillimet e pluralizmit politik në Shqipëri, Neshati është angazhuar në strukturat politike, fillimisht me PD e më vonë me PAA. Aktualisht është sekretar organizativ i kësaj partie.

"Ku ka rrjedhur, në mos rrjedhtë do të pikojë", thotë një fjalë e urtë popullore. Por Neshat Ndreu nuk është pikë që pikon atje ku ka rrjedhur dikur. Ai është rrjedhje e pandërprerë, është rrjedhje e vazhduar, e shtuar, e shumëfishuar e asaj rrjedhje të hershme, në ato troje të zëshme, buzë Drinit. Ai është gjurmë e dukshme e një fisi dhe familje me shumë emër, që kanë krijuar e lënë gjurmë në historinë tonë. Ai është gur i çmuar në truallin dhe në themelet e kalasë qëndrestare, në vendlindjen e tij, në Dardhën-mal historik në Nëntë Malet e Dibrës, ku fjala është celebruar me besën, besa me betimin, betimin me heroizmin dhe heroizmi me lavdinë e përjetshme. Ai është pentagram i zërit të vendlindjes, që ushqehet nga historia dhe bëhet këngë dhe ushqim për historinë, traditën, artin, kulturën... Ai është gjak i gjakut të Haziz Ndreut, është jehonë e zërit të Qerim Sulës, është ritëm i valles së Xhelal Çerpes, ai është lis e shkëmb në bjeshkë, valë e dallgë Drini ...



Neshat Ndreu me familjen

Bëj pajtimin tënd me

PayPal

përmes emailit

<rrugaearberit@gmail.com>

Një pajtim vjetor kushton:

Në Shqipëri: 600 lekë.

Në Europë: 10 Euro.

Në SHBA dhe vende të tjera: 15 USD.

Pajtimi në Europë dhe SHBA është vetëm në versionin PDF.

traditë

Afrimiteti midis Murres dhe Shqutit e tregojnë marrëdhëniet zakonore të nunllikut midis tyre, e cila shpjegohet si mirënjohjen reciproke.

Hasmëria Murrja-Hasa dhe zbatimi në perfeksion i kanunit

Nga prof.asoc.dr. **ARIF MURRJA**

I -PROLOG

Një ndër hasmëritë e shumta në Dibër ka qenë edhe ajo e fisit Murrja me fisin Hasa në fshatin Hotesh në Luzni. Hasmëria midis tyre kujtohet si një nga konfliktet më të ashpra të kohës. Gjendja e "luftës" ndërmjet familjeve të përfshira në konflikt ka zgjatur më shumë se një dekadë.

Hasmëria midis fiseve Murrja e Hasa është pjesa e katërt e studimit "Kronologjia e fisit Murrja në Hotesh të Dibrës". Objektivat e studimit janë: (i) Informimi me detajet e hasmërisë. (ii) Kur ka ndodhur dhe kohëzgjatja? (iii) Cila familje e fisit Murrja mbajti barrën e kësaj gjakmarrjeje? (iv) Kush është enigmatiku Dan Murrja? (v) Si iku (u largua) fisi Hasa nga fshati Hotesh? (vi) Precedenti i pranimit nga Murrja si "vlla" në troje i Shqutit me origjinë nga Lura, i vendosur përkohësisht në Sinë. Qëllimi i punimit është njohja me zbatimin në perfeksion të zakoneve kanunore nga fiset Murrja dhe Hasa.

II –ASPEKTI METODIK

Për të sjellë në "kornizë" shkencore historinë e hasmërisë së fiseve Murrja e Hasa kemi mbledhur gojëdhënat, faktet toponimike, pozicionet gjeografike të kullave, opinionet dhe i kemi analizuar në bazë të "teorisë së lojës", ku një nga elementët bazë të sajë është "racionalja ose logjika/arsyeja". Dinamizmin deskriptiv/përshkrues e kemi ballafaquar dhe krahasuar seritë kohore, ku etalon është brezi biologjik i jetës së njeriut (deri në 30 vite).

Për të gjetur periudhën e ndodhjes së hasmërisë jemi bazuar në pemët gjenetike të fiseve Murrja e Shquti. Për herë të parë pema gjentike e degës së fisit Murrja në fshatin Hotesh është skicuar nga studiuesi Munir Shehu rreth viteve 60' të shekullit të kaluar. Sipas studiuesit mendjendritur të folkorit, të këngës epiko-historike, të gojëdhës dhe të historisë së Dibrës pasardhësit e Halilit janë Elezi, Hasani, Hyseni, Seferi dhe Limani.

Përfshirja rastësore e Vesel Shqutit në shamatën fillestare midis Murres e Hasës është provë e pakontestuar dhe më kryesorja në këtë studim. Krahasimi kohor i gjeneratave të dy fiseve na orjenton në familjen Murrja që përfshihet në hasmëri dhe në dekadën e dy shekujve të mëparshëm të ndodhjes së konfliktit.

III –SHKAKU DHE PASOJAT E HASMËRISË

1 –Shamata dhe lindja e hamërisë

Në fshatin Hotesh të Luznisë, një ditë prej ditësh, gratë e familjes së Sefer Murres kishin dalë për të mbledhur krande në zabelin e fisit Hasa. Kujtojmë se Hasani, Elezi, Hyseni, Seferi dhe Limani janë pasardhësit e Halilit ose thënë ndryshe përfaqësuesit e brezit të dytë të degës së fisit Murrja në Hotesh. Pasardhësit e Seferit janë Tafa dhe Brahimi (referohuni Figurës 4.3). Kulla e Tafës dhe Kulla e Danit djalit të Brahimit (në të majtë të Figurës 4.1) ishin karshi kullës së Hasës (në të djathtë të Figurës 4.1.) në lugina ballë për ballë, të ndara nga përroi i fshatit.

Sipas zakonit kanunor përveç meras së "katunit", mbledhja e shkarpave dhe kullotja e bagëtive në zabelet e njëri-tjetrit ishin dhe janë të lejueshme. Ndalohej vetëm përdorimi i spatës dhe kmesës, thënë ndryshe prerja e degëve të lisave.

Ndërkohë gratë po mblidhnin krande, pikasen nga disa burra të fisit Hasa. Ato fillojnë të shajnë dhe fyejnë gratë e Murre. Por sipas kanunit gruaja ishte e mbrojtur ndaj ofendimeve dhe akoma më shumë ndaj kërcënimeve.

2 -Përfshirja e Shqutit në këtë hasmëri

Për fatin e mirë, në shamatën e grave të tarafit të Seferit me burrat e familjes Hasa gjendet rastësisht Vesel Shquti (pinjolli i parë i fisit Shquti në Hotesh), që kishte shtegtuar para disa viteve nga Lura në Sinë dhe në fund ishte vendosur për të jetuar me familjen e tij në fshatin Hotesh në Luzni. Ai iu thotë burrave të Hasës: -Mos i shani gratë e Murre sepse i kam motra. Në shkëmbime verbale fjalësh midis tyre Vesel Shquti vret me hutë një nga burrat e fisit Hasa. Kundërpërgjigja e tyre ishte e menjëhershme duke vrarë Vesel Shqutin dhe duke lënë të plagosur rëndë një grua të fisit Murrja (Burimi: Shaqir Shquti sot 80 vjeç).

Akti i Vesel Shqutit ishte heroik. Heroizmi i tij u vlerësua nga Murrja. Murrja i çon "Plakun" Hasës.

3-Zgjatja e hasmërisë dhe zgjidhja e gjakmarrjes

Pas vrasjes së Vesel Shqutit dhe plagosjes së njërës prej grave, Murrja i çon "Plakun" Hasës. Plaku e vë në dijeni Hasën se do të hakmerrej për gjakun e Vesel Shqutit dhe të gruas së plagosur. Familjet u ngujuan dhe për 12 apo 17 vjetë rrjeshtë nuk u panë as qetë në ara (Burimi: Jahe Murrja, Shaqir Shquti, Xheladin Murrja). Në njërën anë familja Hasa mbrohej në anën tjetër tarafi i Seferit kërkonte të zhbënte atë. Ekonomia e familjeve në hasmëri sa vinte e rëndohej, saqë secila në hesapet e veta (llogaritë e tyre) po mendonte të largohej apo të ikte nga fshati.

Kullat ballë për ballë i bënin sehir njëra-tjetrës. Çdo të lindur të Diellit, familjet kontrollonin jetën e njëra-tjetrës duke vështruar tymin e oxhaqeve respektivë. Pas më shumë se një dekadë Hasa detyrohet të lërë pronat dhe ikën/largohet nga Hoteshi. Ato vendosen për të jetuar në fshatin Bllat në Maqellarë. Ikja e Hasës shënoi fundin e hasmërisë ose thënë ndryshe zgjidhjen e gjakmarrjes. Sipas kanunit kur hasmi largohej gjakmarrja ndërpritej dhe pala tjetër zaptonte pronat.

Legjenda vendase e shpjegon kështu largimin e Hasës: -Kriza kishte arritur kulmin. Burrat e tarafit të Seferit një natë prej netësh ishin mblidhur për të diskutuar largimin nga fshati sepse Hasa ua kishte sjellë ngushtë. E zonja e shpisë i dëgjon dhe u thotë: -Meqë maxhja (arka e miellit) ka miell për bukë edhe për nesër, ta sosim (mbarojmë) dhe mbledhim rraçet (rrobat) dhe ikim. Por në të njëjtën situatë gjendej edhe Hasa. Për habi edhe ato ishin mbledhur për të diskutuar pamundësinë e qëndrimit në fshat dhe të bënin planin e ikjes. Por ç'farë ndodhi të nesërmen? Burrat e shpisë së Seferit, si zakonisht nga kulla e tyre, shikonin nëse dilte tym nga oxhaku i kullës së Hasës. Kaloi mesdita dhe tym nuk po dilte. Hasa kishte mbledhur rraçet dhe kishte ikur nga fshati.

4. Shquti i ardhur nga Lura u bë vëlla në/me troje nga Murrja

Me detyrim-përcaktim Fisi Hasa iku nga fshati. Sipas kanunit nga dezertimi i Hasës, pasurinë e përfitonte Murrja. Por fisi Murrja për të vlerësuar aktin heroik të Vesel Shqutit mblodhi të gjithë vllallikun për ta bërë vlla në troje familjen e tij.

Për jetën e humbur të Vesel Shqutit në mbrojtje të grave te Murre, Murrja i dhuron familjes së tij 2/3 e pronave të Hasës (kullën dhe pjesën





Figura 4.1 –Kullat karshi njëra-tjetrës. (Burimi: Arif Murrja)



-Diagrama e pemëve gjenetike Murrja dhe Shquti (Burimi: Arif Murrja)

më të mirë të arave dhe pyjeve) dhe 1/3 e mbajti për vete. Thuhet se në kuvendin e mbajtur nga Murrja për këtë problem ka patur zëra kundra dhurimit, por shumica ka vendosur, që Shquti të bëhej "vlla" në troje nga Murrja. Zëri kundër është bindur me argumentin, se nëse Murrja nuk do të dhuronte pasurinë familjes së Veselit që ishte vrarë për të mbrojtur gratë e fisit Murrja, do të shaheshin dhe do të ulej reputacioni si Pari e Malit të Luznisë (Burimi: Shaqir Shquti).

5. Enigma Dan Murrja!

Bratësi dhe mbajtësi i peshës së hasmërisë midis fisit Murrja dhe fisit Hasa ka qenë Dan Murrja (Burimi: Osman Shquti i vjetër, Shaqir Shquti sot 80 vjeç, djali i Osmanit). Ai ishte nipi i fisit Dedja në Hotesh (Burimi: Zir Dedja). Historia e tij është diçka shumë e vështirë për ta kuptuar, për ta zbërthyer a për ta shpjeguar, është diçka mjaft e errët dhe e paqartë.

Gojëdhënat tregojnë për sjellje kontraverse të tij. Kjo shpjegohet nga mos mbështetja e vllallikut në bëmat e tij. Thuhet se nuk kishte qejf të thirrej Dan Murrja por Dan Brahimi. Trimëria e shfrenuar i morri jetën duke i djegur kullën dhe duke e vrarë në një konflikt të armatosur me Alkun e Dohoshishtit (Burimi: Zir Dedja & Brahim Murrja).

Natyrshëm njerëzit lindin dhe vdesin, por jo të gjithë lënë emër. Trimëria e shfrenuar dhe bëmat kontraverse të Dan Murres janë reflektuar dhe memorizuar nëpërmjet toponimeve Kroi i Danit, Kulla e Danit (ku sot ndodhen disa nga pasardhësit e tarafit të Seferit) dhe Ara e Danit (një arë e rrafshët në "vgjeret"/vgjerishtet e Sherametes).



Figura 4.2 –Kroi i Danit dhe Figura



4.3 –Ara e Danit (Burimi: Arif Murrja)

IV –FAKTE DHE ARGUMENTE

Në diagramën e mëposhtme paraqiten të reduktuara pemët gjenetike të fisit Murrja me fokus tarafin e Seferit dhe fisin Shquti. Në boshtin vertikal të grafikut kemi vendosur brezat biologjikë (1810-2020) dhe në atë horizontal kemi vendosur pemët gjenetike respektive të fiseve.

Në të e djathtë të diagramës pasqyrohet pema gjenetike e fisit Shquti (Burimi: Shaqir Shquti) ku konstatojmë 6 breza biologjik, që do të thotë se Vesel Shquti ka ardhur në fshatin Hotesh para vitit 1870. Në të majtë të diagramës pasqyrohet pema gjentike (e reduktuar) e fist Murrja me fokus tarafin e Seferit. Ardhja e Shqutit përkon me brezin e tretë të fist Murrja në Hotesh. Familja e përfshirë në konflikt me Hasën është familja ose tarafi i Seferit.

Fakte të ekzistencës dhe ikjes së fisit Hasa nga fshati Hotesh janë toponimet Kulla e Hasës, Kroi i Hasës (sot tek lagja e Beqirallarve), Zabeli i Hasës dhe Kodra e Hasës. Kulla e Hasës ka qenë aty ku sot është shtëpia e Shaqir Shqutit. Pronat e dhuruara, si shpërblim ndaj aktit heroik të Vesel Shqutit në mbrojtje të grave të fisit Murrja gëzohen edhe sot nga pasardhësit e tij.

Kohët ndryshojnë dhe bashkë me atë ndryshojnë edhe njerëzit, por secili është në të drejtën e tij. Lidhja e Murres me Shqutin si vllezër në/me troje është ruajtur me fanatizëm deri vonë. Vllalliku në troje është transmetuar nëpërmjet "nunllikut", ku gratë e fisit Murrja zgjidhnin për nuna burrat e fisit Shquti dhe anasjelltas. Kjo shpjegon "hatikatllikun" midis dy fiseve.

IV –PËRFUNDIME

Konstatime të respektimit të zakoneve kanunore:

(1) Edhe përse Murrja ishte në superioritet numerik dhe ekonomik me Hasën në konflikt është përfshirë vetëm tarafi i Seferit.
(2) Në pamundësi për të qëndruar në fshat, Hasa ka bërë zgjidhje morale. Hasa kishte bërë faj dhe për të mos vazhduar gjakmarrjen është larguar nga fshati.
(3) Natyrshëm zaptimi i pronave të Hasës nga Murrja ka qenë kompesimi i gjakut të Vesel Shqutit dhe plagosjes së njërës prej grave të tyre, të gjendura në shamatë.
(4) Dhurimi i 2/3 së pronave ku përfshihej dhe kulla e Hasës, tregon fisnikërinë e pinjollëve të fisit Murrja nën udhëheqjen e Elez Murres njëkohësisht Kreu i Malit të Luznisë.
(5) Afrimiteti midis Murres dhe Shqutit e tregojnë marrëdhëniet zakonore të nunllikut midis tyre, e cila shpjegohet si mirënjohjen reciproke.

Rruga e Arbërit nr. 168
jetë

Historia e Tiranës është një histori edhe e dibranëve, ndoshta më e bukura histori dashurie që reziston prej më shumë se një shekull.

Tirana 100 vjet kryeqytet

Një histori e mikpritjes dhe e dashurisë me dibranët



Nga **ENISA GORDANI**

11 shkurt 1920-11 shkurt 2020, Tirana mbush plot 100 vjet si kryeqyteti i Shqipërisë. Ajo u shpall e tillë nga një vendim i Kongresit të Lushnjes, një nga evenimentet më të rëndësishme të historisë kombëtare. Më 11 shkurt të vitit 1920, qeveria e dalë nga Kongresi i Lushnjes u vendos në Tiranë, duke e shpallur kështu zyrtarisht kryeqytet i vendit. Tirana është qytet që e krijoi treva ku është. Është një trevë shumë interesante, një kryqëzim rrugësh: nga Shkodra, Ulqini, Lezha, për të shkuar në Lindje, duhej kaluar njëherë nga Tirana, Qafë-Krrabë dhe në Elbasan, rrugën "Egnatia" e shkonin drejt e në Manastir, Selanik, Stamboll e më tutje. Kjo ishte rruga veriore, ishin dy rrugë të tjera pastaj horizontale, njëra nisej nga Durrësi, bregdeti vinte në Tiranë dhe kalonte në rrugën e "Shën Gjergjit", kështu lidhej Malësia me detin. Ishte një rrugë tjetër që nisej nga Kavaja, që ishte një qytet tregtar po aq i lulëzuar sa edhe Durrësi, e shkonte nëpër Ndroq, tek Urë e Beshirit në Tiranë e hynte në Rrugën e Dibrës e në Qafën e Tujanit, Qafë të Murizës, në Mat, në Dibër, në Maqedoni.

Ata qe njohin sadopak historinë e Tiranës të pas viteve 1900, njohin mirë dhe ardhjen e dibranëve gjatë viteve 1912-1913. Historia e Tiranës do të ishte e cunguar pa dibranët, ashtu si një trupi do t'i mungonte një pjesë e tij.

Kjo ishte vala e parë e emigracionit të dibranëve për shkak të dhunës serbe, ku dibranët pothuajse u përzunë dhe qyteti për shumë pak kohë u zbraz i gjithi. Një grup ndoqi rrugën Dibër-Strugë-Elbasan dhe Tiranë, ndërsa tjetri Dibër-Mat-Shkallë e Tujanit - Tiranë. Pak familje zunë vend në Elbasan, ndërsa pjesa më e madhe e tyre zuri vend në Tiranë.

Të gjithë këta dibranë mbërritën vetëm rrobat e trupit, sepse nuk patën kohë të merrnin ndonjë plaçkë. Ndër ta ishte dhe stërgjyshja ime. Quhej Beglie Gordani, po e thërrisnin Bega (Dibër 1897 - Tiranë 1947). Të parët e mi më kanë treguar që ato pak para që ajo kishte i fshehu nëpër astarët e rrobave duke i qepur mire. Di që stërgjyshi kishte vdekur ndërkohë. Ajo mbërriti në Tiranë vetëm me fëmijët e saj dhe sipas llogarive të mia me ato pak të dhëna që kam, ata erdhën fiks në 1912, kur gjyshi im Qazim (Dibër 1902-Tiranë 1991) ishte jo më shumë se 10 vjeç. Dibranët u vendosën në disa pjesë të Tiranës. Një pjesë e madhe e tyre themeluan atë që njihet edhe sot nga të gjithë "Mëhalla e dibranëve". Familjet dibrane u vendosën kryesisht në të djathtë e të majtë të "Xhamllikut", por dhe disa pika të tjera si: te "Namazgjaja", "Mëhalla Shebekve", "Selvia", rruga "Qemal Stafa", "Hoxha Tahsim" dhe "Pazari i Ri". Shumë shpejt e blenë truallin ku ndërtuan shtëpitë dhe me punë e përkushtim i dhanë jetë një Tirane të re.

Mbiemrat e disa familjeve dibrane në Tiranë: Pitarka, Pustina, Salku, Limani, Mia, Saraçi, Klloboçishta, Sengla, Jashari, Shamku, Torozi, Çanka, Ostreni, Muhaxhiri, Gorenca, Varvarica, Çoku, Basha, Pregja, Oshafi, Reka, Kapexhiu, Erebara, Strazimiri, Kodra, Menzelxhiu, Xhuglini, Dibra, Agolli, Najdeni, Cami, Hysa, Borova, Jorganxhiu, Daci, Abule, Çausholli, Verzivolli, Kuçuku, Kosovrasti, Juca, Kërçiku, Sakiqi, Langu, Lata, Spahiu, Zeqja, Turkeshi, Zllatku, Dibra, Lazimi, Haxhiymeri, Haxhirexha, Pilku, Tërshana, Leksani, Laçi, Qylafku, Resuli, Rusi, Fishta, Zeraliu, Kuriu, Kujofska, Brekofska, Pasholli, Lleshi, Mullahi etj.

Dibranët respektuan bujarinë, dashamirësinë dhe mikpritjen tiranase. Ata nuk kërkuan të bëheshin të parët e vendit, nuk zaptuan asgjë me forcë, por u bënë njësh me autoktonët: kjo është diferenca dhe merita e tyre.

Tironsit falën shumë dashuri, hapën dyert e shtëpive të tyre, por edhe dibronët ia kthyen mbrapsht. Nuk erdhën me prepotencë, e respektuan të zotin e shtëpisë duke ia vlerësuar zakonet, pronën, qytetin e gjithçka.

Ustallarët duarartë dibranë ndihmuan tiranasit të riparonin e ndërtonin shtëpitë e tyre, që deri në atë kohë në pjesën më të madhe ishin të ndërtuara me qerpiç, pra, Tirana ishte trupi dhe dibranët ishin krahët.

Shtëpi që sot i rezistojnë çdo lëkundje tërmeti, ashtu si dhe shtëpia katërkatëshe që gjyshi im e ndërtoi i vetëm rreth viteve '50-të, pasi bleu truallin nga familja Derhemi (një nga familjet historike autoktone tiranase), me të gjitha dokumentet e hipotekuara. Në atë shtëpi janë rritur pesë breza e ku jetojnë akoma prindërit e mi. Floririn e botës të më japin, nuk do të bija kurrë viktimë e delirimit të pallatizimeve që ka pushtuar Tiranën. Ajo shtëpi është qendra ime e gravitetit, sado larg të jem nga Tirona.

Shumë shpejt filluan martesat ndërmjet tiranasve dhe dibranëve, një pjesë e mirë e familjeve të hershme dibrane njërin prind e kanë dibran e tjetrin tiranas. A ka sot dibranë Tirane që nuk kanë mbase një prind ose gjyshër puro tironas? A ka sot tironsa që s'janë të mpleksur me dibranët e Tiranës?

Një shprehje thotë: "Disa tironca, po t'i gërvishtësh pak, dalin dibranë."

Kjo është bukuria e të omlës Tironë, që ato që e deshtën si nonë, i bëri bijtë e vetes. Përse dibronët janë bijtë e Tironës? Sepse u lindën, u rritën, burrnuan e vdiqën në gjirin e saj.

"Po ti je tironse?" - shpesh dëgjoj të më thuhet.

Ashtu realisht ndihem. Nga Tirana morëm natyrën e omël, ku fjalët janë më të buta se pambuku.

Por origjina thërret, gjenetika nuk gabon, as nuk mund të shndërrohet. Prej paraardhësve të mi kam trashëguar dashurinë dhe respektin për punën, deri në sakrificë. Një femër dibrane punon më shumë sesa një burrë, do jetë një zonjë shtëpie me "Z" të madhe madje.

Nuk kam informacione mbi programin që Bashkia e Tiranës do të ndjekë për këtë event historik, ajo që prej kohësh e mendoj është që këto zona apo lagje të kryeqytetit të shpallën e të mbrohen si lagje historike, sikurse ndodh në shumë vende të botës, si shembull ideal i integrimit dhe bashkëjetesës ... të ruhet e të përcillet historia ndër breza, detyrë që na takon ne, pasardhësve të tyre.

Në Dibër të Madhe është ndërtuar "Sahati", në shenjë dashamirësie për Tiranën. Ky shembull të ndiqet dhe në Tiranë.

Më poshtë do të gjeni mbiemrat e disa familjeve dibrane në Tiranë:

Pitarka, Pustina, Salku, Limani, Mia, Saraçi, Klloboçishta, Sengla, Jashari, Shamku, Torozi, Çanka, Ostreni, Muhaxhiri, Gorenca, Varvarica, Çoku, Basha, Pregja, Oshafi, Reka, Kapexhiu, Erebara, Strazimiri, Kodra, Menzelxhiu, Xhuglini, Dibra, Agolli, Najdeni, Cami, Hysa, Borova, Jorganxhiu, Daci, Abule, Çausholli, Verzivolli, Kuçuku, Kosovrasti, Juca, Kërçiku, Sakiqi, Langu, Lata, Spahiu, Zeqja, Turkeshi, Zllatku, Dibra, Lazimi, Haxhiymeri, Haxhirexha, Pilku, Tërshana, Leksani, Laçi, Qylafku, Resuli, Rusi, Fishta, Zeraliu, Kuriu, Kujofska, Brekofska, Pasholli, Lleshi, Mullahi etj.

Historia e Tiranës është një histori edhe e dibranëve, ndoshta më e bukura histori dashurie që reziston prej më shumë se një shekull. Më mirë e përshkruajnë fjalët e këngës së Haxhi Maqellarës:


"Un' me zemër fort të du'
se si ti nuk gjej në botë,
me dash borxhin o me ta shly
asnjëherë nuk ta laj dot."

(Botuar për herë të parë në indibra.al)

Dibranët respektuan bujarinë, dashamirësinë dhe mikpritjen tiranase. Ata nuk kërkuan të bëheshin të parët e vendit, nuk zaptuan asgjë me forcë, por u bënë njësh me autoktonët. Tironsit falën shumë dashuri, hapën dyert e shtëpive të tyre, por edhe dibronët ia kthyen mbrapsht.

Ustallarët duarartë dibranë ndihmuan tiranasit të riparonin e ndërtonin shtëpitë e tyre, që deri në atë kohë në pjesën më të madhe ishin të ndërtuara me qerpiç, pra, Tirana ishte trupi dhe dibranët ishin krahët.

cyan magenta yelloë black



SHITET

1 200 m² katror sipërfaqe e përdorshme për biznes dhe banim.
300 m² lokal, bar kafe dhe restorant, i përshtatshëm për dasma, 100 m² kuzhina.
4 apartamente, me dy dhoma të mëdha gjumi dhe 2 të tjera me një dhomë.
Restoranti ka katër banjo moderne dhe një dhomë ndërrimi.
Lokali në katin e parë është 200 m² + magazinë, qilari është 30 m².
Bari - 30 m² brenda dhe 140 m² ambienti i jashtëm.

Për një vizitë në pronë, kontakto: ***068 65 08 441*** ***ramizgjini@yahoo.com***



SARINA 2002

Më shumë se një zgjidhje...

REGJISTRIMET KANË FILLUAR

Çmimi vetëm për mësimdhënie
për 1 vit akademik:

CIKLI 9-VJEÇAR: 100 000 lekë

CIKLI I MESËM: 120 000 lekë



Adresa:
Autostrada Tiranë - Durrës,
Km.1, Përballë Vodafonit.
Cel. **068 20 37 865**
shkollasarina@gmail.com
www.sarina2002.edu.al

SHKOLLA SARINA 2002

REKLAMO BIZNESIN TËND

Një faqe e plotë me ngjyra kushton 15000 lekë

Me **1000** lekë mund të rezervosh një reklamë gjatë gjithë vitit në format kartvizite (8x5cm)

NE jemi gazetë e lirë dhe e pavarur nga ndikimi politik. Pavarësia dhe liria jonë garantohet vetëm nga mbështetja e lexuesve...
BËJ PAJTIMIN TËND!

Një pajtim vjetor kushton: **600 lekë.**
Në Europë: **10 Euro.**
Në SHBA dhe vende të tjera: **15 USD**.
Pajtimi në Europë dhe SHBA është vetëm në versionin PDF.

Botimi i gazetës është punë vullnetare, ndaj çdo pajtim vjetor ose dhurim, është i mirëpritur. Dhurimet pranohen vetëm përmes llogarisë bankare që gjendet më poshtë dhe për çdo rast ai do të bëhet publik.
Raiffeisen Bank, Rr. Kavajës, Tiranë. Swift code: SGSBALTX.
IBAN(ALL): AL44 2021 1219 0000 0000 1003 6640

KËRKOHET GAZETAR

Kërkohen një gazetar me kohë të pjesshme. Detyra kryesore është të shkruajë dhe raportojë për ngjarje që ndodhin në qarkun e Dibrës.

Të interesuarit duhet të kenë pasion gazetarinë.

Përbën avantazh përvoja në shtypin e shkruar ose në qoftë se kanë mbaruar studimet për gazetari dhe letërsi. Të jenë të angazhuar për punën në grup dhe të jenë të pavarur politikisht gjatë kohës që bashkëpunojnë me gazetën.

Të interesuarit të komunikojnë me redaksinë.

Tel. **069 20 68 603**
E-mail. **rrugaearberit@gmail.com**



Rruga e Arbërit nr. 168

recensë

Autori i këtij libri, që e ka lidhur jetën me gjeologjinë, i dhimsen shkatërrimet e Institucioneve të Gjeologjisë. Ai thekson se: ***"Kombet krenohen me historinë e institucioneve akademike, ndërsa qeveria jonë, edhe për të vetmen godinë simbol, ku janë përgatitur mbi 4800 kuadro të shkencave të tokës, Fakultetin e Gjeologjisë dhe Minierave, nxjerr VKM për t'ia kaluar Gjykatës së Lartë".***


"SHËNIME NË ÇADËR" NJË LIBËR ME VLERA SHKENCORE

Nga prof. **BASHKIM LLESHI**

Në muajin janar të këtij viti doli nga botimi libri "Shënime në Çadër" me autor Vesel Hoxhën. Kam patur fatin të njihem me Veselin, sapo mbaroi shkollën e lartë për inxhinier gjeolog në Fakultetin e Gjeologjisë dhe të Miniera Tiranë, kur drejtoria e Ndërmarjes Gjeologjike të Bulqizës e emëroi të kryente stazhin e diplomës në Ekipin Gjeologjik të Dhoksit, bashkë me mua që do të isha njëkohësisht udhëheqësi i diplomës së këtij inxhinieri të ri. Mbështetur në rezultatet e larta të arritura në mbarimin e shkollës së mesme dhe asaj të lartë, duke qenë dhe kuadër vendas me perspektivë u caktua të kryejë temën e diplomës në vendburimin e kromit të Bulqizës, një nga vendburimet më të mëdha të kromit jo vetëm në vendin tonë por edhe në shkallë botërore, njëkohësisht një nga vendburimet më të vështirë për të punuar një gjeolog i sapo dalë nga shkolla, mbështetur në intensitetin e madh të punës dhe vështirësive për t'u njohur shpejt me ndërtimin dhe strukturën e këtij vendburimi, për të punuar si gjeolog i pavarur në zbulim. Por mbështetur në përgatitjet e larta në shkollë, inxhinieri i ri Vesel Hoxha e kapërceu këtë shkallë dhe u ingranua në njohjen e vendburimit të Bulqizës edhe në sajë të vullnetit të tij të fortë, ç'ka nuk e kanë arrritur disa gjeologë vendas para tij, që brenda vitit janë larguar në ekipe të tjera kërkimi sepse nuk e kanë përballuar intensitetin e madh të punës në Ekspeditën e Bulqizës. Ai kujton vështirësitë e ndjekjes së këtyre punimeve, natën e ditën në borë e acar, ndjekjen e punimeve nëntokësore të shpimit, në zonën Qëndrore e Galerinë 34 të zonës "D" afro 2000 ml. të gjatë, të ulët e me kthesa të mëdha, me ujë deri afër gjurit, Bulqizën ku duhet të ishe i gatshëm gjatë 24 orëve, se mund të lajmëronin edhe natën, që sonda ka takuar mineralin e kromit dhe inxhinieri bashkë me teknikun duhet të niseshin natën, më këmbë ose me makinë për të shkuar të bënin matjen e thellësisë së shpimit. Inxhinier Veseli e kapërceu dhe e përballoi këtë situatë të vështirë dhe në saj të bashkëpunimit më inxhinierët e vjetër që punonin në këtë vendburim si i ndjeri Koço Gushi nga Gjirokastra që punoi mbi 17 vite në Bulqizë dhe u nda para kohe nga jeta, Bashkim Jahja, etj. Kështu dy vitet e para të punës së tij në venburimin e Bulqizës ishin shkolla e dytë e përgatitjes së tij, për të punuar si gjeolog zbulues i pavarur, në çdo objekt apo venburim tjetër, këto dy vite ishin si kurs i lartë pas universitar për tu përgatitur si gjeolog zbulues. Në fillimet e punës së tij ai kujton dhe punëtorin e urtë, fjalë pak e të palodhur, drejtorin e Gjeologjisë së Bulqizës, Ismail Loshën.

Ndërmarja Gjeologjike e Bulqizës, rreth 85-90 % të punimeve i kishte në venburimin e Bulqizës e zonën për rreth saj, aktivitetin për kërkimin e mineraleve të dobishme në pjesën tjetër të territorit, nga Maqellara në Peshkopi, Sllovë e Kala të Dodës, Muhur, Katër Grykët, Dardhë e Reç dhe Lurë e kryente EGJ Peshkopi. Kështu që kjo ekspeditë kishte nevojë për gjeologë të përgatitur, volumi i pakët i punimeve që kryhej duhet të ishte me efektivitet sa më të lartë. Mbështetur në këto kërkesa, falë edhe përgatitjes në vendburimin e Bulqizës si gjeolog zbulues, u plotësua dhe dëshira e inxhinier Veselit për të punuar në zonën e Korabit që ishte ngjitur me vendlindjen e tij në pjesën veri-lindore.

Që në faqet e para të librit ai kujton me nostalgji fillimet e punës në zonën e Korabit, nga përgatitjet e bazës materiale me çadra e paisje guzhine në Bulqizë, rrugëtimin e parë me shoferin e urtë e punëtor Bujar Lala, takimin me Isuf Dobin e Muhurrit që do të bëhej transportuesi i ekipit, takimin e parë me Sherif Brikën në kafenenë e Ploshtanit, mbresat e takimit me mësues Destan Vishën nga Cereni, që tani ishte K/këshillit të Bashkuar të Kalasë së Dodës, për të marrë konfirmimin për punëtorët sezonalë që do të punonin gjatë verës dhe arritja më në fund në fshatin Tejzë (Radomirë) ku do të shkarkonim makinën sepse më tej, transporti i materialeve për në Bjeshkën e Abazallarëve, ku do të vendosej baza e ekipit me çadra, do të bëhej me kafshë. Materialet për siguri i shkarkuan në oborrin e Postës së kufirit me lejen e komandantit Kozma Ziu nga Berati, me të cilin Veseli bisedoi për lejet e kufirit të punëtorëve, për lëvizjet se ishte zonë kufitare, njohjen me k/postës tjetër, lurianin Lenin Vladi, etj. Dy banorët e parë që takoi në Tejzë ishin mësuesit e fshatit, Mersim Sopoti nga Brezhdani e Nazmi Laçi nga Bresti i Poshtëm. Edhe ato kishin kushte shumë të vështira në fshat se nuk mund të shkonin çdo natë në shtëpi.



Botimet M&B, Tiranë 2020
ISBN: 978-9928-307-19-4

Kujton transportin me kafshë të bazës nga Tejza në Bjeshkën e Shehut, ndihmën e k/postës me ushtarë të kufirit, ngritjen e bazës dhe ardhjen e lëndës eksplozive të shoqëruuar nga Lik Skarra e Ramadan Pali, sigurimin e saj sipas rregullave, takimi me punëtorët e parë që erdhën tek çadrat si, Ever Lamallari, Misim Daku, Xhevat Shehu, Esat Selmani, Sherif Ferhati, Skënder Domi, Avni Përzhilla, etj. nga fshatrat për rreth, të guzhinierit Gani Kolgjini dhe ardhjen e teknikut të vjetër e me eksperiencë Ali Bardhi nga Sina, që vetëm emrin kishte teknik por kishte aftësitë e një inxhinieri, me të cilin edhe unë kam punuar dy vitet e para në Lurë dhe ruaj kujtime të paharruara. Ai u nda nga jeta para kohe, por puna dhe kontibuti i tij në Ekspeditën e Peshkopisë nuk do të harrohen. Kujton nxënësin e shkëlqyer të Prrenjasit, Xhelal Sulin dhe kontributin e tij si topograf në Ekspeditën e Peshkopisë.

Me ngritjen e çadrave në malin e Korabit filluan punimet e kërkimit në këtë zonë, në fillim punimet e rilevim kërkimit. Inxhinier Veseli, që në faqet e para të këtij libri nënvizon se***: "Një gjeolog që nuk ka punuar në terren, veçanërisht në rilevimet gjeologjike, nuk mund të pretendojë të merret me shkencat gjeologjike. Pa rilevime gjeologjike nuk ka shkencë gjeologjike. Ky është një postulat që po anashkalohet dhe harrohet".*** E nënvizova këtë citim të tij sepse nuk mund të bësh gjelogji pa punë në terren dhe pa laborator. Inxhinier Veselit i qëlloi fati të punojë në zonën e Korabit, zona më e komplikuar e vendit tonë nga ana gjeologjike, ku me punën e tij këmbëngulëse dhe me përkushtim në terren arriti të bëhet një gjeolog i kompletuar edhe në fushën e kërkim rilevimit dhe të punojë si gjeolog i pavarur.

Por zona e vështirë kërkonte edhe bashkëpunim, të cilin ai arriti t'a realizojë duke bashkëpunuar me gjeologët më të mirë të vendit tonë, të cilët filluan të jenë edhe mysafirët e parë në çadrat e gjeologjisë, afër majës së Korabit, që aq bukur e me pasion i përshkruan autori në faqet e këtij libri. Ato ishin profesorët e gjeologjisë në Fakultetin e Gjeologjisë dhe të Minierave dhe specialistët e Instiutit të Gjeologjisë, që punonin në grupet e Hartës gjeologjike në shkallë 1: 200 000, grupit të Studimit të hekurit, Studimeve stratigrafike etj., ku Veseli ishte dhe bashkëpunëtor i këtyre studimeve. Mysafirët e parë në Çadër ishin K/gjelogu Sali Bushi dhe specialistët më të mirë të Shërbimit Gjeologjik Shqiptar, shumica e të cilëve sot janë kthyer në ikona e personalitete të shkencës së gjeologjisë shqiptare si, dekani Eshref Pumo, profesorët Vangjel Melo (studiuesi i parë shqiptar i zonës së Korabit), Selam Meço, Jorgo Kanani, Andon Grazhdani, specialistët e grupit të Hartës dhe grupeve të tjera të Institutit si, Minella Shallo, Shyqyri Aliaj, Pandeli Pashko, Polikron Theodhori, Alaudin Kodra, Abedin Xhomo, Vangjel Kici, mineralogu i shquar Petro Kati,

Libri "Shënime në Çadër" nuk ka vetëm vlera shkencore për gjeologjinë e gjeologët por, ai është shkruar edhe me një nivel të lartë artistik duke u bërë i lexueshëm edhe për të gjitha shtresat e tjera të interesuara, për t'u njohur me pasuritë e mëdha nëntokësore e mbitokësore, mineralet metalorë e jo metalorë, pasuritë e mëdha ujore, me bukuritë e mahnitshme turistike e gjeoturistike...

mineraloge Dylbere Gjokuta, zv/drejtori i Institutit Feti Arkaxhiu, gjeologët Nuredin Osmani, Enver Bushi, Vangjel Qirici e Nikoll Meshi, gjeofizikantët Zoto Rjepaj e Aleksandër Kospiri etj.

Gjatë viteve që kam punuar në Institutin e Gjeologjisë edhe unë kam qenë mysafir në Çadrën e tij, gati 2-3 herë në vit së bashku me shoferin shembullor e të papërtuar Tiranas, që punonte me mua, Ramazan Vrapin e pa harruar, i cili kishte aftësi dhe si kuzhinier dhe në bagazhin e makinës mbante një kamineto, disa paisje kafeje e kuzhine dhe 2-3 arka të vogla me ushqime e zarzavate dhe kudo që të ndaleshim në mal, pinim ndonjë kafe, ose gatuanim ndonjë gjë të shpejtë në kushtet e malit, për të ngrënë vetë, apo për të gostitur edhe ndonjë mysafir të rastit në mal. Ai brenda 10-15 minutash ishte në gjendje të përgatiste ushqim për 4-5 veta dhe e shtronte në tavolinën e vogël portative dhe thoshte: *"Hajde bujrum, urdhëroni të hamë me këto që na ndodhën",* që aq bukur e përshkruan dhe Veseli në kujtimet e tij. Ai shkruan për kujtimet me mua që në Ekipin e Dhoksit në Bulqizë, në Peshkopi, Korab e deri kur erdhi në Tiranë.

Nga viti në vit njohuritë e ti shkencore vinin duke u rritur. Zona e Korabit nuk është perspektive vetëm për minerale të dobishme metalore e jo metalore, por ka perspektivë edhe për naftë dhe gaz. Për këtë duhej bashkëpunimi me specialistët më të mirë të Institutit të Naftës e Gazit në Fier që u bënë mysafirët tjerë të inxhinier Veselit si, Fotaq Lula, Petraq Naço, Engjëll Prrenjasi, etj. për kryerjen e studimit "Mendime për ndërtimin gjeologjik dhe vlerësimin e mundësisë së perspektivës naftë-gaz mbajtëse të rajonit Veleshicë-Kostenjë" mbi bazën e të cilit është projektuar dhe një shpim kërkues në zonën Ura e Çerenecit-Okshtun me thellësi 2 500 m, i cili nuk është kryer. Kujton bashkëpunimin me specialistët e tjerë të naftës si, Mynyr Arapi, Luftar Bandilli, Telo Velaj, Skënder Miftari, Eleni Gjani, etj. Vite më vonë do të vinte prof. Fotaq Diamanti për studimin e Evaporiteve në zonë e Korabit, së bashku me specialistët, Telo Velaj, Skënder Miftari, Irakli Prifti, Eleni Gjani, Vladimir Veizaj, Adem Hyseni, Vangjel Ndroi e Vesel Hoxha.

Miq në çadrat e tij në Korab kanë qenë dhe disa specialistë të shquar të gjeoshkencave si, Prof. Pierre Vergely (francez), specialistët gjermanë, prof. Peter Koenigskof e dr. Eberhardt Schindler së bashku me prof. Selam Meçe, specialisti gjerman dr. Martin Holzapfel dhe ai bullgar Xhorxh Paraskov.

Me punën dhe përkushtimin e tij, ai diti të bashkëpunojë me këto personalitete shkencore, të gjeologjisë së mineraleve të dobishme të ngurta dhe të naftës, të marrë nga eksperienca e tyre dhe arriti brenda një kohe jo shumë të gjatë të futet në radhët e tyre. Në sajë të këtij bashkëpunimi dhe punës me përkushtim të tij u arrit që të deshifrohet më tej gjeologjia, stratigrafia dhe perspektiva mineralmbajtëse e kësaj zone. ***Ky bashkëpunim do të ngelet si model i bashkëpunimit në historinë e gjeologjisë shqiptare.***

Gjatë punës në Korab, mysafir në Çadër erdhi dhe një student nga Sllatina e Dibrës, Alban (Ahmet) Çollaku të cilin falë rezultateve të shkëlqyera të arritura në fakultet e mbajtën pedagog, i cili më vonë u specializua në Francë ku mbaroi doktoratën me rezultate të larta. Kujton takimin në Peshkopi me gjeologun e madh francez, prof. Jean Paul Cadet, udhëheqës i doktoratës së Albanit "Zhvillimi gjeodinamik i Shqipërisë së Veriut" së bashku me dy udhëheqësit shqiptar, profesorët Vangjel Melo e Aleks Vranai. Në vitet 2002-2003 erdhi në Shqipëri në krye të kompanisë franceze "Coparex" për kërkimin e naftës në Shqipërinë e mesme dhe vazhdon të punojë në kompanitë më me emër botëror të naftës e gazit, si drejtor i Studimeve për Evropën dhe Afrikën, nga Bukureshti në Kongo, Algjeri, etj.

Bazat ku vendoseshin çadrat lëviznin nga Bjeshka e Abazallarëve të Vleshës, afër Bjeshkës së Shehut, në Përroin e Lushit, në pyllin e Mështeknave në Kijavec, etj. deri sa u vendosën më në fund në bazën e rregullt me baraka mbi Postën kufitare të Ploshtanit, poshtë Sorokolit. Sa herë që ndrronte bazën do t'i vinte në ndihmë përgjegjësi për punimet minerare në Ekspeditë, zjarmëtari Lik Skarra që i njihte mirë banorët dhe zonën ku do të punonin.

Autori sjell në kujtimet e tij të gjithë punonjësit që e rrethonin, kujton teknikët Ali Bardhi e Halit Koka, elektriçistin e pa përtuar Isuf Lela, kolegët e EGJ të Peshkopisë, Esat Manjani, Sakip Elezi, Selim Muça, Niko Kita, Nexhat Hysa, Xhelal Suli, Muharrem Sturçe, Adli Baholli, Isa Mandri, Emërllah Kolgjini, Miftar Islami, etj.

Puna në zonën pranë trojeve të tij të lindjes, i zgjoi kujtimet e fëmijërisë, kohën kur ishte fare i ri dhe kulloste delet në Çelias, në Çeliasin ku ishte rritur dhe Skënderbeu i cili sipas historianit të shquar prof. Kristo Frashëri, *"kishte lindur në Sinë dhe ishte rritur në Çelias"*. Çeliasi ndodhet vetëm 500 m larg Blliçes, po aq larg edhe fshatit Kukaj, vendbanimi i Pal Kukajt, bashkëkohës i Skënderbeut, dhe 1000 m larg fshatit Kastriot, vendbanim i Gjon Kastriotit, babait të Skënderbeut, kujton maloren e Kodrës së Bitrit, burimet e fshatit si, Kroin e Milecit, të Arrave, Dertit, Lajthisë e Sadikut, xherizet në Vneshtë, Kodrën e Gjatë, Kodrën e Pareve, Përroin e Gramës, varrezat e rrethuara të lagjes e të fshatit, etj. etj.

Me mall e dashuri kujton mësuesin e klasës së I-rë, Aqif Sherif Spatën, në sitën e të cilit kanë dalë shumë breza nxënësish, si: Sakip Dauti, Munir e Vesel Hoxha, Ruzhdi, Ilir e Esat Spata, Shaban, Maliq e Muhamet Bitri, Lazam e Hamdi Nezha, Ismet Kuta, Nuri Noka, Pajazit Noka, etj., nuk harron as mësuesit e tjerë të kësaj shkolle, Miftar Bushi, Selim Noka, Nazmi Kaci, Skënder Kuta, etj. kujton moshatarët e tij, Majune, Rrushe, Sakip, Ramiz, Xhetan, Halim e Din Dauti, Dije, Gani, Imer e Fatmir Bitri, Ilir, Esat, Ajet e Agim Spata, Hamdi, Nuri e Rexhep Noka, Hysen Tota, etj. Kujton mësuesin e vjetër Zotëri Ahmet Çaushin, që më vonë për disa vite do të ishte edhe kryetar i Këshillit të Përgjithshëm të Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, mësuesin e gjuhës dhe letërsisë në shkollën 7 vjeçare të Fushë Alies, shkrimtarin e shquar dibran, Xhafer Martini.

Kujton bariun e deleve, xha Bajramin me opinga e kësulën e bardhë, vuajtjet e moshatarit të tij Sakip Dauti, i cili megjithëse kishte mbaruar arsimin e lartë ekonomik me rezultate shumë të mira, sistemi i atëhershëm nuk e lejoi të ushtrojë profesionin e tij. Kur rastësisht e takoi Veseli dhe mësoi se ishte pa punë, e mori në punë punëtor dhe më vonë u bë brigadier e zjarrmëtar i EGJ Peshkopi, ku edhe doli në pension.

Gjatë periudhës që ka qëndruar në Ploshtan ai kujton pritjen e këtyre malësorëve bujarë, kujton në veçanti, Basri Litën, nënë Adivijen (motra e Lik Skarrës) dhe Bajram Litën në Ploshtan, prindërit e Halit Kokës në Stredok, etj. në shtëpitë e të cilëve shkonte si në shtëpinë e tij, kujton pritjet e ngrohta të banorëve të Kalasë së Dodës, kësaj krahine me emër në të gjithë Shqipërinë si: si Maliq Ganiu (Lika), Mahmut Hasani (Përzhilla), Daut, Hysen e Vait Përzhilla, Ibraim e Njazi Shehu, Hamdi Kamber e Sabri Ferati, Qerim Skeja, Jonuz Visha, Muharem Baloshi, Tosum Kolgjini, Rrahman Sufa, Ali Jakupi, Veli Koka, Ramadan Hima, Jaho Kasemi, Eshref e Avzi Visha, Sherif Brika, Sami Koka, Sami Isai, Abaz Palushi, Enver e Veli Lamollari, Mersim e Esat Selmani, Xhabir Domi, Misim e Agim Daku, Etem Madana etj. etj., dhe shumë punëtorë të gjeologjisë të kësaj zone si, Njazi Hima, Safat Hoxha, Veli Lamallari, Sherif e Agim Ferati, Xhevat Shehu, Vasip Manallari, Adem Sufa, Adem Përzhilla, Skënder Domi, Halim Mandri, kuzhinierin Agim Ferati, Faik Feratin nga Kullasi (Çernjeva) makinistin e Diagaçit të Luftës së II-të Botërore me të cilin transportonim materialet e sondave, zhurma e të cilit dëgjohej në gjithë Kalanë e Dodës, kujton të gjithë punëtorët e punimeve sipërfaqësore të kanaleve e puseve, minatorët e galerive, sondistët e shpimeve, etj. numri i të cilëve arriti në 130 punonjës, me intensifikimin e punimeve të kërkim zbulimit në këtë zonë.

Gjatë punës në Korab dhe në zonat e tjera të Dibrës me shokët e Ekipit, Ekspeditës apo me miqtë e ardhur nga Tirana ka rastisur të shkojë për ndonjë vizitë, ku mund t'a kenë mbajtur dhe për darkë ose drekë, sigurisht në familjet që i njihte ose kishte miqësi, duke filluar nga familja e tij

vlerësim

Në të gjitha institucionet ku ka punuar Vesel Hoxha është karakterizuar nga thjeshtësia, drejtësia, ndërgjegja, përkushtimi, profesionalizmi dhe niveli shkencor i kryerjes së punimeve e studimeve.

PËR GJEOLOGJINË, EKONOMINË, HISTORINË, TURIZMIN, etj.

Me punën dhe përkushtimin e tij, Vesel Hoxha diti të bashkëpunojë me personalitete shkencore të gjeologjisë së mineraleve të dobishme, të ngurta dhe të naftës, të marrë nga eksperienca e tyre dhe arriti brenda një kohe jo shumë të gjatë të futet në radhët e tyre. Në sajë të këtij bashkëpunimi dhe punës me përkushtim të tij u arrit që të deshifrohet më tej gjeologjia, stratigrafia dhe perspektiva mineralmbajtëse e kësaj zone. Ky bashkëpunim do të ngelet si model i bashkëpunimit në historinë e gjeologjisë shqiptare.

në Blliçe, ku i priste babai i tij Ramadan Hoxha, një nga burrat më të zgjuar të fshatit Blliçe. Ai tregon për pritjet që i kanë bërë Basri e Bajram Lita i Ploshtanit, Mexhit Paci i Cerjanit, Ali Hoti i Borije Lurës, Shefki Lleshi i Zogjeve të Dibrës, apo tek miqtë e tij të Tole në Çidhën, etj.

Në vitin 2001 mbron disertacionin po për zonën e Korabit dhe fiton gradën shkencore "Doktor". Në vitin 2014 fiton titullin shkencor akademik "Profesor i asociuar" .

Përgatitja nga ana profesionale gjatë punës në Korab e bëri që në vitin 2006 të transferohet në Drejtorinë e Përgjithëshme të SHGJSH në Tiranë, në vitin 2008 në Institutin e Gjeoshkencave të UPT. Gjatë kësaj periudhe ai kujton bashkëpunëtorët e tij, Ibrahim Milushi, Safet Dogjani, Nezir Mekshiqi, Idriz Jata etj.

Duke qenë një nga njohësit më të mirë të gjeologjisë së Korabit, së bashku me prof. Kodrën morën pjesë në projektin e korelimit gjeologjik ndërkufitar (Shqipëri-Kosovë), kujton bashkëpunimin me drejtuesin e këtij projekti prof. Murat Meha dhe kolgun Dukagjin Shala, kujton marshutat deri natën vonë në bjeshkët e Sharrit, në Restelicë, Brod, Krushevo, Zli Patok, Gllboçicë, etj.

Gjatë punës që ka punuar në Bulqizë, Korab dhe EGJ Peshkopi ai ka dhënë një kontribut të rëndësishëm në sqarimin e gjeologjisë dhe stratigrafisë së kësaj zone, duke konkretizuar dhe objekte të mineraleve të ngurta metalore e jo metalore si të kromit, hekurit, manganit, bakrit, polimetaleve, vanadit, etj., dhe mineraleve të tjerë jometalorë, si squfur, mermere, argjila, travertina, bojra dheu, gjipse, anhidrite, selenite, inerte, kuarcite, ranorë, gëlqerorë, pirofilite, etj. të cilat janë një pasuri e madhe për rajonin e Dibrës. Për secilën nga këto pasuri ka studime e raporte ku Inxh. Veseli është autor ose bashkëautor kryesor, të cilat në mënyrë të përmbledhur jepen edhe në kapitullujt e këtij libri, si : "Pasuritë minerale të rajonit të Dibrës që mund të vihen në qarkullim ekonomik me ndërtimin e Rrugës së Arbërit" mbajtur në Kuvendin Tekniko-Shkencor për Rrugën e Arbërit më 7 maj 2007 dhe "Përmirësimi dhe ndërtimi i rrugëve lidhëse me Rrugën e Arbërit të njësive Administrative të Peshkopisë, Kastriotit, Çidhnës, Lurës, Dardhës, Reçit, Sllovës, Kalasë së Dodës, Tominit e Melanit, me rëndësi për zhvillimin e mëtejshëm të ekonomisë, turizmit malor e historik" mbajtur në Konferencën shkencore të LID "Përmirësimi dhe ndërtimi i rrugëve lidhëse me Rrugën e Abërit", më 12 maj 2019.

Në këto referate krahas mineraleve të dobishme metalore e jo metalore, përshkruhen dhe pasuritë e mëdha ujore që ka Dibra të cilat kërkojnë një vlerësim e menaxhim më kompleks, ku përmenden, burimet sulfidrike të llixhave të Peshkopisë, mbi 40 burime ujore të freskëta në gjithë teritorrin e Dibrës, lumi Drini i Zi që e përshkon luginën e Dibrës nga Viçishti në jug deri në Draj Reç në veri dhe në të derdhen nga të dy anët e luginës zalle e përrej të fuqishëm, nga malet e Bulqizës, Balgjajt, Korabit e Lurës ka mbi 70 liqej të bukur malorë dhe të gjithë së bashku përbëjnë një pasuri ujore shumë të madhe të kësaj treve, që bashkë më mineralet, po të vihen si duhet në shërbim të ekonomisë së tregut do t'i shërbejnë ***zhvillimit të mëtejshëm ekonomik të Qarkut të Dibrës.***

Pasuritë turistike dhe gjeoturistike të Dibrës kanë vlera të pallogaritëshme për ekonominë e kësaj treve, ku përmenden: pejsazhet mahnitëse të gjipseve dhe anhidriteve, liqenet akullnajore të Selishtës (gjithsej 40), të Lurës (13), të Korabit (10), të Bulqizës (8), etj., Fusha e Panaireve, bjeshkët e Korabit, Lan Lurës, Muhurit e Selishtës, etj.

Dibra është e pasur me monumente e gjeomonumente të natyrës. Ndër gjeomonumentet me vlera të jashtëzakonshme (regjionale ballkanike dhe europiane) përmend vendburimin e kromit Bulqizë, një VB unik për nga përmasat, rrudhosjet e trupave të mineralit të kromit, vendburimi kristalor i gjipsit të Radikës (Seleniti), masivi gjipsor i malit të Bardhë në Sllovë e Radomirë, formimet paleozoike me graptolite në zonën e Muhurit, Kanioni i Setës, Monumente të tjera me rëndësi kombëtare si, ujrat termominerale të dy Dibrave, minralizimi i Squfurit Kërçisht, Rafshi i Korabit (1 500 - 1 600 m), Fusha e Panaireve (mbi 2 000 m), etj., Gjeoparqet e Lurës, Selishtës, etj. etj. të cilat kërkojnë një inventarizim e studim të mëtejshëm, sepse edhe ***zhvillimi i gjeoturizmit malor është një drejtim tjetër i rëndësishëm i zhvillimit ekonomik të rajonit të Dibrës.***

Në këto referate ngrihet edhe problemi i rezervave hidrike të pashfrytëzuara, në të gjitha degët e zalleve e përrejve të mëdhej malorë që derdhen në lumin Drini i Zi, rekomadohet kryerja e studimeve të mirëfillta shkencore, për të ruajtur dhe mjedisin, ngre problemin e ndërtimit të tre Hec-ve në luginën e Drinit të zi, duke debatuar me baza shkencore me gazetarin Ashiku, i cili me të drejtë është i shqetësuar për trojet që mund të përmbyten nga rezervuari i Hec-it të madh të Skavicës, apo variantit me tre Hec-e, por argumentave të tij u mungon mendimi teknikoshkencor. Për këto shqetësohet me të drejtë autori i librit, ashtu siç shqetësohet kur për problemet e tërmeteve të fund vitit 2019, apo fenomene të tjera gjeologjike si rrëshqitjet, etj. pyeten e japin mendime nëpër media, diletantë e gazetarë të pa informuar dhe nuk pyeten gjeologët, gjeofizikanët, apo personalitet shkencore të kësaj fushe, të cilët tek ne nuk mungojnë.

Rajoni i Dibrës nga Qafa e Buallit deri në Kala të Dodës është pëllëmbë e histori. Me ndërtimin e Rrugës së Arbërit do të bëhen të vizitueshme nga vendas e të huaj, Kalaja e Petralbës, Fusha e Vajkalit, Gurët e Skënderbeut, Valikardha, Peladhia, Vendbanimet e herëshme të Krajkës, Sofraçanit, Topojanit e Allabejgisë, Gropat e Ukut, Gjurra e Mazhicës, Monumentet historike të Dibrës së Madhe (Xhamitë Inqari e Bajram Beg, Kishat Shën Mëria e Shën Jovan Preteça, Manastiret Bigorski (Mbi-gurit) e Shën Gjergji fitimtari, Kështjella e Qyteti i Sfetigradit, Kalaja e Modriçit, etj.), Kalaja e Grazhdanit, Kastrioti, Kisha e Gjonit, Zabeli i Kukës, Kulla e Gjonit, Ogradja e Gjonit, Guri i luftës, Kulla e Gjonit, Ferra e Pashës, Beteja e Arrasit, Muzeu i Kastriotëve në Sinë, Hambarët e Skënderbeut, Ara e Trojës, Troja, Arat e Gjegjës, Kalaja e Skënderbeut mbi Kanionin e Setës, etj, etj. të cilat do të bëhen të vizitueshme dhe do të kenë një ***rëndësi shumë të madhe për njohjen e mëtejshme të historisë dhe zhvillimit të turizmit historik të këtij rajoni.***

Ai ka ndjekur me intteres të veçantë kalvarin e gjatë të studimit e ndërtimit të Rrugës së Arbërit, që në fillimet e saj, në përpjekjet e para të shoqatës "Nisma Dibrane" me ish kryetar Iljaz Kacën dhe aktivistët Hysen Uka, Bujar Karoshi e shumë të tjerë, është aktivizuar në shoqatën LID në Tiranë duke marrë pjesë në aktivitetet e saj shkencore dhe ka ngritur e mbështetur problemet shqetësuese për të mos prishur standartet e ndërtimit të saj, duke shkruar vazhdimisht në gazetën Rruga e Arbërit, siç është artikulli "Rruga e Arbërit, Rruga e zhvillimit të Shqipërisë Lindore" botuar në maj 2007, që botohet i plotë në faqet e këtij libri, etj.

Autori i këtij libri që e ka lidhur jetën me gjeologjinë i dhimsen shkatërrimet e Institucioneve të Gjeologjisë. Ai thekson se: *"Kombet krenohen me historinë e Institucioneve akademike, ndërsa Qeveria jonë, edhe për të vetmen godinë simbol, ku janë përgatitur mbi 4800 kuadro të shkencave të tokës, Fakultetin e Gjeologjisë dhe Minierave, nxjerr VKM për t'ia kaluar Gjykatës së Lartë"*. Sulmi ndaj Institucioneve të Gjeologjisë e Minierave, që i kanë dhënë aq shumë kombit tonë, ka filluar që me fillimet e demokracisë, në fillim të viteve nëntëdhjetë kur godinën e Institutit të Gjeologjisë dhe godinën e Alb krom-bakrit, dhe Institutit të Kimisë e gjysmën e godinës së N/Gjeofizike, ia kaluan KESH-it, duke mos pyetur për shkatërrimin e laboratorëve, bibliotekës, muzeut dhe ambienteve të tjera të Institutit të Gjeologjisë, Kimisë dhe Gjeofizikës, duke vazhduar më vonë me godinën e N/Gjeologji-Gjeodezi ku shkatërruan dhe laboratorin e gjeomekanikës së shkëmbinjve i paisur me makineritë e kohës, ku u vendos për disa kohë dhe Gjeoalba, për t'ia kaluar Sistemit të Shëndetësisë, apo deri veprimet e viteve të fundit kur Drejtorinë e Përgjithëshme të SHGJSH ku ishte dhe Fondi Qëndror i Gjeologjisë e degdisën në Repartet Ushtarake tek Rapi Tresh, për t'a kthyer në godinë të Prefektit të Qarkut të Tiranës, a thua se zyra e Prefektit kishte rëndësi më të madhe se SHGJSH apo FQGJ, etj.

Ai me të drejtë shqetësohet për degjenerimin e reformave, për shkrirjen e Instituteve Shkencore, për problemet që dalin para shkencave gjeologjike, për ndërtimin e rrugës Arras-Lurë si domosdoshmëri për zhvillimin e turizmit dhe kërkimin e mineraleve, si dhe për rrugët e tjera lidhëse me Rrugën e Arbërit, për zhvillimin ekonomik, të turizmit malor e historik në rajonin e Dibrës, etj. për të cilat ka folur gjërë e gjatë në shtypin e shkruar dhe në faqet e këtij libri.

Falë përgatitjes së tij dhe disa bashkëmoshatarëve nga ana letrare, që në shkollën 7 vjeçare, nga mësuesi i letërsisë, shkrimtari i shquar dibran Xhafer Martini, ai e mbyll librin "Shënime në Çadër" me 3 vjersha që ua kushton kolegëve të tij si: "Gjeologëve", "Jua di hallet kolegëve të mij" dhe "Për shokun tim të fëmisë Ilir Lazim Spata", boton disa perla nga libri i Ilir Spatës "Legjenda e një fisi" dhe vjershën që i ka kushtuar ai, shokut të fëmijërisë, Veselit, kujton dhe një herë besimtarët Daut Përzhilla (babai i ish K/kooperativës Shaban Përzhilla) e Maliq Ganiu (Lika), myfti Ahmet Çaushin, Hamdi Feratin, Bajram Litën, Xhafer Martinin, ku përmend librat e shumtë të tij me karakter studimor për kulturën popullore, si: "Kanuni i Dibrës", "Perlat e Dibrës", "Gjakmarrja", "Dashuria me shikim të parë", "Pajtimi në traditën popullore", "Fjala priu", "Tregime të rralla popullore", "Ese filozofike me motive popullore", "Tregime mitologjike", 'Pedagogjikasit", "Kur vdiste Kanuni", duke përfunduar me kujtimet e mbresat për mikun e tij të paharruar Maliq Bitri.

Mbështetur sa munda të përshkruaj shkurtimisht më sipër, libri "Shënime në Çadër" nuk ka vetëm vlera shkencore për gjeologjinë e gjeologët por, ai është shkruar edhe me një nivel të lartë artistik duke u bërë i lexueshëm edhe për të gjitha shtresat e tjera të interesuara, për t'u njohur me pasuritë e mëdha nëntokësore e mbitokësore, mineralet metalorë e jo metalorë, pasuritë e mëdha ujore, me bukuritë e mahnitëshme turistike e gjeoturistike dhe monumentet e shumta historike, që ka treva jonë e begatshme Dibra, vënja në lëvizje e të cilave do zhvillojë më tej ekonomikisht atë.

Vitet bëjnë punën e tyre, prof. Vesel Hoxha ka dalë në pension, por edhe tani vazhdon të jetë energjik e plot pasion, siç e mbaj mend, para 46 vitesh kur filloi punën në Bulqizë, dhe me këtë rast i uroj jetë të gjatë e plot shëndet, për vazhdimin e punës së mëtejshme shkencore dhe në përfundimin e monografive: "Gjeologjia dhe mineralet e Dibrës" e "Rreziku gjeologjik i Dibrës", etj., me rëndësi të madhe, jo vetëm për Dibrën, por edhe për Kombin.

Jeta dhe veprimtaria e profesor asoc. dr. Vesel Hoxha

Vesel Ramadan Hoxha lindi më 20 tetor 1952 në fshatin Blliçe, bashkia Dibër. Shkollën fillore dhe 7 vjeçare i kreu në vendlindje dhe në Fush Çidhën më 1966, me rezultate të shkëlqyera. Më 1970 kreu po me rezultate të shkëlqyera Teknikumin e Minierave dhe të Gjeologjisë në Prrenjas të Librazhdit, ku diplomohet Teknik i Mesëm Markshajder. Në vitin 1975 kryen me rezultate shumë të larta Fakultetin e Gjeologjisë dhe të Minierave dhe diplomohet Inxhinier Gjeolog për Minerale të Dobishme të Ngurta. Në vitin 2000 mbaron SHPU-në, ku fiton Dipllomën e Studimeve të thelluara Pasuniversitare. Në vitin 2001 mbron me vlerësimin "Shumë mirë" disertacionin me temë : "Tiparet themelore të gjeologjisë dhe perspektiva e kërkimeve në rajonin Kërçisht-Sorokol" dhe fiton gradën shkencore "Doktor". Në vitin 2014 Këshilli i Profesorëve të FGJM-së i jep titullin shkencor akademik "Profesor i asociuar" .

***Eksperienca në punë** : Në vitin 1974 fillon stazhin e diplomës së shkollës së lartë në Ndërmarjen Gjeologjike Bulqizë (NGJB), Ekspedita Gjeologjike (EGJ) Dhoks, në vitin 1975 inxhinier gjeolog në EGJ Bulqizë për kërkim–zbulimin e mineralit të kromit. Më qershor 1976 transferohet në EGJ Peshkopi (Ekipi i Korabit), ku punoi për kërkimin e mineraleve të hekurit, manganit, dhe metaleve të çmuara. Më 1984 emërohet kryetar i EGJ Peshkopi. Në periudhën 1993-1995 zgjidhet Kryetar i Këshillit Drejtues të NGJB. Gjatë vitit 1996 komandohet drejtor i NGJB. Më 1988 emërohet përgjegjës i Sektorit të Gjeologjisë Peshkopi, më 2003 drejtor i Degës Rajonale Gjeologjike Peshkopi.*

Më 2006 transferohet në Drejtorinë e Përgjithëshme të SHGJSH në Tiranë. Më 2008 në Institutin e Gjeoshkencave të Universitetit Politeknik të Tiranës, në Departamentin e Gjeoresurseve dhe Gjeoinxhinierisë, si drejtues i grupit kërkimor të mineraleve dhe po këtë vit zgjidhet anëtar i Senatit Akademik të Universitetit Politeknik të Tiranës. Nga viti 2011 e në vazhdim, punonjës shkencor dhe drejtues i projektit për Hartën e re Metalogjenike të Shqipërisë, në DGJGJ të Institutit të Gjeoshkencave, Energjisë, Ujit dhe Mjedisit. Më 2005 deri më tetor 2017, punonjës shkencor në geupin kërkimor të Metallogjenisë në Departamentin e Gjeologjisë, të IGJEUM-it. Nga viti 2009 deri më 2015 ka dhënë leksione si pedagog i jashtëm në FGJM, në lëndën "Rilevim Gjeologjik dhe Gjeomorfologjik" për studentët e degës së Gjeoinformatikës (Bachelor) dhe gjatë vitit akademik 2016-2017 ka dhënë leksione në lëndën "Vendburimet e mineraleve të dobishme të ngurta dhe kërkimi i tyre", për degët e Gjeoinformatikës dhe Inxhinierisë Gjeologjike (Bachelor). Në të gjitha institucionet ku ka punuar e ka karakterizuar, thjeshtësia, drejtësia, ndërgjegja, përkushtimi, profesionalizmi dhe niveli shkencor i kryerjes së punimeve e studimeve.

***Kontributi shkencor:** Ka kryer rilevime të shkallëve të ndryshme në rajonet e Dibrës, Kukësit , Matit, Klosit dhe Bulqizës, krahas punës në kërkim-zbulimin e mineraleve metalore të kromit, hekurit, manganit, bakrit, polimetaleve, vanadit, etj. dhe mineraleve të tjerë jometalorë, si squfur, mermere, argjila, travertina, bojra dheu, gjipse, anhidrite, selenite, inerte, kuarcite, ranorë, gëlqerorë, pirofilite, etj. Është angazhuar në studime të gjeologjisë inxhinierike, gjeomjedisit, hidrogjeologjisë, etj. Ka bashkëpunuar me kompani të hueja në rajonin e Korabit, Vrenjtit, Muhurit dhe Lurës në vitet 1993-1997, për kërkim-vlerësimin e gjipseve, mermereve, bakrit, mineraleve të çmuar, etj. Në vitet 2006-2016 ka punuar si specialist i jashtëm pranë kompanisë gjermane "KNAUF". Është autor dhe bashkëautor i mbi 127-të studimeve, raporteve, relacioneve, projekteve, prezantimeve gjeologjike, etj. në konferenca e kongrese brenda e jashtë vendit si dhe i mbi 22 artikujve shkencorë të botuar në buletine e revista shkencore vendase e të hueja. Disa nga studimet që ka drejtuar janë: "Harta gjeologjike dhe e pasurive minerale të rrethit të Dibrës në shkallë 1:50 000 dhe teksti shpjegues i saj" (1999), "Administrimi i teritorit dhe resurseve natyrore në rrethin e Dibrës, të Qarkut Dibër" (2001-2003), "Harta e rrezikut gjeologjik për rrethin e Dibrës në shkallë 1: 50 000 me tekstin shpjegues përkatës"(2004-2005), "Evaporitet e Shqipërisë dhe mineralmbajtja e tyre" (2009-2012). Ka bashkëpunuar në studimet madhore për gjeologjinë, mineralmbajtjen dhe metalogjeninë e Shqipërisë. Po përgatit për botim monografitë shkencore: "Gjeologjia dhe mineralet e Dibrës" dhe "Rreziku gjeologjik i Dibrës".*

Në vitet 2007 dhe 2019 ka marrë pjesë në Kuvendin Tekniko-Shkencor dhe Konferencën Shkencore për Rrugën e Arbërit, të organizuar nga Shoqata LID, ku ka qenë bashkëautori kryesor i dy referateve të mbajtura në këto aktivitete. Ka shkruar vazhdimisht në gazetën "Rruga e Arbërit" dhe në organet tjera të shtypit duke ngritur probleme të rëndësishme për riorganizimin e Institucioneve Shkencore të Gjeologjisë, për zhvillimin ekonomik të Qarkut të Dibrës, etj.

Megjithëse tashmë në pension ai vazhdon aktivitetin e tij shkencor. Sapo ka botuar si bashkautor dy artikuj shkencorë me mbi 65 faqe në revistën shkencore të Akademisë së Shkencave të Shqipërisë në numrat 1, respektivisht të viteve 2019, 2020 (JNTS – Journal of Natural and Technical Sciences). Në janar të këtij viti nxori nga botimi librin "Shënime në Çadër", vlerat shkencore dhe ekonomike të të cilit po i prezantojmë shkurtimisht në numrin e kësaj gazete. Vazhdon të shkruajë artikuj shkencorë në revista shkencore brenda e jashtë vendit, si dhe në organet tona të shtypit.

Rreth vëllimit me fabulla "Valle çmendurie" i autorit Qemal Cenaj

"Valle çmendurie", libër për dukuritë e jetës

Nga **MEVLUD BUCI**

Ky libër "i vogël" është me 91 faqe, por i madh në përmbajtje, dritëkohorë e mbi të gjitha diagnostigues ndaj dukurive të jetës, stigmatizues ndaj politikës denigruese bashkëkohore, pasqyrë e ndritshme ndaj negativitetit aktual, përqeshës ndaj falsitetit drejtues e servil, zhvatës e mashtrues të të votbesuarëve a postdhimbjeve të pa merituar.

Në çdo fabul, te çdo varg, lexuesi i kujdesshëm zbulon dukuri të jetës, ballafaqon realitetin me atë çka ndodh nën petkun e pozitës, të votbesimit a të ngjitjes aty ku shpërfaqet formalizmi, maska a lajkataria çnjerëzore.

* * *

Autori Cenaj, ky punëtor i denjë i pendës, publicist, poet e fabulist i talentuar, pas disa botimeve të arrira që te "Fol o Mat", kohët e fundit doli para lexuesve me librin e thjeshtë, por të rrallë fabulistik "Valle çmendurie", ku te çdo fabul, strofë a varg, përcjell mesazhe bashkëkohore, ka shkruar me syrin e "okulistit" të shoqërisë, ka "diagnostikuar" dukuritë e jetës, veset, antivlerat, falsitetit e politikës, të politikanëve megallomanë e drejtuesve burokratë, servilë e zhvatës, të lindur për dredhí.

Përvoja krijuese e Qemal Cenajt të Matit është rrezatuese, e përgjegjshme, këmbëngulëse e mbi të gjitha e kuptueshme, tërheqëse dhe e frymëzuar për lexuesit. Puna si drejtues i gazetës "Mati", shembëllimi prej specialisti novator në disa profesione, përkushtimi gazetaresk, poetik, publicistik e shpirti krijues në gjininë e fabulës, bëjnë pa mëdyshje që Qemal Cenaj (jo për hiperbolë, por për realitet) të quhet "Ezopi i Matit". Pra, dëshmitë e botimeve, ndjesitë lirike e mbi të gjitha shembëllimi ndaj dukurive bashkëkohore tregojnë se Cenaj i Matit ka një përvojë të çmuar, ka prova krijuese e mbi të gjitha mjeshtëri artistike e thellësi mendimi, talent e thjeshtësi në trajtimin e dukurive, të cilat i hapin horizonte dhe frymëzojnë lexuesit.

Dihet se Mati, vatra e Budit e plot filozofëve, vatra e poetëve Milloshi, e të talentuarit studiues Behar Gjoka, lirikut Basir Bushkashi, mjeshtrit e të palodhurit, poetit Hamdi Hysuka, bilbilit të shkrepit Bajram Canameti, të poetëve të shquar Kujtim Stana, Fatmir Gjestila, Fatmir Neli, Rakip Lasku, Faik Xhani, studiuesit Artan D. Kurti; të historianit, ushtarakut e studiuesit Sefer Duka, studiuesit Aqif Ymeri etj, dëshmohet se është vatra e pasuesëve të Budit, e studiuesit të paharruar Dilaver Kurti; vatra e bilbilave popullorë e plot jehonë për kombin, babë e bir Ymer e Behar Nelaj, Sabri Aliaj, të shquarit të krijimtarisë e studimeve muzikologjike, Esat Ruka e deri te poeti më i ri, Sokol Llozhi e plot të tjerëve në plot gjini krijimtarie të çmuar për kohën, traditat e për brezat tanë.

* * *


Krijimtaria fabulistike e Qemal Cenajt ka filozofinë e kohës, mençurinë e matjanit, mbart vlera e mesazhe jete, godet me art, satirë therëse, si dhe i bën lexuesit të meditojnë, të njohin antivlera të veshur me petkun e pozitës, me petkun e politikanit a deputetit. Në fakt realiteti është ai që shkruan z. Cenaj te "Valle çmendurie", valle e ekstremizmit anti njeri-tjetrit, valle për karrierë të pamerituar, për maska, servilizëm, burrokraci të shfrenuar, valle me të pazotë që u kundërvihen vlerave, të zotit, bilbilit. Cenaj shkruan:

Valle nisin me finesë,
pula, gjela, shpend të pyllit
dhe hutini me përtesë
dajrexhi, nis e i bie fyellit…

Grindjet, sharjet, shitmendjet, trifytyrësia, servilizmi, mburrjet pa bukë, pa baza, zënë vend në vargjet fabulistike:

S'dinë të sillen, nga t'ia nisin
e kush ndjek më melodi
njeri-tjetrin veç çukisin,
ti je çmend, / i çmendur ti…

Autori Cenaj është vëzhgues i hollë, di të godasë, të demaskojë me art atë çka ndodh sot në politikën makbethiane të etur për pasuri, dredhi, amoralitet, favore e pabesi, e vetdemaskuar në sy të brezave. Fabulisti Cenaj stigmatizon konformizmin, të krekosurit, boshët e kohës, ata që



siç thotë populli, bëjnë të 99-tat e hiqen "hizra", "shenjtorë" në postet që kanë ngjitur me stile dredhie:

U puthën dhe u lëpinë
u hëngrën dhe u shtynë
por u lodhën, veç më kot
mesin e botës s'e gjenin dot…

(Mesi i botës, strofa e dytë)

Fabulat e Qemal Cenajt janë një "rrufe" shpartalluese mbi politikën, postet fallco, formalizmin, shtetarët lubí, ekspertizat e bufanadat në udhët e jetës:

Një maune bef në derë,
thanë komshijtë: Ka sa herë..
atë mëngjes video perfekt
pa vonesa nga arinjtë ekspertë
konkluzioni krejt i rrallë
kish shkarkuar vetëm fjalë.

(Ekspertizë, faqe 6)

Me plot domethënie, filozofi e mesazhe jete janë fabulat "Klloçka", "Besa", "Vendimmarrje", "Gomari dhe pela", "Pas një viti", "Turtulli", "Zarfi", "Koha", "Vendi i shenjtë", "Daci dhe ujku" etj. Kontrastet çnjerëzore, vetëfundosja e karakterit të politikanëve, e shtetarëve me tri fytyrësi, dekorimet bujamanë e të bëra me interes, apo të pa merituara, demaskimi ndaj falsitetit në lartësimin e vlerave tregon se fabula e Cenajt godet në shenjë, është një sprovë e ndritur për t'ia hequr qafe popullit padrejtësitë, antivlerat:

Dikur bëhej humor me ca kokrra,
sot jepen medalje për ca monstra…

(Dikur, faqe 13)

Vargu fabulistik i Cenajt ka mjeshtëri, figurë, përcjell mesazhe, të cilat i vlejnë njeriut, shoqërisë. Me anonimí autori godet. Pra, siç thotë populli, "Lum kush e ble fjalën!" Shoqëria, shteti, të eturit për karrierë, veset e kohës së demoshkërdhatokracisë që mbart sot njerëzia, shpërfytyrimi i të ngriturve në pushtet, ato çka sjell emigracioni etj, janë në "shpatën" e mprehtë të zotit Cenaj:

Jashtë stine delja polli,
pështpërin tufa në mëhallë
me kureshtje vesh më vesh
i gjori dash, kurbetqarë…

(Përgojim, faqe 20)

Filozofia matjane, përvoja krijuese, vëzhgimi i hollë, real e konkret i jetës, kohës, politikës (pordhithikës shqiptare M. B) si dhe mjeshtëria e trajtimit të urtësisë populloree i bëjnë fabulat e Qemal Cenaj tërheqëse, domethënëse, të çmuara e mbresëlënëse për lexuesit. Fabulat "Proverbi", "Reklamë", "Filli dhe lëmshi", "Akuzë", "Kush jam", "Në provim", "Në valikë" përcjellin ide, mesazhe, kritika therëse, si dhe mbi të gjitha goditje ndaj ligësive të kohës.

Autori Cenaj, mjeshtër e punëtor i pendës, siç është dhe në jetën shoqërore, e shikon jetën

"Valle çmendurie" është dëshmi e kohës, pasqyrim i problemeve, ku me art e mjeshtëri ironizohet politika e politikanët, të cilët ia kanë bërë vendin që të demaskohen. Autori Cenaj, me përkushtim e sinqeritet, me urti e mjeshtëri fshikullon veset, antivlerat, dinakërinë, e cila bleron te politika e politikanët shterpë.

në sy. Ata që ngjiten dhe zbresin, ku lënë pas pafytyrësisë zhgënjimin e përsëri llomotisin, grinden, shajnë, turren e harbohen sikur duan popullin, sikur janë "të zot", pasqyrohen te fabula "Anasjelltas":

Fat i madh të ishte kështu,
"jemi ne, se jeni ju"
e kundërta s'kuptohet vërtë,
"ikni ju, se jemi ne"…

Kontrastet, metaforat, simbolet, urtësitë, vargu brilant me domethënie filozofike, realizmi dhe mjeshtëria krijuese, zënë vend në çdo fabul të këtij libri. Vetë titulli "Valle çmendurie" nënkupton politikë e politikanë të çmendur, larg popullit, larg halleve, të vetshpallur "demokratë", apo "shtetarë", prijës të rrallë, por që në të vërtetë bëjnë petulla me ujë, siç thotë populli. Shtiren meleq e janë dreq, "mjeránia politikë"…

Me të drejtë, pa mëdyshje e pa fare hiperbolë, theksojmë se Cenaj i Matit e meriton të quhet "Ezopi matjan", Ezopi i kohës. E çfarë bëri më shumë Ezopi?! Siguristht ai ishte real i kohës, goditës e satirik i shquar. Këto vlera i ka dhe libri fabulistik "Valle çmendurie". Pra, vallja e mat valltarin. Kur del tek ajo duhet intuit, mençuri, frymëzim e mjeshtëri në interpretim. Pra, politika e politikanët s'duhet të çmenden, siç janë vërtetë:

Politika në plan të parë,
ushqeheshim dikur
të dehur tash nga mrekullitë,
e para dhe e fundit pikë
mjeránia politikë… (Ngre e ul, faqe 29)

Autori Cenaj nëpërmjet anasjelles (inversionit) "mjeránia politikë" damkos marrëzinë e "baballarëve të kombit", të atyre që vlojnë vëretë si kazan, apo siç e thonë matjanët e urtësisë, "bëjnë si arrat në thes".

Fabulat e Qemal Cenajt dëshmojnë se si intelektuali, mjeshtri i punës, njeriu i vlerave, jeton në kohën dhe godet antivlerat, ata që nuk çmojnë besimin, drejtësisë, mirësinë njerëzore:

Matanë gardhit ham e hum,
qen kamshiu, s'di të ndali
bëhet buça tërë inatë,
soji i tij është qen çakalli…

(Qen çakalli, faqe 30)

Fabulat "Ndryshim", "Shteg", "Kohë e re", "Dhelpra", "Në festival", "Tabelë frymëzimi", "Tapia", "Modë", "Miza dhe grenza", përcjellin mesazhe jete, vendosin në shpatën e kritikës dukuritë negative, siç thotë fabulisti:

Për të pasurit është shumëzimi,
për të varfërit është pjestimi…

(Tabelë shumëzimi, faqe 36)

Padrejtësia dhe falsiteti, krekosja dhe fundbataku njerëzor trajtohen me katër vargje nga fabulisti Cenaj:

Për një emër profesioni,
shkollë pas shkolle vite plot
shko, merr sot një kartë partie,
është diplomë dhe pilot..

(Lartësimi, faqe 42)

Demaskimi i dinakërisë, i mburrjes, qylxhiut, dredharakut, falsitetit në dashuri, injorancës, servilizmit, harresës e padrejtësisë ndaj djersës së humbur (Harresë, faqe 57), llafollogët shterpë, dështakët servilë etj:

Hajnisë veç iso i mban,
fol e qesh dhe gjë nuk ndan
në të shumtën kacafytja,
u rri pullë dhe në llum zhyutur…

Antiteza e kohës, kontrasti çnjerëzor, utopia e karrierës, demaskohen artistikisht në fabulën "Zvarranikët", faqe 62, ku autori Cenaj jeton me kohën dhe godet në shenjë nëpërmjet ironisë. Fabulat e tij bëjnë diagnozën e atyre që gërthasin, të atyre që janë provuar e përsëri trumbetohen e zotohen. Autori jep me mjeshtëri e realizëm se si duhet të shmangeni nga e kaluara, apo e sotmja që ripërtërit neodiktaturën në mënyrë të maskuar, ndaj "s'duhet të mbetemi shpresëvrarë", thotë fabulisti:

Do i "pushtojmë" lartësitë,
boll kemi ndejtur duke prit
vendimi i prerë dhe pikë,
një herë një kohë tiqeshim zvarrë
s'mund të mbetemi shpresëvrarë…

(Zvarrankët, faqe 62).

Vargjet *"i tha qeni qenit"* (Lemeri), / nuk hyj më pa trokitur (Edukatë), apo *"s'po ndahej me gomar jaranin"* (Gomarica) etj, godasin dinakërinë, stigmatizojnë dukuritë, të cilat duhen fshikulluar. Të shkruara me frymëzim dhe mjeshtëri janë edhe fabulat "Vjetulla e dhelpra", "Bima dhe ferra", "Gazeta", "Bushtrat", "Zogjtë shtegtarë", "Pacienti i fshatit", "Ndodh", "Bashkëbisedim" etj. Ortaklleku, konformizmi, politika shterpë dhe e dalë boje, anonimia ndaj ligësive, aktualitet allashqiptar:

Ulkonja dhe dhelpra,
xhiro në një ditë
nënat e mashtrimit,
pa presje e pikë…

(Bashkëbisedim, faqe 74).

Libri me fabula "Valle çmendurie" është dëshmi e kohës, pasqyrim i problemeve, ku me art e mjeshtëri ironizohet politika e politikanët, të cilët ia kanë bërë vendin që të demaskohen. Autori Cenaj, me përkushtim e sinqeritet, me urti e mjeshtëri fshikullon veset, antivlerat, dinakërinë, e cila bleron te politika e politikanët shterpë. Libri "Valle çmendurie" është vallja e kohës, e atyre që prijnë në valle e s'dinë ta heqin, por bëjnë si të çmendur. Është vërtetë koha epope, për dukuritë e jetës. Urime Qemal Cenaj i Matit, i shqiptarisë!



botim i ri

***Sh. Sinani*: Besoj se libri do t'i ndihmojë brezat e rinj jo vetëm për të njohur paraardhësit, por edhe kushërinjtë e tyre. Në këtë kohë largësimi, ky është një shërbim që meriton nderim.**

Muhurri, histori dhe personalitete
- një enciklopedi e gjithë zonës

Prof.dr. **SHABAN SINANI**

Përse duhet të lexohet libri i Halil Ramës për Muhurrin, vendlindjen e tij, zonë e përmendur në historinë e vjetër dhe të re të Dibrës?

Kësaj pyetjeje do t'i përgjigjem me përshtypjet që më la ky libër gjatë leximit të parë, në daktiloshkrim, me mirësinë e autorit.

Duhet lexuar sepse është shkruar me shumë dashuri, deri në tepërim, për dymbëdhjetë katundet e kësaj zone, njëri me histori më të pasur se tjetri; një prej teprimeve më të përligjura në punët e autorësisë, që është një mister, aq mister sa vetë *Bāsi, Krijuesi*, sipas fjalës së përdorur në librin e parë shqip.

Ismail Kadare, në vitet 1960, kur ishte për studime në Moskë, në poezinë *Malli i Shqipërisë* shkroi edhe këto dy vargje:

Ata që shpikën shpejtësinë reaktive,
Larg atdheut sigurisht do kenë qenë ndonjëherë.

Dhe ja ku vijmë sakaq tek arsyeja e dytë. Janë me mijëra ata banorë të fshatrave të Dibrës (dhe Muhurrit) që e kanë lënë *Itakën* e tyre dhe tani ndodhen në kryeqytet e rreth e përqark. Janë kryeqytetas. Janë harruar cilësimet përkeqësuese për ta, janë miqësuar me vendësit e vjetër, siç ka ndodhur gjithnjë me dibranët. Është një çështje më vete të shpjegohet pse, bashkë me krahina të tjera, u shpopullua edhe Muhurri. Por një gjë është e qartë: një brezi të ri të të shpërngulurve prej andej, në s'u mungoftë sot, një ditë do t'u mungojë vendlindja, historia e familjes, e fisit; do t'u mungojnë varret e të parëve, kishat dhe xhamitë, dasmat dhe ritet tradicionale.

Nuk është traditë në viset veriore të Shqipërisë të shkruhen gjenealogjitë e fisit dhe kronikat familjare. Afërsisht 15 vjet më parë, kur isha ngarkuar të drejtoja rrjetin arkivor të Shqipërisë, shërbimin e dokumenteve për gjenealogji, e kisha zgjidhur me rregullore që të bëhej falas.


Atëherë, si të marrin lehtë të dhëna të përgjithshme dhe të njohin të parët e tyre, djemtë dhe vajzat muhurrake, tashmë qytetarë të Tiranës apo Durrësit?

Libri i Halil Ramës është zgjidhja më komode. Sepse është një enciklopedi e gjithë zonës, prej hershmërisë antike deri në kohët moderne, me bëmat dhe gjëmat e saj, pa kritere përjashtuese, duke filluar prej përshkrimit gjeofizik deri tek ai etnografik e historik; mbështetur në kujtesën e shkruar dhe atë gojore. Besoj se libri do t'i ndihmojë brezat e rinj jo vetëm për të njohur paraardhësit, por edhe kushërinjtë e tyre. Në këtë kohë largësimi ky është një shërbim që meriton nderim.

Lexuesi duhet ta dijë se autori i këtij libri ka lexuar shumë dhe është munduar shumë. Edhe studiuesi mund të përfitojë. Sidomos në kohën e sotme, që pak mundësi ofron që studiuesit shqiptarë të bëjnë ekspedita kërkimore në terren.

Një grup studiuesish rusë të shqipes dhe dialekteve të saj, një dekadë e ca më parë, kanë bërë kërkime dhe regjistrime të folësve të Muhurrit dhe dy vëllime me lëndën gjuhësore të mbledhur janë botuar bashkë me regjistrimet zanore. Dy dekada të shkuara në Muhurr bënë kërkime studiues bullgarë që kishin interesa shkencorë për zhvillimin historik të identitetit të shqiptarëve.

Libri i Halil Ramës është një iniciativë vetjake, nuk është projekt akademik apo institucional, por burimet që ofron, edhe në mos qofshin të gjitha të vërtetueshme, janë me dobi të veçantë për studiuesit: etnologë, antropologë, dialektologë, folkloristë, edhe historianë po të doni.



MUHUREI, HISTORI DHE PERSONALITETE
Halil Rama
Botimet M&B, 2020

Konsulentë:
Shemsi Prençi,
Sakip Cami

Redaktore:
Luljeta Dishi (Prençi)

Recensentë:
Dr. Hajri Mandri,
Dr.Selman Mëziu

Foto e kopertinës:
Edmond Hasani

ISBN:
978-9928-307-42-2
Faqe: 712
Çmimi: 2000 lekë

"Edhe unë jam nga Muhurri!"

*Prof.dr.***BUJAR KAPEXHIU**
"Nderi i Kombit"

Vendlindja, trualli që gjymtyrët prekin për herë të parë, ku për herë të parë thithin ajrin e kësaj toke, ku lëshon pikën e parë të lotit dhe ku zëri lajmëron vazhdimësinë e jetës, duke përcaktuar që prej atij çasti emrin e këtij trualli që do e ndjekë pas gjithë jetën, deri në përjetësi. Fjalët e bukura e të ndjera janë në nderin dhe fisnikërinë e atij që di të respektojë e të falënderojë këtë tokë që e priti.

Nuk ka krahinë në Shqipëri me më shumë tituj librash, të shkruar e të botuar nga autorë dibranë. Kjo më bën të shpenguar, të sigurt e bindës kur them: Nuk është e rastit që fjala Dibër rimon bukur me fjalën Libër. DIBËR - LIBËR. Askund tjetër nuk e gjen këtë lidhje. Vërtetësinë e këtij përcaktimi, me

Mbas leximit të librit edhe unë, si dibran, tashmë jam i bindur më mirë, më saktë e më hollësisht për vendin, ngjarjet me njerëzit. Njoh Muhurrin. E kështu, me plot gojën, nuk gaboj kur them se unë jam nga Muhurri!

këtë togfjalësh e përforcon dhe shkrimtari e publicisti dibran Halil Rama, që deri tani ka botuar 16 libra... E sa e sa të tjerë pas këtij libri. Vetëm ai e di... Ne, si lexues, presim.

Përkushtim, seriozitet, dinjitet, dashuri, mall, respekt, mburrje, nostalgji, krenari, të gjitha së bashku këto ndjesi, si një gjerdan gurësh të çmuar në gjoksin e Halil Ramës, japin shkëlqimin dhe meritën e të suksesshmit që çdo muhrrak e çmon dhe e vlerëson këtë punë, që duke mbledhur germë pas germe, ashtu siç milingona punon, ka ngritur me pasion këtë kështjellë kryelartë, të pakrahasueshme të Muhurrit.

Mbasi vështrimi shkëputet nga rreshti i fundit i librit dhe gishtat me delikatesë mbyllin kopertinën, për një çast kupton që, me njohuritë që ke marrë për historinë e vjetër dhe të re, ngjarjet e personazhet, me hollësitë e pafund të fshatit, vetvetiu të mbështjell një ndjesi e brendshme krejt e veçantë, deri aty sa edhe ty të ngjan vetja si të jesh një banor i hershëm i Muhurrit. Edhe kjo meritë e autorit, në kohën kur sot fshatin po e braktisin, me leximin e këtij libri duket sikur fshati shtohet me banorë të tjerë të rinj, që e njohin aq mirë Muhurrin, edhe pse në formë virtuale.

Një privilegj për muhrrakët, se kudo, në çdo cep të botës që të jenë do të kenë pranë vetes malet, fushat, lumin, lulet, shtëpitë, komshinjtë, familjen e gjithë të njohurit e dashur e të shtrenjtë të vendlindjes, për të mos i harruar kurrë. E nëse një ditë, larg, aty ku je, të merr malli e i thua vetes po shkoj në fshat, tani e ke më të lehtë, se bën dy hapa dhe fshatin e ke të gjithin në raftin e bibliotekës, si një dhuratë të çmuar nga bashkëfshatari yt, tashmë aq i njohur për krijimtarinë e tij, Halil Rama.

Mbas leximit të librit edhe unë, si dibran, tashmë jam i bindur më mirë, më saktë e më hollësisht për vendin, ngjarjet me njerëzit. Njoh Muhurrin. E kështu, me plot gojën, nuk gaboj kur them se unë jam nga Muhurri! Nuk beson? Më pyet për gjithçka e jam gati të të jap përgjigjen për të gjitha e me hollësi.

Në faqet e këtij libri, midis rreshtave, si në një pasqyrë, çdo muhrrak do të shohë veten dhe do të arrijë në përfundimin se në këtë pasqyrë të krijuar nga mendja dhe dora e Halilit duket më i mirë, më trim, më punëtor, më i bukur e më i mençur, dhe thellë nga shpirti do t'i dalë urimi për këtë krijues të veçantë, unikal: Faleminderit Halil, krenari e Muhurrit! Paç uratën!

printime dixhitale
me ngjyra dhe bardh e zi
shpejtësi | cilësi | çmime të favorshme
libra | broshura | revista | fletëpalosje
katalogë | kalendarë | postera | ftesa etj.
duke filluar nga 1 kopje e vetme
për informacion: mbbotime@gmail.com / Cel. 069 20 68 603

Ndahet nga jeta kompozitori Përparim Tomçini
Ideatori dhe themeluesi i "Odës dibrane"

in memoriam

Kush ishte **Përparim Tomçini?**

Përparim TOMÇINI u lindur në vitin 1955, në Peshkopi. Në vitet 1970-1974 ka kryer Liceun Artistik " Jordan Misja" Tiranë në degën Teori Muzike. Në vitet 1975-1979 ka kryer studimet në Institutin e Lartë të Arteve (sot Universiteti i Arteve) në degën "Kompozicion" me udhëheqës kompozitorin e njohur Feim Ibrahimi.

• Nga viti 1976-1979 ka qenë bashkëkrijues dhe anëtar i rregullt i grupit muzikor "Na bashkoi kënga popullore" . Në gusht 1979 deri në nëntor 2012 ka qenë pergjegjes i sektorit të muzikës pranë Pallatit të Kulturës "Haki Stërmilli" Peshkopi. Më pas, nga viti 2012 deri në vitin 2015 ka punuar në të njëjtën detyrë pranë Pallatit të Kulturës Kamzë, Tiranë. Në shkurt 2016 kthehet përsëri me punë në Pallatin e Kulturës Peshkopi.

• Që nga vitin 1982 ka qenë anëtar i Lidhjes së Shkrimtareve dhe Artisteve të Shqipërisë dhe po atë vit është zgjedhur edhe kryetar i Lidhjes së Shkrimtarëve dhe Artistëve të rrethit Dibër, detyrë shoqërore që e ka mbajtur deri në vitin 1989. Gjatë dy viteve, 1994 -1996 ka qenë drejtor i Pallatit të Kulturës Peshkopi.

• Që nga maji i vitit 1981 deri në nëntor 2012 ka qenë udhëheqës artistik i të gjitha ansambleve artistike e folklorike të rrethit të Dibrës në festivale të ndryshme kombëtare e ndërkombëtare, ku është nderuar me çmime të ndryshme të dokumentuara rast pas rasti.

• Ka qenë udhëheqës artistik dhe dirigjent i orkestrës së Peshkopisë në të gjitha festivalet kombëtare të këngës qytetare shqiptare që nga viti i themelimit me 1995 në Elbasan. Edhe në këto festivale është nderuar me çmime të ndryshme.

• Ka punuar si kompozitor dhe udhëheqës artistik në shoqëri të ndryshme kulturore artistike shqiptare të Maqedonisë së Veriut si në Dibër të Madhe, Strugë, Gostivar, Tetovë dhe Shkup.

• Në 1994 ka qenë një ndër themeluesit, organizuesit dhe drejtuesit e Festivalit të Parë Kombëtar të satirës dhe humorit popullor nëpërmjet këngëve, valleve, riteve, i titulluar "Oda Dibrane".

Përparim Tomçini ka lënë një trashëgimi të pasur në fushën e krijimtarisë muzikore, në gjini të ndryshme. Është autor i mbi 400 kompozimeve dhe përpunimeve të këngëve e melodive; ndër të cilat mund të përmendim:

• Rapsodi për kor, solist dhe orkestër me titull "Isa Boletini", interpretuar nga kori dhe orkestra simfonike e Institutit të Lartë të Arteve në Koncertet e Majit 1979 me dirigjent Pandi Bellon, e vlerësuar me çmim të dytë;

• Rapsodi për kor, solist dhe orkestër "Rrënjët në gjak i ka liria", interpretuar nga kori dhe orkestra e qytetit të Peshkopisë me solist këngëtarin Arif Vladi në takimin kombëtar të ansambleve artistike të klasës punëtore në tetor të vitit 1984 në Durrës, vlerësuar me çmim të parë në konkursin kombëtar të krijimtarisë artistike me rastin e 40 vjetorit të çlirimit të atdheut.

• Poemi simfonik "Kullat e Boletinit", interpretuar nga orkestra simfonike e RTSh në Koncertet e Majit të vitit 1986, me dirigjent Eno Koçon.

• Poemi vokal simfonik "Ecte komandanti, pas i vinin malet" me tekst të Hysni Milloshit, e vlerësuar me çmim të dytë në konkursin kombëtar të krijimtarisë artistike me rastin e 45 vjetorit te çlirimit të atdheut në vitin 1989.

• Suita simfonike"Fatprerët", kolonë muzikore e filmit me të njëjtin titull, me skenar të shkrimtarit të njohur Murat Isaku Tetovë dhe regji të Xhevat Limanit, Shkup 1999.

• Baladë vokale "Nusja e maleve", me poezi të Naim Plakut, kënduar nga Ilir Shaqiri në vitin 2004, kushtuar dëshmores së UÇK-së Xhevë Lladrovci.



• Poemi vokal "Toka jonë Çamëria", poezia Ndoc Papleka, kënduar nga Arif Vladi në qershor 2008 në Ditët përkujtimore për Çamërinë në Konispol.

• Baladë vokale "Të rroku ballin rrezja e diellit", poezia Naim Plaku, kënduar nga Ilir Shaqiri në vitin 2009, kushtuar aviatorëve të rënë në krye të detyrës.

• Tablo koreografike "Lulëkuqet e Kosovës", luajtur nga grupi i valleve të ShKASh "Xheladin Zeqiri" Tetovë me 1999.

• Elegji "Eja ti, moj nënë", poezia Naim Plaku, kënduar nga Vera Laçi në 1996, si dhe shumë këngë të tjera të kënduara nga këngëtarë të njohur shqiptarë brenda dhe jashtë Shqipërisë.

Është autor i përpunimeve muzikore në mënyrë mjeshtërore të "Këngës së Rexhës", "Pjergullo, moj pjergullo", "Po vjen zogu përreth livadhit", "Po këndojnë pushkët nëpër kulla", "Sefë Kosharja i pari i fisit", "O, prite Azem Galicën" etj., këngë të cilat janë interpretuar me nivel të lartë artistik nga Liri Rasha, Sajhe Poleshi, Qerim Sula, Arif Vladi etj.

Përparim Tomçini, për punën dhe krijimtarinë e tij është vlerësuar me medaljen "Naim Frashëri" nga Presidiumi i Kuvendit të Shqipërisë në Festivalin Kombëtar të Gjirokastrës të vitit 1983. Gjithashtu, është nderuar me Urdhrin "Naim Frashëri" të Klasit III, për Festivalin Kombëtar të Gjirokastrës të vitit 1988.

Presidenti i Kosovës, z.Hashim Thaçi, e ka dekoruar me motivacionin: "Për kontribut të madh për lirinë, për kontributin e madh në muzikë dhe art barazinë dhe pavarësinë e Kosovës. Këngët e tij kanë qenë frymëzim dhe motivim për shumë gjenerata që u angazhuan për liri, barazi dhe pavarësi".

Gjithashtu, ai është nderuar me Medaljen e Mirënjohjes nga Organizata e Invalidëve të Luftës së UÇK-së për kontributin e dhënë me krijimtarinë muzikore që i ka shërbyer kësaj lufte si dhe me mirënjohjen nga Komuna Drenas në Kosovë. Në maj të vitit 2005 është shpallur nga Këshilli i Qarkut Dibër "Nderi i Kulturës Dibrane".

Përparim Tomçini u nda nga kjo jetë më 5 qershor 2020, pas një lufte të gjatë me një sëmundje të rëndë, por puna dhe kujtimi i tij do të mbeten gjatë në kujtesën e kulturës sonë kombëtare.

Një Korab - Kompozitor

Nga Mevlud Buci

U hap fjala e u drodh Runja
Valët Drini seç i ngriti,
I nis vajet nënë Ajkuna
U nda nga jeta Rim Tomçini.

Vëllezërit Sula e Seit burrnia
Si tan Dibra me lot në sy,
Jo,s`vdes vepra e mençuria
Ndrit në mote e histori….

Kullë e fis me gen hyjnori
Dritë e këngës-hov vigani,
Kurorë bjeshke kompozitori
Përparim Tomçini,bir dibrani.

Nderoi brezat, kombin, Dibrën,
Flet me talent e shpirt hyjnori,
"Prite prite Azem Galicën",
Një Korab-kompozitori….

Ne mburreshim me ty!

Nga **ARTAN GJ. HASANI**

Unë jam mburrur me ty pa të njohur, miku im. Njohje përmes ekranit hera e parë. Ka qenë mesi i viteve shtatëdhjetë, kur me gëzim pamë që në ansamblin "Na bashkoi kënga popullore" bënte pjesë edhe një dibran. Rim Tomçini. Një djalosh i qeshur, me trup të vogël, por, siç dëshmoi më vonë jeta, me shpirt shumë të madh.

Rimi, tani që ti nuk je më, njerëzve që të njohën në jetë u vjen ndërmend përmes kujtimeve. Dhe mua mes tyre.

Dhe kujtimet janë enë të padukshme komunikuese në të cilat qarkullon shpirt.

Kam disa ditë që e ndjeja nga brenda që duhet të shkruaja diçka për ty. E ndjeja që duhej, por nuk e dija saktësisht se çfarë ishte ajo "diçka".

I larguar prej shumë vitesh nga vendlindja dhe atdheu, në mes të viteve 90-të kisha botuar librin tim të parë. Kisha ardhur me pushime dhe jetoja në Vlorë, kur im vëlla, i sapoardhur nga Peshkopia, më jep një letër. Ishte një letër e jotja drejtuar mua. Të kishte gëzuar fakti që unë kisha shkruar një libër të cilin e vlerësoje shumë, ishe krenar për mua dhe ndër të tjera më shkruaje që më talentin që kisha, mund të bëhesha një ditë ndërgjegjja e qytetit tonë verilindor. M'u dukën si fjale euforike nga dashamirësia jote e përhershme për mua. Isha çuditur duke vrarë mendjen se si mund të krenohej një ditë një qytet i tërë për mua apo për një tjetër.

Por me ikjen tënde unë kuptova diçka. Atë "diçka" që më shtyu të ulem të shkruaj këto rreshta.

Ti ke qenë vërtet ndërgjegjja e atij qyteti, Rim Tomçini!

Unë kam shumë vite larguar nga ai qytet që nuk është më.

Sa herë që e kujtoj Peshkopinë e dikurshme, atë qytet të mrekullueshëm që s'është më, e kam të pamundur të mos kujtoj disa njerëz, shpirti i të cilëve ushqen pafundësisht enët komunikuese që lidhin një ikanak si unë me qytetin ku lindi e u rrit.

Dhe ti je një prej tyre, Rim. Prandaj edhe i paharrueshëm.

U desh ikja jote, Rim, që unë të ndjeja vërtet që një njeri mund të bëhet njësh me imazhin e një qyteti të tërë. Fjalët që më pate shkruar në letrën e dikurshme.

E folura jote më sjell ndër mend gjuhën e qytetit ku linda e u rrita.

Buzëqeshja jote më kujton mirësinë e banorëve të asaj Peshkopie të dikurshme ku jetuam të dy.

Humori yt i mençur dhe i spikatur më kujton zgjuarsinë plot dritë të atyre njerëzve paqësorë e hokatarë të asaj Peshkopie të dikurshme që nuk është më.

Miqësia dhe dashuria jote për njerëzit më kujton mallin për ata që nuk janë më.

Shumë gjëra të dikurshme nuk janë më.

Ndërsa artisti brenda teje jeton akoma, o mik i mirë, që ike!

Endet nga njëra këngë që ti le pas në tjetrën…

Dhe ke lënë aq shumë këngë e tinguj, sa në qiell nuk ka qetësi.

Të shoh mes erës së kujtimeve që të shpupurit flokët e dredhur, shkon e vjen ashtu me të ecurën tënde hapshpejtë dhe na përshëndet me dorë, ashtu ëmbël, i buzëqeshur dhe duke na shkelur syrin…

Elegji…

Për **dy BURRA që iken** duke lënë dhembje e mall pas…

Si ikin burrat e Dibrës, kur pema e tyre rëndon nga frytet?

Vërtet si ikin burrat e mëdhenj të Dibrës kur pemën e tyre e kanë mbushë me fryte?

Si iku Qerim Sula, dy metër burrë që mbushte skenën me hijeshinë e maleve të Dibrës tek këndonte trimëritë shekullore të dibranëve…

Oh, medet Qerim për ty!

Si iku Përparim Tomçini, nota më e lartë në pentagramin e këngës dibrane?

Oh, medet Përparim për ty!

Herën e fundit që u takuam, 1 nëntor 2015, u bëmë bashkë, në një fotografi, në Bulevardin e Blinjve, në atë bulevard që bashkë me bilbilat e majit kënduat edhe ju, hodhët në pentagram shpirtin tuaj…

Oh, medet Qerim për ty!

Oh, medet Përparim për ty!

Ikët për të na lënë këngën, atë këngën studentore Përparim që aq shumë e kemi dashur, aq shumë e ka dashur rinia: "Na bashkoi kënga popullore"!…

Oh sa mall kam, oh sa bukur këndonit!

Desha të të imitoj Përparim ndaj një ditë bashkova këtu në mërgim valën e këngës labe me furinë e çiftelisë në një ansambël jetëshkurtër "Na bashkoi isoja dhe çiftelia"…

Eh, vështirë ti bashkosh, si vështirë të bashkosh kombin…

Por jo vetëm kur ishe i ri…

Edhe kur u rrite, kur u poqe, kur u fute në meloditë e papërsëritshme të një treve që thoshit se "sapo i është hapur thesi"…

Oh sa melodi e këngë nxorët nga ky "thes"!

Sa i mblodhët dhe paraqitet në festivalet folklorike që nga fshati më i largët i Dibrës e deri në festivale kombëtare!

Sa shumë dhatë vëllezër për Dibrën, sa shumë!

Ikët të rinj, ikët atëherë kur kënga dibrane u donte më pranë se kurrë, kur malet e Dibrës kishin nevojë për male shpirtërore që lart ti ngrenë e bukur ta ndërtojnë folenë…

Ikët njeri pas tjetrit, njeri në fund të majit e tjetri në fillim të qershorit. Ikët në pranverë kur piqet qershia e molla rrit frytet, kur bjeshkët mbushen me lule e kur malet mbledhin e përcjellin



teposhtës drejt Drinit të Zi lotët e dëborës.

Nuk e di, nuk kam fjalë dhimbjen ta shpreh e ngushëllimin ta përcjell…

Nuk kam…

Dhe as do të kem ndonjëherë…

Dhimbjen dhe mallin as fjalë, as fjali, as këngë, as poemë, as roman nuk e mban, nuk e shpreh dot deri në fund.

Por Dibra një fjalë e ka gjete…

Dhimbja…

I ra pemës dhe e thau…

I ra gurit dhe e çau…

I ra njeriut dhe e …

O zot si do ta mbajë kënga, melodia e jetës suaj…

Aq e madhe sa mbetet përgjithmonë…

Ju ikët…

Unë ju kam me vete…

Në një fotografi…

Në një kujtim të bukur…

Do të desha që në Bulevardin e Blinjve dy statuja të shihja për ju, BURRA TË DIBRËS, rënduar nga frytet e këngës dhe muzikës dibrane…

Abdurahim Ashiku

Athinë, 5 qershor 2020







Fjalë zemre nga kompozitorë, këngëtarë, bashkëpunëtorë, miq e të njohur të kompozitorit të madh Përparim Tomçini

ILIR SHAQIRI, *këngëtar:*

Komuniteti i artit muzikor kombëtar sot ka ulur flamurin në gjysmështizë. Është ndarë nga jeta (në moshën 65 vjeçare) kompozitori i papërsëritshëm shqiptar, Përparim Tomçini...

I frymëzuar nga krijimtaria alegorike e Dibrës, nga gurra e pashtershme e folklorit dibran, ai ngriti në skenat artistike perla të muzikës shqiptare; vepra që shtrihen në gjini të ndryshme, si: Rapsodi për kor, Rapsodi për solist dhe orkestër, Suitë simfonike, Poemë simfonike, Elegji korale, Balada vokale, Këngë lirike dhe epike, deri të Tablotë koreografike. Një bagazh i madh artistik që na frymëzoi pamatshëm, plot 40 vjet!

Studiuesit e mëvonshëm do ta gjejnë: forcën, karakterin, mjeshtërinë, jetën e tij në krijimtarinë e tij. Ndërsa ne, miqtë e tij, nuk do ta gjejmë më atë kompozitorin e këngëve me nektarin e "Nëntë Maleve", nuk do ta gjejmë më atë mikpritësin zemër plotë, ngrohtësinë vëllazërore, çiltërsinë dhe argëtimin e pangjashëm, kur shtroheshin sofrat tona në Dibër, Tiranë e Prishtinë.

SHPËTIM SARAÇI, *kompozitor:*

Lajmi i ikjes tënde shumë të parakohshme më tronditi shumë.

Kështu i qeshur, i mirë, i sinqertë, shok i vërtetë, krijues origjinal e çfarë të duash epiteti të mirë mund të shkruash për ty, do mbetesh gjithmonë për të gjithë ne.

Pusho në paqe, o shpirt i bukur!

Avni Ndreu, koreograf:

Për më se 30 vjet patëm një bashkëpunim të shkëlqyer në realizimin e dhjetëra valleve, suitave e tablove koreografike, ku si gjithmonë muzika e krijuar nga mjeshtri Përparim Tomçini do të ishte garanci e suksesit në skenat kombëtare e ndërkombëtare.

EDMOND ZHULALI, *kompozitor:*

Me keqardhje mora lajmin e hidhur të ndarjes nga jeta të kolegut, mikut e shokut të paharruar, kompozitorit të shquar Përparim Tomçini.

Një humbje e madhe për familjen, artin shqiptar e të gjithë shokët e miqtë e tij të shumtë.

Përparimi la pas një krijimtari të gjerë thellësisht kombëtare e me shumë vlera për Dibrën, Kosovën e mbarë shqiptarinë, e cila do ta lartësojë në pafundësi emrin e tij.

Lamtumirë Përparim, miku ynë i shtrenjtë i të gjithë artistëve.

AGIM HUSHI, *tenor*:

Lamtumirë, Përparim Tomçini!

S'e kisha menduar kurrë se do të shkruaja këto fjalë plot dhimbje për ty, miku im!

S'do të harroj kurrë pjekurinë dhe mençurinë tënde, humorin tënd të pashoq, sharmin tënd të rrallë!

Do mbetesh në mendjen time si kolos i muzikës dhe talent i rrallë i këngës popullore dibrane, që i dhe aq shumë jetë nga jeta jote!

Sot po besoj se vdekja do të jetë një vazhdim i jetës!

Se ti s'mund të vdesësh kurrë!

Me buzëqeshjen dhe mirësinë tënde njerëzore!

Isha dhe mbetem krenar që të kisha një mik të madh dhe faleminderit për gazin me gjithë shpirt që më ke falur! Qofsh i parajsës, miku im!

FAIK VOJKA, *muzikant:*

U njohëm me 15 shtator 1970 dhe u ndamë me 5 qershor 2020, për ta kujtuar gjithmonë në përjetësi. 50 vite bashkë, në të mirë e në të keqe. E përbashkëta ime me Përparimin është se ne ndenjëm më shumë me njëritjetrin sesa me vëllezërit dhe motrat tona. Përparimi është kompozitori, folkloristi dhe njeriu që la gjurmë në jetën artistike të Dibrës dhe mbarë trojeve shqiptare. Ishte i dashur, ishte me humor dhe shumë këmbëngulës në punën e tij. Bashkëpunimin e parë me Përparimin e kam me këngën "Pjergullo". Një këngë lirike, e kompozuar nga Rimi dhe ku unë luajta me klarinetë variantin e Gazelit, siç i thoshte Rimi. Më vonë na lidhi aq shumë muzika, sa në shumë këngë, valle, rapsodi e romanca më la të ekzekutoj gjithmonë solist. Nuk mbaj mend që Përparimi të më thërriste në emër. "O Vojkë", - më thërriste. Dhe kështu më thërrasin dhe sot shokët e mi muzikantë. Veprat që ka lënë Përparimi janë madhështore. Duke filluar me këngën për Azem Galicën, Sef Kosharen, Kullat, Këngë për Kosovën, ritet dibrane, këngët lirike e tjerë.

Përparimi ishte pjesë e imja dhe e familjes time. Shpeshherë në bisedat private kërkoja që Përparimin ta



kem mbështetje dhe ma ka dhënë këtë mbështetje si njeri dhe si muzikant. Nuk them çdo dite, por në dy-tre ditë unë isha prezent te familja e Përparimit. Ke xha Hasani e Tota Shime. Kur kam luajtur rapsodinë me klarinetë dhe orkestrën e vitit 1986, pasi mbaroi shfaqja e ansamblit, Rimi më përqafon dhe më merr e shkojmë bashkë me bacën Haziz Ndreu në turizmin e Peshkopisë, ku më thotë "që dolëm mirë dhe tani do pimë nga një gotë"...

Përparimi është ideatori i "Odës Dibrane", ishte udhëheqësi artistik i ansamblit Dibra për më shumë se 40 vite. Kam pasur fat, pasi Rimi ishte njeri me emër në muzikën shqiptare. Bashkë njohëm me dhjetëra miq muzikantë nga Maqedonia, Kosova, Mali i Zi, Presheva e Çamëria. Jeta ime dhe e Rimit ishte e pandarë...

LUNDRIM PAÇUKU, *këngëtar:*

U zgjova me një lajm shumë të hidhur sot.

Të qoftë i lehtë dheu i Shqipërisë Mjeshtër! Do t'i mungosh muzikës, kompozimit, artistëve, mbi të gjitha Dibrës dhe dibranëve.

Të gjithë jemi kalimtarë në këtë botë, sepse jeta është e tillë, megjithatë, ajo që e bën njeriun të pavdekshëm janë veprat dhe kujtimet e ju do të mbeteni i përjetshëm brenda notave dhe në zemrat tona.

ZAIM ELEZI, *piktor*:

Më dhembi shumë ikja jote, Përparim! Jo vetëm pse ishte e parakohshme, por sepse ti ishe një vlerë shumë e madhe e Peshkopisë, Dibrës, Kosovës, gjithë trevave të Veriut e mbarë Shqipërisë. Me krijimtarinë tënde ti ju dhe emër shumë këngëtarëve si Arif Vladi, Lirie Rasha, Qerim Sula, Ilir Shaqiri në Kosovë, Vera Laçi, shumë e shumë të tjerëve. I bëre të njohur,duke kënduar këngët e krijuara nga ti. Por ti nuk kompozove vetëm këngë, por edhe krijime me vlera në gjini të tjera të muzikës. Sa herë i ndaje me mua, kur këto krijime ishin duke marrë formë.

Më le një bosh të madh Pap, jo vetëm mua. Do na mungojë buzëqeshja, humori, historitë humoristike që aq bukur i krijoje dhe tregoheshin nga të tjerë miq e shokë në raste pa fund.

Vështirë të harrohet Përparimi. Ke lënë plot, për të mos ikur Pap!

LIRIM HOXHA, *këngëtar:*

Kush të njohu nga afër, u mrekullua nga çiltërsia jote njerëzore. Ishe plot humor, i dashur, i respektueshëm, me një formim kulturor për t'u pasur zili. Pasuria artistike që le pas është e madhe. Dibra do t'ju jetë mirënjohëse përjetë!

DEFRIM METHASANI, *gazetar*:

Ike dhe ti mjeshtër i muzikës Përparim Tomçini! Ike nxitimthi, në një moshë dhe kohë të paduhur. Drini sot e shtoi rrjedhën, sepse Dibra dhe ata që të njohën ty dhe krijimtarinë tënde si kompozitor i talentuar, derdhën lot. Edhe ti deshe të prehesh në vendlindje, aty ku bëre emrin e madh. Lamtumirë Rimi. Buzëqeshja jote ndaloi sot në stacionin e fundit, ndërsa kujtesa për ty, kurrë nuk do të ketë stacion të fundit...!

BESART GALICA, *gazetar:*

Gjatë rrugëtimit tim si gazetar, anembanë botës e veçanërisht në trojet tona shqiptare, kam takuar njerëz të ndryshëm, politikanë, mjekë, artistë e të tjerë. Por, takimi me Përparim Tomçinin ishte me shumë emocion, ishte kompozitori i këngës së Azem Galicës, një këngë historike. Rimin, siç e thirrnim e kisha përveç mik, e doja fort, pasi brenda tij ishte ajo ndjenja e përbashkët, Shqipëri e Kosovë janë NJË.

Thjesht, frymonim njëjtë! Do të më mungosh o shqipe e Dibrës!

HYSEN UKA, *studiues:*

Ç'lajm i hidhur. Sa e befasishme ikja jote Rim Tomçini. Sa dhimbje e mall le pas, njeriu i pazëvendësueshëm, artisti, miku dhe shoku ynë i shtrenjtë Rim! Sa tinguj, muzikë, ide e projekte artistike që gjallonin e vlonin në kraharorin, në zemrën tënde Rim, sot nuk pulsojnë më; e ti Rim i dashur do t'i marrësh me vete, duke na lënë ne, në varfëri e boshllëk shpirtëror e intelektual. Ike Rim Tomçini, por ideja dhe krijesa jote "Oda dibrane", kjo krijese që ti i kushtove jetën, shpirtin dhe talentin tënd, do të jetojë dhe do të të bëje ty të pavdekshëm! Ti nuk u mburre asnjëherë me këtë krijesë, të cilën lakmitarët e të pandershmit, pareshtur janë përpjekur e lodhur ta fshinin me mëngë e ta përllangnin me jargë krijesën në të cilën ti ke gdhendur me mendjen e talentin tënd, emrin "Oda dibrane". Edhe ideja jote për panteonin e artistëve dhe intelektualëve do të vijë një ditë të realizohet e pavdekësia jote të lartësohet.

Nuk do harrohesh kurrë i çmuari ynë, kuptimi i vërtetë i fjalës vëlla, baba, mik e shok!

Nderimi e lavdia e përjetësoftë emrin tënd!

Ndarja me ty, lamtumira për ty është një dhimbje e madhe jo vetëm për Dibrën, Shqipërinë e Kosovën, për aradhat e UÇK-së, por për gjithë shqiptarinë kudo në botë, Europë e Amerikë.

Lamtumirë, i shtrenjti ynë, Rim Tomçini!

ILIR META, *President i Republikës:*

I hidhur lajmi për ndarjen nga jeta të artistit të talentuar dhe kompozitorit të njohur dibran, Përparim Tomçini.

Me një krijimtari të suksesshme muzikore dhe mbi 400 kompozime me natyrë lirike, epike dhe folklorike, trashëgimia e çmuar që la pas në muzikë dhe art do të kujtohet gjithmonë me nderim, si një shembull frymëzimi dhe motivimi për brezat e rinj të artistëve shqiptarë.

DRITAN KORUMI, *mjek:*

- Sa keq ta filloj ditën me ikjen tënde, i dashur Përparim!

Po ikën një bashkëshort dhe baba shembullor, një artist që Dibra nuk do ta zëvendësojë dot. Një shok i gëzuar që kurrë nuk na dha mërzi, por me humorin e tij na e bënte më të lehtë ditën, punën- një shok që ta shton jetën.

Ka thënë dikush: "Artistët janë si Shehrezadeja- me çdo vepër që krijojnë, ia shtojnë ditët jetës së tyre"- dhe vërtet, ti je në krijimet e tua, të cilat shumica e dibranëve i këndojnë pa e ditur autorin.

Gjej rast të shpreh vlerësimet më të mira për zonjën tuaj, mësuese Perihanin dhe djemtë e tu, Anin dhe Iglin, që të shërbyen ashtu si e meriton. Gjej rast të uroj mikun e rrallë Arif Vladin, që jo vetëm t'u gjend pranë, por të plotësoi një peng që të mundonte shumë. Gjej rast të falënderoj mikun e rrallë Ilir Shaqirin dhe Presidentin e Kosovës z. Hashim Thaçi për nderimin më të lartë që të dhanë në emër të Republikës së Kosovës, që aq shumë e deshe.

Sa dhimbje! Zoti të paste në parajsë Miku im i Mirë!

DAIM HISENI:

Vëlla, shok, profesor, kompozitor, Mjeshtër i Madh, mbi të gjitha njeri me shpirt artisti, Përparim Tomçini.

Fatlum janë në këtë jetë ata njerëz që kishin rastin t'ju njohin dhe të paktën të pinë një kafe me ju, për të shkruar në biografinë e tyre se vërtetë kanë takuar njeri në këtë botë pa kohë.

Përpos që je njëri nga themeluesit, ti mbetesh shpirti i gjallë i "Odës Dibrane" dhe kulturës shqiptare.

Tani që u largove nga kjo botë, Dibra, Peshkopia dhe mbarë Shqipëria do të kuptojnë se i ka kapluar errësira, ngase që sot u mungon ndriçimi dhe buzëqeshja juaj.

E bëre tamam si artist!

Në kohën kur nga kjo jetë u larguan shumë nga ata që kishin shpirtin e artistit dhe në kohën kur Shqipërinë e ka kapluar bota e materializmit, ti ike t'ju bashkëngjitesh atyre që i deshe dhe të shkosh atje ku prehet qetë shpirti i një artisti.

Rëndë për familjen, por edhe për neve që të kishim mik.

Do të na mungosh deri në ditën kur do të bashkangjitemi.

Ikja jote e hershme më kujtoi Prometheun:

"Mund të më mundni, por s'mund të më thyeni!"

Qëndrove stoik në jetë dhe ike i pathyer në parimet dhe principet e tua.

I përhershëm kujtimi për Ty dhe për krijimtarinë artistike tënden që na e le pas e të kujtohet brez pas brezi!

ALMIRA ZEBI XHEMBULLA, *deputete e Dibrës:*

Ah sa vështirë të gjesh fjalën, kur në fakt do të thuash shumë ...

U rritëm me këngën tënde, hodhëm valle e gëzuam në dasma e festa, por edhe qeshëm nëpër odat tona sa e sa herë me historitë e batuat e tua origjinale.

Mirënjohje pa fund mjeshtër, për kontributin e madh në muzikë, për përçimin dhe promovimin e vlerave dibrane e mbarë shqiptare. Në çdo varg a notë ke ditur të shprehësh patriotizmin dhe dashurinë për traditën, të bukurën, folkloriken dhe qytetaren.

Kompozitori dhe muzikologu i shquar, autori i dhjetëra veprave muzikore e shumë këngëve e krijimeve në zhanre të ndryshme, që na ka bërë krenar në të gjitha trojet shqiptare!

Pushofsh në paqe artist i madh i Dibrës dhe i shqiptarisë!

XHEMAL GJUNKSHI, *deputet i Dibrës:*

Me keqardhje mësova lajmin për ndarjen nga jeta të një tjetër artisti, një nga themeluesit e grupit "Na bashkoi kënga popullore", kompozitorit të mirënjohur, Mjeshtrit të Madh, Përparim Tomçini.

Rimi me talentin e tij i dha vlerë këngës popullore dibrane, duke e bërë këngën e të gjithë shqiptarëve.

Me mjeshtërinë e tij ngriti në nivele të larta e të panjohura dhe i dha përmasat e shpirtit këngës patriotike, ku çoi peshë zemrat e shqiptarëve dhe kosovarëve.

Ngushëllime familjarëve, komunitetit të artistëve dhe gjithë Dibrës!

Lamtumirë "Mjeshtër i Madh" Përparim Tomçini, shok dhe mik i mirë!

Ti do të jesh i gjallë me këngët e tua sa të jetë Dibra!

SHKODRAN TOLAJ:

Për mikun dhe autorin e këngës "Gjaku i Kastriotit", Përparim Tomçini.

Lajmi i trishtë në mëngjesin e ditës së sotme për humbjen tënde mik, më bëri të pafuqishëm të gjej fjalët e duhura për ta ngushëlluar veten dhe të tjerët!

Jemi njohur që nga viti 2012, ndërkaq muzika jote më ka frymëzuar në vitet më të rënda të pushtimit të Kosovës dhe sfidave të gjeneratës sime. Ata që nuk të njihnin dhe kishin dëgjuar këngët "Nusja e maleve", "Ç'po i bjen era retë e zeza", "Prite, prite Azem Galicën" mbase mund të krijonin imazhin se je një njeri me fizik të fuqishëm si burrat e moçëm të maleve kreshnike, por unë dhe të tjerë që patëm fat të të njohim e dinim se ti kishe pasuri shpirtin e madh, me qetësinë, thellësinë dhe dallgët e një deti.

Ti nuk shkruaje muzikë nga nevoja e momentit, por projektet i mendoje dhe i sillje në momentin e duhur.

Ti gjithnjë shkruaje dhe përshtasje këngët për karakterin e interpretuesit, duke i menduar të gjitha specifikat vokale dhe të karakterit.

E them këtë me bindje, miku im, sepse pas shumë takimesh nga viti 2012, shumica e të cilave kalonte me biseda plot ide për projekte të reja, në vitin 2017 pata fat të kem një krijim tëndin në një jubile të madh, pikërisht në dekadën e shtetformimit të Kosovës. Me këngën "Gjaku i Kastriotit" kam ndjerë shpirtin e madh kombëtar dhe vulën krijuese shqiptare, ku Kosovën me aq dashuri e quaje Lulja më e re në Ballkan. Ishe shumë krenar dhe i lumtur që ky projekt si këngë e videoklip pëlqehej dhe vlerësohej si himni më i ri i shtetit të Kosovës.

Ti, një jetë të tërë ia fale artit kombëtar dhe në këmbim nuk kërkove asnjëherë asgjë!

Jam i lumtur që notat tua tashmë janë pjesë edhe e repertorit të Ansamblit të këngëve e valleve shqipe në RMV, ku si drejtues kam pas kënaqësi ta vendos në programin për prezantimin e parë të ansamblit në Kosovë në 13 vjetorin e shtetit. Ky interpretim i këngës "Gjaku i Kastriotit" nga të gjithë solistët e ansamblit dhe inskenimi koreografik nga prof. Dilaver Kryeziu mbetet një prej realizimeve më të veçanta e madhështore që bën krenar çdo shqiptar.

Falemnderit mik për frymëzimin që na dhe!

Falemnderit mik për muzikën që na fale!

Falemnderit mik që na bëre krenarë me lartësimin e atdheut e kombit!

Ngushëllime për familjen, miqtë dhe gjithë shqiptarët që u le veprat dhe krenarinë!

I lehtë të qoftë dheu i Dibrës sate, që aq shumë e deshe!

Nuk do të them asnjëherë lamtumirë, sepse bashkë me muzikën tënde do më shoqërosh gjatë gjithë jetës!

Përjetësisht përkulje e falenderim për ty!

Luljeta Çera, një njeri e grua shembullore, model për të gjitha gratë.

Profili njerëzor dhe profesional i **Luljeta Çerës**

Nga **SHAQIR ÇERPJA**

Tregohet se diku e dikur, një mbret thirri një mjek të njohur, që të shërbente pranë tij, të cilit i tha: "Mos harro se po shërben në oborrin mbretëror"! Ndërsa mjeku i njohur e human iu përgjigj: "Madhëri, përpara meje, të gjithë pacientët janë mbretër".

Gjithmonë kur kujton këtë shprehje, më vjen ndërmend Luljeta Çera, e cila ka dhënë prova se ajo është frymëzuar e motivuar nga ky parim i madh human.

Quhet Luljeta Çera, por thirret Leta. Thirret shkurt, sepse emri i saj përmendet shpesh dhe për Letën është folur e folet gjatë.

Luljeta Çera (Skeja), ose siç e thërrasin shkurt, Leta, ka lindur në vitin 1955, në fshatin Ploshtan të Kalasë së Dodës. Në vitin 1973 përfundoi shkollën e mesme për mami-infermiere në Peshkopi dhe deri në vitin 1978 punoi në vendlindje. Në vitin 1978 martohet me mjekun veteriner Halim Çera nga fshati Tartaj i Dardhës dhe prej atëherë, për shumë vite me radhë, derisa doli në pension, punoi, kreu dhe ushtroi detyrën mami-infermiere në fshatrat Lashkizë, Qan, etj., të Dardhës. Nuk është profesioni, posti dhe detyra, që i japin vlerë njeriut, por është njeriu që u jep vlerë profesionit, postit dhe detyrës. Leta Çera, me karakterin, cilësitë, vlerat dhe virtytet e saj të spikatura, me punën e saj të palodhur, me zell, pasion dhe vullnet, me këmbëngulje dhe përkushtim maksimal, për t'u shërbyer njerëzve, ia rriti vlerat, jo vetëm vetes, por edhe profesionit dhe detyrës që kryente dhe ushtronte.

Kudo dhe kurdoherë punoi pa përtesë për të qenë në krye të punës dhe detyrës, gjithmonë pranë njerëzve, për t'u shërbyer atyre. Për Letën kishte vetëm punë dhe puna për të nuk kishte orë e orar. Nuk kishte ditë feste dhe ditë pushimi. Në çdo minutë të ditës dhe në çdo orë të natës, ishte gjithmonë e gatshme, përherë e palodhur dhe e papërtuar. Për Letën koha nuk ndahej në ditë dhe natë. Nata ishte ditë dhe dita nuk kishte limit. Ajo punonte me shpirt dhe zemër; shkonte në çdo shtëpi, trokiste në çdo derë, hynte në çdo familje dhe kudo pritej me shumë dashuri, respekt dhe mirënjohje. Modeli i saj i punës dhe përkushtimit ishin nxitës, frymëzues dhe shpresëdhënës për të gjithë njerëzit. Ajo shpërndante dhe përhapte kudo mirësi, pozivitet, kurajo dhe shpresë. Pavarësisht kushteve ekonomike dhe social-kulturore, mjedisit, rregullit familjar, mënyrës së jetesës së njerëzve, ajo nuk përbuzte, nuk paragjykonte, nuk përgojonte, përkundrazi, me thjeshtësinë dhe modestinë që e karakterizonte, ajo i ndihmonte, i këshillonte, i udhëzonte për problemet e ndryshme familjare, të jetës së tyre të përditshme, si për higjienën, gatimin,



veshjen, por edhe për mënyrën e administrimit të ekonomisë dhe kohës. Me të gjithë njerëzit ajo kishte marrëdhënie të çiltërta, të sinqerta dhe shumë të afërta. Ajo ishte shumë e mirëpritur dhe e dëshiruar në çdo familje dhe për çdo njeri. Në çdo familje në fshatrat ku ka punuar, ajo ishte si pjesëtare familje. Përveç problemeve shëndetësore, me Letën qanin, diskutonin dhe konsultoheshin edhe për hallet e tjera familjare.

Leta dhe bashkëshorti i saj, Halim Çera, kishin krijuar dhe ndërtuar një familje të shëndoshë, të kulturuar dhe të emancipuar, me shumë mirëkuptim, harmoni dhe unitet. Për shkak të punës dhe detyrës, Leta udhëtonte ditën dhe natën, nga njëri fshat në tjetrin, nga familja në familje, herë e shoqëruar dhe herë e pashoqëruar, por asnjëherë nuk u paragjykua, sepse asnjëherë nuk la e nuk dha rast për t'u paragjykua, sepse ajo ishte grua e drejtë, e drejtpërdrejt, korrekte dhe serioze.

Ajo është dyfish e gjallë dhe dyfish nënë. Është dyfish e gjallë, sepse përveçse jeton e lumtur midis njerëzve të saj të dashur, ajo jeton edhe në mendimet e mira dhe kujtimeve të çmuara e të bukura të njerëzve dhe gëzon respektin dhe mirënjohjen e thellë të tyre. Është dyfish nënë, sepse përveçse ka familjen dhe fëmijët e saj, ajo është nënë e dytë, nënë e dashur për fëmijët e familjeve ku punoi, për kohën që punoi. Në festat, ditëlindjet dhe dasmat e këtyre fëmijëve, në mos gjithmonë fizikisht, ajo është e pranishme në mendimet e kujtimet e njerëzve, të dasmorëve e të pjesëmarrësve në këto feste, dasma e ditëlindje. Në përjetimet e nënave, në mendimet e grave, në buzëqeshjet e fëmijëve tashmë të rritur, është gdhend imazhi dhe portreti njerëzor e human i Luljeta Çerës.

Edhe më parë, por tani edhe më shumë e më shpesh se më parë e pyes veten se ku e gjente gjithë atë forcë, ku e merrte gjithë atë energji, ku buronte gjithë ai pasion, vullnet, përkushtim dhe këmbëngulje maksimale për të punuar aq shumë, për të qenë pranë njerëzve dhe për t'u shërbyer atyre, duke mos u lodhur e ankuar asnjëherë. Si shumë punë, si çdo punë, edhe puna që bënte dhe kryente Leta, kishte shumë vështirësi dhe pengesa. Edhe më të vështirë e bënte punën e saj, terreni shumë i thyer malor, shërbimi pa orar, ditën e natën, etj. Përveç lodhjes fizike, jo vetëm njëherë ka rrezikuar edhe jetën e saj. Njerëzit e dinë, e mbajnë mend dhe i kujtojnë sakrificat e saj, por unë po veçoj dhe evidentoj vetëm njërin nga rastet. Ishte dimër i vitit 1984. Bora kishte mbuluar vendin dhe rrugët ishin zënë. Poshtë akullit ishte krijuar një shtresë e padukshme akulli. Leta, e vetme, ndërsa po kalonte rrugës në Lerat e Shkaurranit, rrugë e vështirë, ku edhe më herët ishte aksidentuar me vdekje një nxënës shkolle, ajo rrëshqet, rrokulliset dhjetëra metra mbi akull dhe përplaset në trungun e një arre. Me shumë vështirësi mbahet për trungut të arrës, derisa vijnë njerëzit nga Lashkiza dhe e shpëtojnë. Familja organizoi darkë gëzimi për shpëtimin e saj nga vdekja. Pas tri ditësh, e vetëdijshme se mund të rrezikonte jetën përsëri, Leta kolon përsëri në atë rrugë me bore dhe akull, për të shkuar dhe për të qenë pranë njerëzve, për t'u shërbyer atyre.

Nëse heronjtë dhe heroina çmohen dhe vlerësohen njerëzit, të cilët, me ndërgjegje e vetëdije rrezikojnë edhe jetën e tyre për t'i shërbyer punës, për të përmbushur detyrën dhe misionin e ngarkuar, atëherë, edhe Luljeta Çera është grua, nënë heroinë, e cila meriton vlerësim, mirënjohje dhe respekt.

Përveçse njeri i sjellshëm, grua e kulturuar dhe nënë e dashur, Leta ishte edhe njeri dhe grua e fortë, e zonja për të kapërcyer vështirësitë dhe pengesat, për t'u përballur me sfidat e jetës, në punë dhe në familje. Ajo ka dhënë provat e një gruaje të fortë, e cila luftoi dhe nuk u dorëzua edhe në situatë të vështirë familjare dhe luftoi e vetme për të mbajtur punën e shërbyer detyrës dhe duke u kujdesur me përkushtim për fëmijët, burrin dhe njerëzit e tjerë të familjes.

Përveçse një mami-infermiere shembullore, ajo ishte edhe një aktiviste shoqërore, e angazhuar në strukturat e ndryshme shoqërore e shtetërore. Ajo, për shumë vite me radhë ka qenë anëtare e pushtetit lokal (ish këshillit të bashkuar dhe komunës) të Dardhës. Gjithashtu ka qenë kryetare e organizatës së gruas të fshatit dhe nënkryetare e kësaj organizate për zonën e Dardhës.

Ajo ishte zërit i njerëzve për të gjitha hallet dhe problemet e tyre. Ishte një aktiviste, agjitatore, mësuese dhe edukatore për emancipimin e shoqërisë, jo vetëm të grave, por edhe të burrave.

Profili njerëzor dhe profesional i Leta Çerës nuk mund të plotësohet me një shkrim. Ai plotësohet me mendimet, kujtimet, konsideratat dhe vlerësimet që njerëzit kanë dhe e ruajnë për të. Dhe këtë mirënjohje dhe respekt e thonë dhe e shprehin në mënyra të ndryshme.

Gjithmonë, në punë dhe në jetë, kudo ku jetoi, punoi, veproi e shërbeu, Luljeta Çera ishte një njeri e grua shembullore, model për gratë.

Mirënjohja dhe respekti i njerëzve është i rëndësishëm, bile më i rëndësishëm, më i çmuar dhe më i vlefshëm se dekoratat dhe vlerësimet e tjera institucionale, sepse mirënjohja dhe respekti burojnë nga shpirti dhe zemrat e njerëzve, janë të gjalla dhe nuk thahen si bari, nuk shkrihen si bora, nuk vjetrohen si rrobat, nuk mplaken dhe nuk vdesin si njeriu. Të gjithë njerëzit i dëshirojnë, i duan dhe i lakmojnë mirënjohjen dhe respektin, por jo të gjithë i kanë, sepse ata i marrin, i kanë dhe i gëzojnë vetëm ata që i meritojnë, siç i ka, siç i ka merituar dhe fituar Luljeta Çera.

Mirënjohja dhe respekti i njerëzve është i rëndësishëm, bile më i rëndësishëm, më i çmuar dhe më i vlefshëm se dekoratat dhe vlerësimet e tjera institucionale, sepse mirënjohja dhe respekti burojnë nga shpirti dhe zemrat e njerëzve, janë të gjalla dhe nuk thahen si bari, nuk shkrihen si bora, nuk vjetrohen si rrobat, nuk mplaken dhe nuk vdesin si njeriu. Të gjithë njerëzit i dëshirojnë.. por jo të gjithë i kanë, sepse ata i marrin, i kanë dhe i gëzojnë vetëm ata që i meritojnë, siç i ka, siç i ka merituar dhe fituar Luljeta Çera.

Nuk është profesioni, posti dhe detyra, që i japin vlerë njeriut, por është njeriu që u jep vlerë profesionit, postit dhe detyrës. Leta Çera, me karakterin, cilësitë, vlerat dhe virtytet e saj të spikatura, me punën e saj të palodhur, me zell, pasion dhe vullnet, me këmbëngulje dhe përkushtim maksimal, për t'u shërbyer njerëzve, ia rriti vlerat, jo vetëm vetes, por edhe profesionit dhe detyrës që kryente dhe ushtronte.



Bashkëshortët, Luljeta dhe Halim Çera

Gazeta "Rruga e Arbërit"

Aty ku fjalët nuk i merr era...

Bëj një abonim online ose në print...

Kushton vetëm 600 lekë në vit...


email: rrugaearberit@gmail.com

përjetime

Zalldardha humbi birin e saj më të mirë.

"Më preve në besë, o Qerim Sula"

Nga **SHAQIR SKARRA**



Më preve në besë, o Qerim Sula, më preve në besë si burra... Kisha vendosur disa herë se do të shkruaja për jetën dhe veprën tënde artistike ndër vite. Kishim biseduar bashkë disa herë, kishim biseduar edhe kur vije në lokal "Bar Kinostudio", i shoqëruar së bashku me Razien, pas një ndërhyrje kirurgjikale të vështirë që kalove në zemër. Ishte jo vetëm një kënaqësi të shkruaja për ju, por edhe një përgjegjësi e madhe, por gjithmonë modestia jua më kishte stepur, ma kishte prerë hovin. E ja, tani vonë, tepër vonë, më takoi të shkruaj, por Juve nuk ju kam pranë. Ti ike shpejt nga kjo jetë krejt e rrejshme.

Lajmin e trishtë për vdekjen tënde e mora vesh herët. Falë rrjeteve sociale tashmë lajmi vjen në çdo orë e minutë tek ne. Në fillim nuk e besova, nuk mund ta besoja Qerim, se duke gdhirë 31 maji e në vazhdim nuk do të të kishim më midis nesh.

Telefonata e mikut tënd të mirë dhe gjithë dibranëve, Latif Miha, më bëri të ngrihem, të vishem e të dal në rrugë të prisja kortezhin tënd Qerim. Do të vija në Zalldardhë, do të të përcillja për herë të fundit, do të hidhja një dorë dhé nga dheu i ngrohtë i vendlindjes, që ti e deshe kaq shumë, saqë e le amanet që banesën e fundit ta kishe pikërisht në Zalldardhë. Dhe amanetin tënd, ne miqtë e shokët e tu, e çuam në vend.

Kortezhi u nis në mëngjes nga shtëpia jote në Kinostudio. Ishte Latif Miha ai që e bëri të gjithë organizmin e ceremonisë mortore. Ai nuk kishte fjetur gjumë fare. Që në orën 1 të natës t'u gjend pranë edhe në minutat e fundit të jetës tënde. Razia ndodhej e sëmurë, shumë sëmurë, nuk mund të vinte me ne. E tillë ishte situata, e tillë ishte gjendja shëndetësore e saj, por bashkëshortja jote, bashkudhëtarja ma e mirë u ngrit nga shtrati, zbriti poshtë dhe me lot në sy u përkul mbi arkivolin tënd Qerim. "Ta kam bërë hallall shërbimin Qerim Sula, hallall njëqind herë!". Djali Aleksandri dhe vajza Greta nuk mundën të vinin, të ishin pranë teje, të përcillnin për herë të fundit në vendlindje. Ata ndodheshin larg, shumë larg, në tokën e premtuar Amerikë dhe të gjitha rrugët ajrore ishin të bllokuara. E, megjithatë, ne miq e shokë që të deshëm vazhdimisht e çuam amanetin tënd në vend.

Makinat që shoqëronin kortezhin ishin shumë, rreshti i tyre ishte i gjatë e heshtja e madhe po i vriste të gjithë. Heshtje në të gjitha makinat, lot tek të gjithë miqtë e shokët e tu. Askush nuk po i mbante lotët. Shikoja lotët në sytë e Latifit, i cili mundohej t'i mbulonte sa mundte, por ishte diçka që nuk mundej. Eh! Sot e kuptova sa shumë të paskan dashur miq e shokë!

Nga Tirana dolëm herët, udhëtuam ngadalë, se në fakt kështu udhëtojnë makinat që shoqërojnë funeralin. Nuk ndaluam askund. Rrugës u bashkua me ne Defrim Methasani, i cili nuk mund të ndahej kaq lehte prej teje Qerim. Deshi të vinte atje, në Zalldardhë dhe më shumë lot sesa fjalë këtë radhë do të derdhte për ju. Në makinë ishte edhe Muharrem Gjoka e Lazam Gjoka.

Në Milot kishte zbritur nga Lezha Hasan Rasha, daja juaj Qerim, së bashku me Shaban Mziun, por jo vetëm. Ishin tre makina e secila mbushur plot me njerëz. Shumë u nisëm nga Tirana, por më shumë u bëmë gjatë rrugës. Në hyrje të Peshkopisë na priste Rasim Shira. Edhe ai vetë i sëmurë, por ishte ngritur nga shtrati dhe erdhi me ne.

Në qytetin e bukur të Peshkopisë arritëm shpejt. Duhej të ishin hapur dyert e Pallatit të Kulturës, por ne nuk kaluam andej dhe mirë bëmë, se po të kishim kaluar, do të vonoheshim shumë.

Do të dilnin të gjithë miq e shokë , kolegë e artdashës që të duartrokitën vite me radhë gjithë dashuri e zjarr. Zëri yt jehoi ndër vite në atë pallat kulture. Megjithatë, qyteti kishte dalë, na prisnin rrugës, na përcillnin në heshtje dhe me lot në sy na përcollën derisa kaluam qytetin e Peshkopisë.

Në Kuben na prisnin kolegët e tu, ata që punove gjatë. Kishin dalë për t'u bashkuar me ne Veliu, Faiku, Agimi. Sapo kaluam urën e re në Arras dhe u futëm në Rrugën e Dritës, Rrugën e Rinisë, në atë rrugë që kishe kaluar me mijëra e mijëra herë me makinën tënde Qerim, kujtimet e asaj kohe u zgjuan. Ndaloje me makinë çdo njëqind metra e merrje njerëz në makinën tënde. Rruga ishte e keqe, makina kishte pak, lëvizjet e njerëzve ishin të shumta që zbrisnin në qytet, e nuk kishte nevojë të ngrinin lart dorën. Ti ndaloje vetë dhe i merrje të gjithë. Edhe sot e njëjta rrugë si atëherë kur udhëtoje vetë me makinë, e pashtruar e gropa-gropa, megjithëse ky është udhëtimi yt i fundit që po bën në këtë rrugë Qerim!

Era i kishte sjellë retë e zeza, i kishte ulur aq shumë poshtë, sa edhe Drini me vështirësi dukej, megjithatë shiu ende ishte larg. Kështu ishte koha që kur u nisëm nga Tirana e ja deri këtu në vendlindjen tuaj Qerim. Dielli sot e kishte humbur ndriçimin e tij.

E doje vendlindjen. E doje Zalldardhën që të lindi e të rriti, Zalldardhën që të bëri vërtet krenar, duke u ngjitur edhe në skenat më prestigjioze të botës. Ajo të dha emër e famë, të bëri artist, por edhe ti e nderove gjithmonë.

Dhe sot më 31 maj 2020 , në qendër të Zalldardhës kishte njerëz, kishte njerëz si dikur kur gumëzhinte si zgjoj bletësh nga kuadro, mësues e nxënës. Ishin mbledhur edhe sot shumë, ishin mbledhur me u takuar për herë të fundit me ju Qerim. Kishin ardhur nga Sorica, Lashkiza, Lugjaj. Kishin ardhur vërtet shumë. Kishin ardhur të gjithë, se të gjithë të deshën, të gjithë i deshe. Kaq shumë njerëz nuk ishin mbledhur ndonjëherë në Zalldardhë pas viteve nëntëdhjetë. Ishin mbledhur të gjithë për ty, për të dhënë lamtumirën e fundit.

E lamë Zalldardhën dhe u ngjitëm në një kodër dominuese nga ku dukej e gjithë Lugina e Drinit të Zi si në pëllëmbë të dorës. Ndaluam tek kjo shtëpi e vjetër ku linde 69 vjet ma parë. Oborri ishte plot me njerëz. Kështu mbushej sa herë vije ti e uleshe shtruar. Mblidheshin të gjithë nga ana e anës. Zalldardha e merrte vesh. "Ka ardhë Qerim Sula!" - dhe ai oborr mbushej me njerëz të moshave të ndryshme. Të kishte hije Qerim muhabeti, por më shumë të kishte hije kënga, kënga jote që gjëmonte më shumë se dallgët e Drinit kur vinte rrëmbyeshëm e gjithë potere. Kishin ardhur dhe sot në oborrin e shtëpisë tënde. Kishin ardhur burra e gra nga të gjitha anët. Qielli ishte nxi nga retë, saqë ishin ulur kaq poshtë, ku edhe Drini nuk dukej mirë. Ishte gati në të plasur rrebesh shiu, por jo. Edhe pse era i kishte sjellë retë e zeza, shiu ende ishte larg. Koha ishte në favorin tonë.

Burrat qanin nën zë e në heshtje, gratë e Dardhës, Çidhnës e Reçit vajtonin. Një heshtje e madhe, një heshtje varri kishte pllakosur në atë kodër të lartë, ku vetëm zëri i Defrimit dëgjohej, edhe ai ndryshe nga herët e tjera ma shumë lot sesa fjalë. Eh, Qerim! Dhimbja për ju paska qenë e madhe, humbja edhe më e madhe, malli do të na rëndojë gjatë mbi supe. Të gjithë lindim, rritemi dhe vdesim. Me punën tonë, me sjelljet tona gjatë gjithë etapave të jetës mundohemi të bëjmë mirë, të kemi vetëm miq, por është e pamundur, se jeta është e gjatë dhe mund të kemi edhe njerëz që nuk na duan. Ti ishe ndryshe Qerim Sula, ishe ndryshe se ja tek po e shikojmë edhe sot. Gjatë gjithë jetës tuaj paske bërë vetëm miq e miq të mirë.

Vetëm fizikisht ke vdekur, shpirtërisht do të jetosh gjithmonë në zemrat tona, se nuk do të vdesë kurrë kënga jote. Ajo këngë që u bë hit, që mbeti himni i Dibrës, që këndohet nga këngëtar të ndryshëm në të gjitha trevat shqipfolëse, por që nuk mund të këndohet kurrë si ju Qerim!

Ajo këngë kishte lindur për ju dhe ju kishit lindur për atë këngë. Edhe tek ceremonia e varrimit, Defrimi e vuri atë këngë, si një amanet prej jush Qerim. Kënga jehoi, jehoi gjatë këndej dhe matanë Drinit.

Askush nga të pranishmit në ato çaste nuk i mbajti dot lotët, por njerëzit e pranishëm hapnin më shumë veshët e dëgjonin në heshtje. Dikush foli: "Jo, or jo. Nuk paska vdekur Qerim Sula!"

Folën të gjithë, folën me lot në sy. Foli administratori i Zalldardhës Abaz Kaca, foli Veli Vraniçi, Agim Skarra, Faik Vojka, Rasim Shira, Lazam Gjoka, Muharrem Gjoka. Eh! Atë ditë foli, heshti dhe qau e gjithë Zalldardha. E pashë me sy, Qerim, se sa shumë miq e shokë paske pasur, sa shumë të paskan dashur të gjithë. Thonë se burri nuk qan, por unë pashë se të gjithë burrat e pranishëm në atë ceremoni mortore ishin të përlotur .

Heshtja dhe zija e kishte pllakosur Zalldardhën tënde Qerim! Ishe lindur dhe rritur në këto vise të bukura, ku natyra vërtet ia ka falur të gjitha. Kënga u bë bashkudhëtare me ty që kur ishe i vogël. Në fillim këndoje tinëz kur dilje nga shkolla, rrugës kur shkoje në shkollë. Më vonë, pasi përfundove shkollën mekanike dhe more edhe patentën për shofer, këndoje në makinën tënde gjatë udhëtimeve të gjata. Shkove vetë pastaj pa të ftuar tek grupet amatore në shtëpinë e kulturës Zalldardhë. Aty panë se zëri yt kishte karakteristika të veçanta.

Ishte viti 1967 kur u angazhove me ansamblin "Dibra" dhe një vit më vonë, në vitin 1968 do të merrje pjesë në festivalin e parë folklorik kombëtar në Gjirokastër me këngën e "Lam Dacit", këngë e cila u vlerësua me çmim të parë në atë festival.Pastaj festivali folklorik kombëtar i Gjirokastrës u bë si shtëpia juaj Qerim. Deri në vitin 2000. More pjesë në mjaft trupa e ansamble si dhe ke qenë pjesëtar i Estradës profesioniste të Peshkopisë.

Në vitin 1981, kur shkele për herë të parë në Kosovë me ansamblin "Kukësi i Ri", kur u ktheve na tregove të gjitha emocionet që përjetove mes vëllezërve tanë të një gjaku, por edhe kosovarët ende këngët e tu i bënë hit dhe ato këngë sot po këndohen nga këngëtarë profesionist dhe amatorë, në koncerte e gëzime familjare.

Repertori juaj është i pasur, mjaft i pasur me këngë epike, se ti kishe lindur për këngën epike. I realizove dy albume me këngët më të bukura dibrane, të mbeti peng i treti, pasi vdekja nuk të priti edhe pak se të mori shpejt. Dhe këngët e tua janë vlerësuar jo vetëm nga artdashësit, por janë vlerësuar edhe me diploma e tituj nderi në aktivitete të ndryshme.

Punove gjatë gjithë karrierës tuaj artistike me këngëtarë të njohur profesionistë si Arif Vladi, Haziz Ndreu, Liri Rasha, Vera Laçi, Sherif Dervishi, Saje Poleshi. Breza të tërë artdashësish të muzikës popullore shqiptare u rritën me këngët epike të tua, se ti ishe dhe mbete ikona e këngës dibrane aq të njohur dhe të dashur në çdo trevë ku flitet, shkruhet dhe këndohet shqip.

Duke marrë stafetën e një historie të shkëlqyer nga legjenda e Zalldardhës Haziz Ndreu, që ti nuk e mohove kurrë, por e vlerësoje vazhdimisht, me interpretimin e këngës epike mbushe me krenari çdo shqiptar. Këngët e tua ishin këngë të qëndresës, këngë të mbijetesës, prandaj edhe kumbonin fort kudo, si himne që mbartnin në vetvete krenarinë dhe vetëdijen. I këndove bukur ti trimërisë së dibranit përballë okupatorëve të shumtë, por ti i ngrite himnin nëpërmjet këngës epike mbijetesës së kombit tonë.

Ti dhe modelin më të bukur se gjithmonë artisti nuk plaket kurrë, nuk del jashtë kohe kur mbetet besnik i këngës së vërtetë të popullit. Udhëtimi yt drejt këngës është një udhëtim drejt një magjie, se sa më shumë shtyhesh në morinë e tingujve dhe trajtave të saj, aq më shumë ndihesh i pushtuar nga magjia e artit elitar.

Me emrin tënd Qerim është e lidhur ngushtë kënga epike, e cila nga brezi në brez do të udhëtojë në kujtesën e njerëzve që e duan, shijojnë dhe impresionohen nga magjia e shpirtit tënd të bukur artistik. Dhe ti kishe lindur për këngën epike. Kënga "Këndojnë pushkët nëpër kulla" sot është bërë hit, këndohet në jug dhe veri, në Maqedoni dhe Kosovë, këndohet kudo ku flitet e shkruhet shqip, nga këngëtarë profesionistë dhe amatorë, por askush nuk mund ta këndojë si ju Qerim! Ajo këngë kishte lindur për ju. Ashtu sikurse edhe kënga e Hajredin Pashës që sot këndohet nga të gjithë, kur e dëgjojmë të kënduar nga Haziz Ndreu tingëllon ndryshe, tingëllon më bukur, shumë më bukur se ishte këngë për artistin e madh të Dibrës Haziz Ndreu.

Edhe kënga "Këndojnë pushkët nëpër kulla" kishte lindur për ty e ka mbetur gjithmonë pronë e juaja Qerim! Që në zanafillë ju ishit një treshe që kishit lindur për njëri-tjetrin, kishit vendosur për të bërë vërtet një himn për heroizmin e dibranëve.

Dhe ia dolët së bashku; ti, Naimi dhe Përparimi. Të tre nuk jetoni sot, por ama këngën, këtë pasuri të madhe shpirtërore na e latë. Dhe ajo këngë për të ardhur deri në skenat e festivaleve ishte e vështirë, pati një rrugëtim të gjatë. Sa net pa gjumë keni qëndruar të tre bashkë, sa orë pune, sa mund e lodhje. Për një fjalë qëndruat një natë të tre tek Ura në Pilafe derisa u gjet, thua se u gjet "Eureka", por ama edhe ju ishit të kënaqur për këtë gjetje, se kënga mori udhë.

Zëri yt jehoi edhe në skenat më prestigjioze të botës si në Gjermani, Austri, Turqi, Belgjikë dhe kudo që ishe, artdashësit shqiptarë, diaspora të ndoqi nga pas, të fali duartrokitje të zjarrta, se këngët epike të tua ishin himne të krenarisë kombëtare. Ti ishe dhe mbete, Qerim, këngëtari me zërin uragan, që dukej sikur zbriste nga lartësitë e ujëvarave dhe alpeve shqiptare.

Ishe dhe mbete ikona e këngës epike dibrane, me një repertor mjaft të pasur.

Me zërin tënd Qerim ke mbartur dhe përcjellë të gjitha motivet e Dibrës, qëndresën, trimërinë, heroizmin, këngë që i ke kënduar qëkur ishe fëmijë dhe që përbëjnë një fond të artë të kulturës shpirtërore të popullit dibran në fushën e këngës dhe folkut.

I dhurove publikut dibran dhe atij shqiptar, vetë historisë së muzikës shqiptare. Me zërin tënd të artë, përkushtimin dhe dashurinë e pakufishme ndaj artit, dashurinë për vendin e tënd të dashur, të cilin e mbarte kudo që vajte, në të gjitha skenat dibrane, shqiptare e të botës, si një peng malli e përkushtimi, për t'i shërbyer deri në fund, me magjinë e një arti të madh e të papërsëritshëm.

Zëri yt tashmë është shuar dhe nuk do të dëgjohet më live në skenat shqiptare, pasi ti ike në një rrugë pa kthim, por kënga jote jeton e do të jetojë përgjithmonë në memorien e brezave, në kujtesën kombëtare të artit të madh elitar, i cili do të ruajë në analet e tij të përjetshëm imazhin e një këngëtari brilant, imazhin e papërsëritshëm të këngëtarit Qerim Sula, me emrin e së cilës lidhet muzika dibrane, kënga dibrane, ikona e së cilës ishe dhe mbete sa kohë që të ekzistojë kënga dhe arti i vërtetë...

Ike shpejt Qerim, ike shpejt nga kjo botë e rrejshme. Ike pa i mbushur shtatëdhjetë vite, pa e festuar shtatëdhjetë vjetorin, por siç tha edhe Defrimi, do ta festojmë shtatëdhjetë vjetorin, se ti vetëm fizikisht na mungon, shpirtërisht do të kemi pranë gjithmonë. Erdhëm me ju Qerim në Zalldardhë dhe u larguam pa ju. U lamë këtu përgjithmonë në këtë vend të bukur e me njerëz fisnikë. Ashtu siç na pritën, ashtu edhe na përcollën, kokën ulur, lotët në sy e dhimbje të madhe në shpirt e zemër. Zalldardha kishte humbur birin e saj më të mirë.

Na përlote e na copëtove shpirtrat e zemrat familjes, të afërmve të tu, neve që të njohëm, që bashkëpunuam e mësuam, kush të njohu, gojëmjalti e inxhinieri që i dhe kaq shumë Dibrës, saqë ajo do të të jetë mirënjohëse gjithmonë.

Përse nuk më shkruajte **inxhinier Luani?**

Kur pena nuk i hapën udhë vetes e truri nuk pjell fjalët e duhura si veprohet? Balli më është rënduar si të ishte parzmore plumbi. Kërkoj të kap fillin e Arjanës për të shkruar një shkrim mbi... Eh sa e vështirë qenka, të ma besoni! Sa e dhimbshme të lidhësh disa fjalë, për të formuar fjalinë apo një ligjëratë të tjerrun për një të njohur! Po nxirre, të shkretën, shkruaje, se na plase, - turfullon lexuesi. Nuk mundem, se është lajm i kobshëm. Nuk e dëshiroja. Ma la peng në zemër e në shpirt, kur më shkruajti. Dua të flas me juve, më dërgo numrin e telefonit. Me sa duket, duhej të përsëritej letërkëmbimi e propozimet e vitit 2012. Por...

Unë ju përgjigja: "Flasim të dielën pasdite, se jam në shtëpi ose pas orës 19.00 çdo ditë. Po të mundesh më shkruaj shkurt problemin. Të përshëndes. Kumt. 27 mars 2020."

Një lajm i zi si tajfun i fuqishëm u përplas dhunshëm mbi shpirtin tim. E lexova, rilexova, kërkova lajme të tjera që ta mohonin. Por, jo, një kumt me një fjongo të zezë shkruante: "Vdekje e papritur, e parakohshme, ndahet nga jeta inxhinieri i pyjeve Luan G. Leka, 04.05.2020.,,


Ula kokën duke i vënë ballit dorën në formë grushti. Ai filloi të nxehej, pikla djersësh më lagën shpinën e dorës. Qelizat e trurit filluan të zbulonin nën rrudhat e tyre Luanin, djalin trupshkurtër e atlet, fytyrën e bardhë e të rrumbullakët, me sytë e ndritshëm, zërin e butë, me hundën e vockël, që fytyrës i jepte një pamje tepër simpatike. Vishej thjesht, por e mbante veten, duke shprehur një kulturë jetese të dallueshme nga teknikumasit dibranë. Natyrshëm m'u zgjuan të rinjtë që vinin nga nëntë malet e Dibrës, në vitin 1972-1974 në Shkollën e Mesme Pyjore Shkodër; Laim Baloshi, Halim Lala, Sabri Pira, Medi Shtrezi, Ismail Hysa, Gëzim Hoti etj. Luani ishte më trupshkurtri e që shoqërohej për bukuri me të gjithë. Vite që rrodhën qetësisht, lumturisht me të gjitha grimcimet e jetës konviktore e shkollore, të cilat hera-herës rishfaqen si zanat në pyjet e virgjër.

Inxhinier Luani lindi me 25.05.1955 nga një familje nga Gorica e Dibrës. Diplomohet Teknik i mesëm pyjesh në vitin 1974, me rezultate shumë të mira, të cilat i hapën udhën e vazhdimit të studimeve në Fakultetin e Pyjeve Kamëz, Tiranë. Pasi përfundoi studimet në vitin 1978, emërohet inxhinier pyjesh në Ndërmarrjen e Pyjeve Peshkopi, duke punuar në degën teknike si inxhinier sektori pyjor, më pas emërohet shef sektori në vitin 1984.

Puna e tij e kujdesshme, aftësitë inxhinierike, përvoja organizative, sjellja e tij, shpirtbutësia, pasioni për profesionin e pylltarit i sjellin atij frytet e një emërimi të ri. Kështu, që nga viti 1985 – 1992, inxhinieri Luan Leka punon kryetar i degës teknike pranë Ndërmarrjes së Kullotave Peshkopi.

Për të nxjerrë në pah punën e tij në studime e projektime, në ndërtimin e lerave të ujit në rrethin e Dibrës do të shkruaj: "Në kullotat verore të ekonomisë Mbas Deje - Bulaç, gjatë viteve 1980-1985 e deri në vitin 1993 janë ndërtuar mbi 25 lera uji me plasmas, me kapacitet 240-250 m³ ujë.

Projektues dhe preventivues i tyre kam qenë unë, jo vetëm aty, por në të gjithë ekonomitë kullosore të rrethit të Dibrës.,, (L. G. Leka, letër 17.10.2012) Tregues i cili e vendos inxhinierin e pyjeve Luan Leka në piedestalin e aftësive të tija jo vetëm projektuese, por edhe në punën e tije si maratonomak i këtyre trevave për të kryer matjet e ndjekur punimet në malësitë e Dibrës, mbi 1700 metra lartësi. Sa djersë, sa sakrifica, sa lodhje e bashkëpunim me zooteknikë, punëtorë, muratorë, kooperativistë etj. Frytet



Puna e tij e kujdesshme, aftësitë inxhinierike, përvoja organizative, sjellja e tij, shpirtbutësia, pasioni për profesionin e pylltarit i sjellin atij frytet e një emërimi të ri. Kështu, që nga viti 1985 – 1992, inxhinieri Luan Leka punon kryetar i degës teknike pranë Ndërmarrjes së Kullotave Peshkopi.

e djersës së tij të lodhjes fizike, mendore dhe zbatimi i shkencës së projeketimit janë shpërndarë në pllajat e bjeshkëve të Dibrës, ku jo vetëm funksionojnë, por janë sytë e kaltër të peizazheve të këtyre vendeve të mrekullueshme.

Inxhinieri Luan Leka është autor i shumë studimeve, ku në pamundësi t'i shkruajmë të gjitha, po japim disa prej tyre

Studimi i filizërisë në pyjet halore (1979). Studimi i kullotave të ekonomisë kullosore Korab (1980). Studimi i potencialit të bimëve mjekësore në shkallë rrethi (1987). Studimi i kullotave në rrethin e Korçës (1988). Ka kryer punimet në terren dhe ka hartuar projektin e inventarizimit të kullotave për rrethin e Dibrës (1981).

Ndërrimi i sistemit ekonomik nuk e trembi inxhinier Luan Lekën, nuk e demoralizoi dhe nuk e futi atë në brazdat partiake, përkundrazi, ai krijoi në vitin 1996 kompaninë "Korabi" shpk, duke e udhëhequr si drejtor, me aktivitet kryesor "Projektime dhe zbatime në fushën e pyjeve dhe mjedisit". Ndërsa pararendi duke kryer kualifikim një vjeçar me shkëputje nga puna në Fakultetin Ekonomik (1988), i cili i shërbeu për të çarë si zgalem në projektet e studimet mbarëkombëtare e ndërkombëtare si me Kosovën, Maqedoninë, Holandën, Bashkimin Evropian etj.

Edhe këto sipërmarrje të fuqishme të cilat kërkonin përgatitje të lartë profesionale, aftësi të veçanta inxhinierike e ekonomike, për shembull, njohjen e shkëlqyer të anglishtes dhe bashkëpunim e bashkërendim me koleg të ndryshëm. Do t'i konkretizojmë sipërmarrjet e mësipërme për të krijuar bindjen e thellë, se si ka vepruar e realizuar këto: "Nuk e di a mund të kombinojmë bashkë (me S.Meziu) për të aplikuar tek projektet e BE-së (IPA) ose projektet ndërkufitare me Maqedoninë, Kosovën, Malin e Zi, Greqinë dhe Italinë.

Në fakt, unë (inxh. Luan Leka) kam hartuar dhe aplikuar dy projekte në BE... Njëri me temë: "Promovimi i vlerave turistike të llixhave të Peshkopisë dhe Elbasanit,, nga shoqata ime "Ecodibra" dhe për palën maqedonase, Llixhat e Kosovrastit, përfaqësuar nga shoqata "CeProSard", të cilat ishin lider i projektit." (Luan G. Leka, Letër 18.10.2012)

Inxhinier Luan Leka është hartues i një projekti mbi: "Përmirësime pyje në pishë (Prerje pastruese) dhe ndërtim infrastrukturor në Parkun Kombëtar Lurë". Meqenëse i njihte mirë këto terrene me pyjet që shtriheshin në relieve të thyera në vitin 1995, inxhinieri kthehet përsëri në malësitë e Lurës në vitin 2002 për të kryer mbarështimin e pyjeve të ekonomisë pyjore Krej – Lurë - Arrmoll.

Inxhinieri Luan Leka me shkathtësinë e tij, me dëshirën për të vazhduar punimet e terrenit dhe projektuese i kryen ato edhe në rrethe të ndryshme të Shqipërisë, pa pyetur për sakrificat, vështirësitë, largësinë nga familja etj. Hartimi i Planit të mbarështimit të pyjeve dhe kullotave të komunave Maminas, rrethi Durrës, Thumanë, rrethi Krujë dhe Shënkoll, rrethi Lezhë në vitet 2010-2011 dhe atë të kullotave të komunave Xare, Dhiver e Aliko, rrethi Sarandë.

Hartimi i planeve të mbarështimit në disa komuna të rrethit të Dibrës si Melan, Maqellarë, Sllovë, Kala e Dodës, Arras, etj. Inxhinier Luani nuk përzgjidhte llojet e projekteve. Ai harton nga ato në sistemime malore, të përrenjve të Gramës, Gjelagjoshit, Peshkopisë, të fshatit Zimur etj. Dhe më tej për gjatë punës së tij inxhinier Leka ka hartuar e zbatuar edhe disa projekte pyllëzimesh, si me fidanë gështenje në komunën Tomin, akacie në fshatrat Deshat, Borovjan, Sohodoll, Vrejn në sasi prej 30 hektarë ose 75,000 rrënjë, plep kanadez në sipërfaqe 20 hektarë në fshatin Kishavec komuna Kastriot, rrethi Dibër.

Inxhinieri Luan Leka me shkathtësinë e tij, me dëshirën për të vazhduar punimet e terrenit dhe projektuese i kryen ato edhe në rrethe të ndryshme të Shqipërisë, pa pyetur për sakrificat, vështirësitë, largësinë nga familja etj. Hartimi i Planit të mbarështimit të pyjeve dhe kullotave të komunave Maminas, rrethi Durrës, Thumanë, rrethi Krujë dhe Shënkoll, rrethi Lezhë në vitet 2010-2011 dhe atë të kullotave të komunave Xare, Dhiver e Aliko, rrethi Sarandë.

Puna e tij intensive, përvoja e gjatë në hartimin e projekteve, ndjekja e udhëzuesve dhe të rejave edhe nëpërmjet trajnimeve në fushën e pylltarisë, të shkencave të mjedisit, konkurrimi i ndershëm e kthyen inxhinier Luan Lekën në një specialist të kërkueshëm në kryerjen e këtyre projekteve në fushën kombëtare dhe ndërkombëtare.

Telefonatën nuk e realizuam, as kumtin nuk ma shkruajte e dërgove, problemin që kishe nuk ta mësove, atë dibrani im e koleg i dashur i more me vete, duke ma lënë peng mua, se çfarë të mundonte, çfarë zgjidhje kërkoje, çfarë dëshiroje të diskutonim. Megjithatë, unë dhe kush të ka njohur e ka punuar me juve, jemi krenar e mburremi, sepse keni lënë pas si fener të pashuar krijimet e tua të shumta në lëmin e projektimeve, të studimeve shkencore, përvojën tuaj të shkruar në referimet e punimet e ndryshme.

Unë kam shkruar vetëm majën e Korabit të tyre. Na befasove, na përlote e na copëtove shpirtrat e zemrat familjes, të afërmve të tu, neve që të njohëm, që bashkëpunuam e mësuam, kush të njohu, gojëmjalti e inxhinieri që i dhe kaq shumë Dibrës, saqë ajo do të të jetë mirënjohëse gjithmonë.

Kolegu dr.**Selman Meziu**

05. 06. 2020

Sejfulla Sefa, 44 vjet në shërbim të arsimit



Nga **BESNIK LAMI**

Njerëzit e ditur e të moshuar po i kin një e nga një nga kjo botë, ashtu si lisat e moçëm në një pyll të ri. Kështu u nda nga jeta dhe gjiri i ngrohte i familjes dhe i shoqërisë, shoku ynë i dashur i kolektivit arsimor, mësuesi gojëmbël e zemërbardhë Sejfulla Sefa.

5 qershori i 2020-ës ishte goditja fatale për jetën e tij. I bërë para 3 muajsh operim në kokë, në spitalin e neurologjisë nr.5 të Tiranës për hemorragji cerebrale, u duk se Sefa ia hodhi të keqes shëndetësore, por ajo nuk e harroi. Goditja e dytë cerebrale i mori jetën dhe e ndau përfundimisht nga familja e shoqëria që aq shumë i deshte. Iku para kohe nga jeta ish mësuesi i dashur e i respektuar deri në admirim nga masa e nxënësve, njeriu zemërbardhë e kavalier që të falte vetëm fjalë të mira, fjalë shprese e dashuri njerëzore. Ai ishte altruist i vërtetë, që bëhej copa të ndihmonte njerëzit në nevojë. Nga këto veti të rralla që gëzonte Sefa, na u dridh zemra e na qau shpirti nga vdekja e tij e parakohshme.

Në 10 vitet e fundit ai jetoi familjarisht në Tiranë, në lagjen e ish Frigoriferit dhe ceremonia mortore u zhvillua në një lokal afër shtëpisë së tij. Varrimi u bë në varrezat e Tufinës në prani të qindra njerëzve të dashur të familjes e të shoqërisë, edhe pse pandemia e virusit i ndalon akoma njerëzit të lëvizin lirisht.

Lamtumirë, o njeriu gojëmbël e zemërbardhë i shoqërisë, o mësuesi i palodhur i brezit të ri, një nga yjet e arsimit në zonën e Bellovës, që tërë jetën punove për arsimimin e edukimin e brezit të ri në katër fshatrat e zonës sonë!

Sefa lindi në fshatin Zagrad me 12 maj 1948, në gjirin e një familje punëtore e patriote. Edhe pse Zagradi ishte 2 orë larg nga Peshkopia, Sefa ndoqi shkollën 7 vjeçare "Demir Gashi", Peshkopi në fillim të viteve '60 , duke bërë nga 4 orë rrugë në këmbë çdo ditë. Etja për arsimim ishte më e fortë se lodhja e rrugës tek Sefa. Ai ishte vetë i pesti vëlla, por babai i tij, Latifi, vendosi që 2 djemtë e vegjël, Sefen e Nuriun, t'i shkollonte. Falë dhe përpjekjeve të tyre të jashtëzakonshme, ata u shkolluan dhe u diplomuan të dy arsimtarë, edukatorë të brezit të ri. Bashkë me shokët e tij moshatarë si Eqerem Lami, Nuri Sefa e ndonjë tjetër, ai nuk ju nda shkollës. Pas mbarimit të 7 vjeçares, Sefa u regjistrua në shkollën pedagogjike Peshkopi, si nxënës i jashtëm. Tre vitet e para i mbaroi në Peshkopi,kurse maturën në shkollën "Shejnaze Juka" të Shkodrës në vitin shkollor 1967- 1968.

Fill pas mbarimit të shkollës pedagogjike Sefa filloi punën si mësues. Dy vitet e para të karrierës së tij i kreu në rrethin e Matit, si në Martanesh e Kurdari të Burrelit. Vitin e tretë Sefa e filloi në fshatin Rabdisht, në shtator të 1970, ku krahas mësimit të paradites, jepte mësim dhe në shkollën e natës, që funksiononte atëherë në fshat, bashkë me kolegët B.Lami e M.Xhembulla. Në vitet 1972- 1973 Sejfulla Sefa kreu shërbimin ushtarak ndaj atdheut në rrethin e Sarandës. Pas mbarimit të ushtrisë Sefa rifillon punën në profesionin e tij si mësues. Në 6-mujorin e parë të 1974 punon si mësues në fshatin Lajthizë të Lurës dhe pastaj 4 muaj si mësues në shkollën 8-vjeçare Kastriot. Nga janari I 1975 e deri në qershor të 1980 Sefa punon në shkollën 8-vjeçare Bellovë, duke dhënë lëndët Histori-Gjeografi. Pas këtij viti Sefa punon pareshtur si mësues dhe në fshatrat e tjerë të zonës si në Cerjan, Zagrad e Rabdisht, here në ciklin e ulët e here në ciklin e lartë, derisa doli në pension në verën e vitit 2012. Ai punoi pareshtur e me përkushtim për 44 vjet rresht për shkollimin e edukimin e brezit të ri. Ishte i komunikueshëm, luajal e i dashur me nxënësit. Për disa vjet rresht Sefa kreu dhe detyrën e zv/drejtorit të shkollës 8 –vjeçare Bellovë e Rabdisht. Motoja e punës së tij si mësues ishte: "Mëso vetë, që të mësosh të tjerët", "Duaji fëmijët, që të të duan", "Po s'të deshën fëmijët, nuk të buzëqeshin", "Bashkëpuno me prindërit, se patjetër do të kesh rezultate të larta në mbesim", "Bashkëpuno me kolegët për të pasur rezultate të mira e të vazhdueshme në shkollë."

Për punë të mirë e të palodhur në procesin mësimor- edukativ dhe përdorimin e metodave të reja në mësim, Sefa dekorohet në qershor të 1989 nga Presidiumi I Kuvendit Popullor me medaljen "Naim Frashëri". Që nga viti 1983 e në vazhdim, për rreth 20 vjet rresht, Sefa ushtroi dhe detyrën e kryetarit të Komisionit të Kualifikimit për të gjithë shkollat 8 –vjeçare të Qendrës, që nga Bellova e deri në Brezhdan e Melan. Për 16 vjet rresht (në vitet 1984—2000) Sefa punoi në fshatin e tij të lindjes me dy klasa kolektive. Nga duart e tij dolën të shkolluar dhjetëra e qindra nxënës, djem e vajza të fshatrave të Bellovës, që ruajnë kujtimet më të mira për të si mësues. Ai ishte mësues i dashur e përkushtuar, metodist i mirë. Për dy legjislatura rresht ai ka qenë dhe këshilltar i komunës Melan, në vitet 1992- 2000 për subjektin PS. Ishte një koleg pune i dashur e i çiltër, bujar e human. U martua në verën e 1976 me znj.Fllanxa e nga kjo martesë ka lënë dy djem e një vajzë. Të tre fëmijët e Sefës janë fëmijë të mirë e të edukuar, që kanë krijuar tashmë familjet e tyre.

U prehsh i qetë, o shoku ynë i punës në tokën amë! Kujtimi yt do të rrojë për shumë kohë në memorien e kolegëve e të nxënësve që mësove e edukove dhe përjetë në gjirin e familjes tënde të shtrenjtë. Lamtumirë o malet e bjeshkët e Zagradit ku u linde e u rrite.

18.06.2020

Elegji

Mësuesit Sef Sefa

Të prita si herët e tjera,
Të pimë kafen me lezet,
Lajm i hidhur erdhi te dera,
Ti na ike, dhimbja ka mbet…

Me lot familja miqësia,
Dhe pranvera me të zeza,
Na mungon, thonë shoqëria,
Dhe nxënësit e tu në breza.

Ç'na bëre, njeri i mirë
Kaq shumë pikëllim sot,
Kalojmë pranë shtëpisë tënde,
Sytë na mbushen me lot.

Do mbetesh për jetë në kujtesë,
Fjalëpakti, i mençur, i mirë,
I pavdekshëm kujtimi yt do mbesë,
Krenar familja e miqtë janë me ty!

BUJAR MUÇA

Për **Qerim Sulën** - Mjeshtrin e madh

Nga dr. **LAZAM GJOKA**

Një lajm i hidhur u përhap me shpejtësi gojë më gojë, në media mëngjesin e datës 31 maj 2020. Një bir i vyer i Dardhës, një xhevahir për shokët, një prind shembullor, një bashkëshort model, nuk është më në jetë.



Qerim Sula u rrëmbye nga një sëmundje e rëndë. Në fillim askush nuk donte ta besonte, askujt nuk i thotë zemra që një kob i zi kishte ndodhur, një tronditje shpirtërore është e fortë dhe e përbashkët. Në mallëngjimin që po më zë fytin vijmë t'i japim lamtumirën e fundit këtij artisti të rrallë, që jemi rritur së bashku me të, me Qerimin e ëmbël dhe gjithmonë i buzëqeshur dhe i padjallëzuar, besnik deri në kulm.

Qërimi ishte një simbol i personifikuar i mëshirës dhe i dhembshurisë ndaj njerëzve nevojtarë, e ndjente thellë në shpirtin e tij bujar.

Valët e jetës e kishin rrahur që në moshë të re. Në kushte të vështira të jetës arriti të formojë një personalitet të shëndoshë me mundime e përpjekje, koshient i detyrës që njeriu duhet të ketë në shoqëri, në supet e tij peshonte një përgjegjësi e madhe.

Që në shkollën fillore nisi jetën artistike me këngë deri në ditën e vdekjes, ku pranë arkivolit të tij mbi dhe u këndua kënga e lamtumirës përgjithmonë nga kjo jetë. Ah kob i zi, për fat të keq fytyrat e familjes, motrave, vëllezërve e të afërmve, shokëve dhe miqve u vrenjtën befas. Qerimi i shtrenjtë nuk rron më. Lot rrëke të pranishmëve kur u këndua kënga nuk patën të ndaluar. Plagë që shkaktoi humbja e tij ka për të qenë gjithmonë e hapur. Në horizontin e botës së artit shqiptar ai kaloi si një meteor i ndritur, duke lënë pas gjurmë pa zhdukur të veprës së tij mirëbërëse, artdashëse ndaj njerëzimit. Po të përcjellim Qerim i shtrenjtë, o shoku, miku, babai, kolegu, në banesën tënde të fundit. Oh! ç'fatkeqësi të mos shohim me kurrë hijen tënde të pashme, fytyrën tënde të përmallshme.

Po si nuk i erdhi pak keq vdekjes që të rrëmbeu nga gjiri i familjes tënde të përlotur që të kishin për mburojë, po si nuk i prite fëmijët e tu që i lë në pikëllim të thellë dhe të vajtuan larg në Amerikë. Kështu e ka jeta, na ndau për së gjalli dhe për së vdekuri me kohë e pa kohë.

Të qajmë e të vajtojmë o Qerim se na le në vetmi me shpirt të djegur, ti u ndave fizikisht, por rron në zemrat dhe shpirtin tonë. E si mund ta ngushëllojmë familjen tënde që u godit rëndë nga humbja jote në kohën që kishin nevojë shumë të madhe për ty?

Ti na ke lënë amanet repertorin tënd të këngëve: si: "Zot ti dalim këtij vatani", "Ballë përballë Dibra me dushmanin", "Jam shqiptar dhe nuk shitem kurrë", "Jam Kosovë, kam le me emër", "Më ka le nana mos me vdek", "Na këndojnë pushkët nëpër kulla", "Këngë për Skënderbeun" etj.

Lamtumirë përgjithmonë o Qerim i shtrenjtë, prehu i qetë në paqe se shkove nga kjo jetë me ballin hapur dhe krenar!

FOTOLAJM



Në fillim të qershorit kompania "Gjoka Konstruksion" ka nisur asfaltimin në disa segmente të rrugës së Arbrit nga Zall Dajti në drejtim të Tiranës dhe nga Maqellarë në drejtim të doganës së Bllatës. Kompania ka bërë të ditur se deri në fund të verës do të përfundojnë shtresa e asfaltit për më shumë se 10 km rrugë si dhe brenda vjeshtës do të përfundojë hapja e trasesë për të gjithë rrugën, përfshirë by-passin në Qafë Murrizë dhe urën e fshatit Fshat në Klos. Sipas premtimeve të kompanisë, rruga do të hapet për trafikun në pranverën e vitit të ardhshëm, gati një vit më parë se parashikon kontrata mes kompanisë dhe qeverisë shqiptare. Ndërsa Tuneli i Murrizit, pavarësisht se punimet vazhdojnë, parashikohet të zgjasë më shumë se afati i parashikuar.
Në foto: Nga punimet për shtrimin e asfaltit në Zall Dajt.

Bigmarket
PESHKOPI
DI ÇFARË ZGJEDH!
GJITHMONË ME OFERTA...